

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2020



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "VIKTOR EFTIMIU" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Korrik 2021

PËRMBAJTJA

Shkurtime	2
Përmbledhje	3
Hyrje	8
1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	10
1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	10
1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)	11
1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale	11
1.1.1 Norma e Arkëtimit	15
1.1.2 Niveli i Matjes	16
1.1.3 Efiçenca e Stafit	17
1.1.4 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	17
1.1.5 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN	18
1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit	18
1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet	18
1.2.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK	21
Investimet nga Buxheti i Shtetit dhe Donatorët	21
1.3 Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim	22
1.4 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave	25
2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime	26
2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK	26
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	28
2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës	29
2.3.1 Uji Pa të Ardhura	29
2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M	34
2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale	41
2.3.4 Norma e Arkëtimit	43
2.3.5 Niveli i Matjes	47
2.3.6 Efiçenca e Stafit	52
2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	59
2.3.8 Mbulimi me Kanalizime	63
3 Konkluzione dhe Rekomandime	69
4 Tema e Veçantë (Studim i ERRU-së Tetor 2020)	70
5 Anekse: Të dhënat Kryesore të Sektorit	77

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli i Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesor të Performancës
OAF	Operator i Alternativës së Fundit
SECO	Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike
SKP	Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operim dhe Mirëmbajtje
NAP	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme
NAK	Norma e Arkëtimit Korente
UPA	Uji Pa të Ardhura

Përmbledhje

Raporti i Performancës, si Instrument Analize, Informimi dhe Transparencë i Sektorit UK

Raporti i Performancës së sektorit UK hartuar nga ERRU tashmë për të 10-in vit radhazi është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Raporti nuk përbën thjesht një dokument statistikor krahasimi me vitin paraardhës, por analizon dhe paraqet tendencën e performancës të të gjithë shoqërive ujësjellës kanalizimeve për vitin 2020 duke nxjerrë në pah problematikat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomik të tyre.

ERRU në të njëjtën kohë me anë të këtij Raporti realizon detyrimin që e ngarkon ligji duke dhënë vlerësimin si institucion i pavarur në pozita asnjëse në lidhje me performancën e sektorit UK .

Bilanci Financiar i Sektorit UK

Tabela 1 e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur performancën financiare të sektorit UK për vitet 2019 dhe 2020.

Tabela 1. Performanca financiare e sektorit për vitet 2019 dhe 2020.

Nr.	Emërtimi Rezultatet Financiare	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca	
		në 000 lekë	në 000 lekë	2020/2019 (në 000 lekë)	2020/2019 (në %)
1	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,113,875	9,542,489	428,614	5%
2	Kostot Kapitale	3,480,569	3,606,628	126,059	4%
3	Kostot Totale	12,594,444	13,149,117	554,673	4%
4	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,763,452	9,850,414	86,962	1%
5	Të Ardhurat nga Subvencionet	700,000	720,000	20,000	3%
6	Totali i të Ardhurave	10,463,452	10,570,414	106,962	1%
7	Mbulimi i Kostove O&M	115%	111%		-4%
8	Mbulimi i Kostove Totale	83%	80%		-3%

Burim informacioni: ERRU

Nisur nga tabela e mësipërme shihet se gjendja financiare e sektorit UK në drejtim të mbulimit të kostove të O&M dhe atyre totale për vitin 2020 është përkeqësuar krahasuar me vitin 2019. Gjendja financiare për pjesën më të madhe të shoqërive UK mbetet akoma e paqëndrueshme. Vetëm 10 nga 57 shoqëri UK në të gjithë vendin mbulojnë Kostot Direkte të Operim-Mirëmbajtjes me të ardhurat.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 850 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 86.9 milion lekë. Gjithashtu këtë vit janë rritur me rreth 20 milion lekë ose 3% të ardhurat nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore. Rritja e të ardhurave ka ardhur kryesisht nga shoqëritë e mëdha (Grupi I-rë)¹ me 17.5 milion lekë ku brenda Grupit ka shoqëri me diferenca pozitive dhe negative. Grupi i II rritet me 94.1 milion lekë ndikim i cili ka ardhur kryesisht nga shoqëritë UK Peqin, UK Mirditë, UK Krujë, UK Kukës. Në këtë grup janë shtuar edhe 2 shoqëri për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve, të cilat kanë rritje të të ardhurave, por që më parë kanë qenë në grupin e tretë UK Poliçan dhe UK Tropojë. Kalimi i këtyre dy shoqërive në Grupin e II ka ndikuar edhe në të ardhurat nga aktiviteti për Grupin e III-të i

1

Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës Kanalizme
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës Kanalizme
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës Kanalizme

cili ka rënie me -24.7 milion lekë. Nëse do të llogariteshin të ardhurat e vitit 2019 duke përjashtuar 2 shoqëritë, atëherë krahasimi me vitin 2020 i Grupit të III-të do të kishte rritje me 13.9 milion lekë.

Edhe pse në dukje sektori rezulton me rritje të të ardhurave nga aktiviteti UK dhe subvencionet me 106.9 milion lekë, kjo nuk ka influencuar pozitivisht në drejtim të mbulimit të kostove të cilat në mbyllje të vitit 2020 rezultojnë me rritje më të lartë (me 575 milion lekë) krahasuar me një vit më parë.

Rritja e kostove O&M është influencuar kryesisht nga rritja e zërave të kostove të punës dhe kostove të riparimeve ndërsa Kostot Totale janë rritur nga zëri i kostove financiare ku kryesisht ka ndikuar rritja e kostove për tatimet dhe për provizionet.

Në mënyrë që të mbulohen diferencat e kostove të O&M me të ardhurat, nevoja për subvencione për Sektorin është llogaritur në vlerën e 1,344 milion lekë (rreth 10.8 milion euro), ndërsa fondi i akorduar shoqërive si subvencion është rreth 720 milion lekë (5.8 milion euro).

**Performanca e
Sektorit UK,
Treguesit
Kryesorë të saj**

Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK jepen në mënyrë të përmblodhur në Tabelën 2

Tabela 2. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK (TKP)

Nr.	Treguesit e Performancës	2019	2020	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	63.7	65.4	↘	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	107.1	103.2	↘	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	77.5	74.9	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	95.8	89.8	↘	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	79.8	76.6	↘	82
6	Niveli i Matjes (%)	77.3	79.6	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.33	5.32	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	13.3	13.8	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	51	51.5	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.8	76.1	↘	n/a

Burim informacioni: ERRU

Nga tabela e mësipërme vërehet se krahasuar me vitin 2019, kanë tendencë negative 6 nga treguesit kryesorë të performancës ndërsa 4 tregues kanë tendencë pozitive.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve, lidhur me Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë (mesatarisht 13.8 orë/ditë) dhe Nivelit të Matjes (79.6%), ka përmirësim, por treguesit mbeten përsëri në nivele jo të kënaqshme, sipas referencës që ERRU konsideron për performancë të mirë. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit (mesatarisht 5,32 staf/1000 lidhje) është pothuajse në të njëjtat nivele, sektori edhe për vitin 2020 vazhdon të paraqitet i mbingarkuar me staf, i cili është shtuar me 213 punonjës. Vërehet një përmirësim i lehtë edhe për treguesin e Mbulimit me Kanalizime. Treguesi Mbulimi i Kostove O&M, sipas referencës së ERRU, paraqitet në nivel performance të mirë, por tendenca e tij është negative krahasuar me vitin 2019. Megjithatë sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM sepse rreth 47 shoqëri UK nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M. Rezultantja del pozitive për sektorin sepse mjaft nga shoqëritë e mëdha duke filluar që nga UK Tirana arrijnë ti mbulojnë kostot e O&M mbi 100%.

Treguesi Mbulimi i Kostove Totale nuk e ka arritur nivelin e performancës së mirë dhe është përkeqësuar për vitin 2020, nga 77.5% në 74.9%. Gjithashtu edhe treguesit Uji Pa të Ardhura, Norma e Arkëtimit Korente dhe e Përgjithshme si dhe Mbulimi me Furnizimin me Ujë paraqiten me rënie krahasuar me vitin 2019.

**Reforma e
Qeverisë në
Sektorin UK dhe
Nevoja e
Agregimit të tij**

Sektorin UK nuk e ka përfunduar ende riorganizimin sipas reformës edhe pse tashmë kanë kaluar 5 vjet nga miratimi i VKM-së Nr.63, datë 27.01.2016, për reformën në sektorin UK. Aktualisht të gjitha shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin në të gjithë territorin administrativ të bashkive përkatëse, por jo të gjitha kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas procesit të parashikuar të riorganizimit pasi vetëm 39 nga 57 shoqëri UK janë licencuar nga ERRU sipas reformës.

Reforma po ndiqet nga afër edhe nga AKUM në zbatim të kontratave të performancës të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkive bazuar në tregues performance që kushtëzojnë edhe shpërndarjen e subvencioneve, si dhe të incentivave për investimet fizike.

Për përshpejtimin dhe arritjen e përmirësimit të gjendjes në sektor, në fund të vitit 2019, MIE përfshiu në Projekt-Ligjin për Sektorin e UK një qasje që propozon agregimin e detyruar të shoqërive me performancë të dobët duke i menaxhuar ato me anë të subjektit Struktura e Kompetencave të Përbashkëta (SKP), por që akoma nuk është aprovuar. Gjithashtu në prill të vitit 2020 me kërkesë të MIE u realizua studimi për agregimin e sektorit i financuar nga (SECO) i cili ashtu si në studimin e bëshmërisë mbi “Agregimin e Sektorit Ujësjellës Kanalizime në Shqipëri i vitit 2009 ” hartuar nga PADECO Co. Ltd dhe Valu-Addces ka konkluduar që: “Agregimi duhet realizuar në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”. Agregimi në vetvete është një proces kompleks e delikat ku ndërthuren mjaft faktorë objektivë dhe subjektivë të cilat duhen marrë në konsideratë, por mund të realizohet në mënyrë agresive dhe të menjëhershme duke tentuar që të jetë i organizuar në nivel kombëtar me një ose 3-4 shoqëri UK, ose gradualisht me agregime pilot të suksesshme si eksperiencia pozitive për agregimin më tej të të gjithë sektorit.

Sipas rastit të dytë parashikohet seleksionimi i 2-3 rasteve të mundshme të një agregimi të suksesshëm sipas parimit me baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore. Më tej këto shembuj pozitivë do të shërbejnë si bazë për agregimin aty ku është e mundshme për të gjithë sektorin.

**Vështirësitë e
Shoqërive UK
për tu Licencuar
nga ERRU**

Në mbyllje të vitit 2020 rezultojnë 8 shoqëri të pa licencuara nga 57 që operojnë në sektorin UK, prandaj problematika e licencimit mbetet akoma evidente në sektor. Arsytet e mos licencimit janë të ndryshme, por kryesisht janë si rezultat i mungesës së emërimit të drejtuesve teknike të kualifikuar me diplomën e duhur sipas kërkesave ligjore si dhe të pajisjes me Akt Miratimin Higjeno Sanitar nga Inspektorati Shëndetësorë Shtetëror. Lidhur me këtë të fundit, ERRU, në mënyrë të vazhdueshme edhe në raportimin që bën çdo vit pranë Kuvendit të Shqipërisë, ka theksuar nevojën për rishikimin e procedurës për përftimin e Akt Miratimit Higjeno Sanitar. Përfitimi i këtij akti ka paqartësi teknike dhe në të njëjtën kohë plotësimi i kushteve ligjore aktuale kërkon vlera të mëdha të investimeve fizike, që nuk mund të plotësohen veçanërisht nga shoqëritë e vogla që operojnë në sektor.

**Planet e
Biznesit 5
Vjeçare si
Instrument i
Përmirësimit të
Menaxhimit të
Shoqërive UK**

Planet 5 Vjeçare të Biznesit janë një dokument shumë i rëndësishëm për shoqëritë UK pasi ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të tyre duke planifikuar veprimet e nevojshme që duhen ndërmarrë nga shoqëria për të përmirësuar Treguesit Kryesorë të Performancës. Duhet theksuar se një pjesë e shoqërive kryesisht ato të mëdha dhe të mesme disponojnë plane 5 vjeçare biznesi, por kërkohet përditësimi i tyre me zonat e reja të shtuara sipas reformës. Mungesa e Planeve 5 vjeçare të biznesit është evidente kryesisht për shoqëritë e vogla, të cilat nuk kanë kapacitete dhe mjetet e duhura financiare për realizimin e tyre. Hartimi i Planeve 5 vjeçare për këtë kategori të shoqërive duhet mbështetur me prioritet nga buxheti i shtetit dhe/ose donatorët.

Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave të Raportuara nga Shoqëritë UK

Për të dytin vit radhazi Raporti i Performancës së sektorit UK është hartuar mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga njësia e monitorimit pranë ERRU-së. Besueshmëria dhe saktësia e të dhënave tekniko-ekonomike mbetet akoma një sfidë për sektorin UK pasi konstatohet jo rrallë se të dhënat e raportuara nga shoqëritë pranë ERRU-së nuk përputhen gjatë verifikimeve të Bilanceve Financiare, Bilanceve të Ujit, apo kur ato aplikojnë për tarifa të reja. ERRU e ka në fokus përmirësimin e besueshmërisë së bazës së të dhënave dhe është duke përfshirë në metodologjinë re të tarifave një kapitull vlerësimi klasifikimi të saktësisë së të dhënave që raportojnë shoqëritë kur aplikojnë për tarifa të reja. Metodologjia jep gjithashtu dhe rrugët dhe mënyrën e rritjes së saktësisë së të dhënave që duhet zbatuar nga stafi i shoqërive për të rritur përgjegjësinë e tyre në këtë drejtim.

Shoqëritë UK Janë të Mbingarkuara me Staf

Trendi i rritjes së stafit në sektor vazhdon akoma edhe për vitin 2020 i cili rezultoi i shtuar me 213 punonjës. Megjithatë treguesi efienca e stafit është pothuajse në të njëjtin nivel 5.32 sfaf/1000 lidhje UK, pasi edhe numri i lidhjeve është rritur, duke zbutur kështu efektin negativ të rritjes së numrit të stafit. Zgjerimi i zonës së shërbimit me zonat e shtuara rurale, por edhe garantimi i sigurisë me personel roje i komponentëve të sistemeve të furnizimit me ujë të shtuara, kanë sjellë nevojën e rritjes së numrit të punonjësve për shoqëritë UK. ERRU në aplikimet e shoqërive UK për tarifa analizon në mënyrë të detajuar këtë tregues i cili lidhet direkt me kostot e punës si zëri me peshë të konsiderueshme në kostot e O&M.

Investimet në Sektorin UK dhe Impakti i Tyre

Për vitin 2020 në sektor janë financuar rreth 6.5 miliard lekë ekuivalente me 53 milion euro. Një pjesë e financimeve është realizuar nga buxheti i shtetit përmes AKUM në vlerën 4.4 miliard lekë ose 36 milion euro (plus dhe vlerën e TVSH-së) dhe pjesa tjetër nga burimet e huaja përmes KfW & SECO në vlerën 2.1 miliard lekë ose 17 milion euro. Financimet nga buxheti i shtetit janë planifikuar për periudhën 2020-2023. Sipas tabelës nr.3 paraqitet realizimi i tyre për vitin 2020.

Tabela 3. Investimet e planifikuara në sektorin UK financuar nga AKUM dhe nga burime të huaja për periudhën 2020-2023.

Përshkrimi	Vlera Totale e Investimit 2020-2023 (Lekë)	Vlera e Financuar për Vitin 2020 (Lekë)
Investime nga AKUM	18,531,262,514	3,706,252,502
Investime të Huaja	1,744,917,279	1,744,917,279
TVSH	4,055,235,959	1,090,233,955
TOTALI	24,331,415,752 (eq. 196 milion euro)	6,541,403,736 (eq. 53 milion euro)

Financimet e huaja nga KfW dhe SECO kanë qenë kryesisht përmes programit Infrastruktura bashkiake III-IV që përfshijnë shoqëritë UK Librazhd, Lushnje, Gjirokastër dhe Kamëz.

Një listë e detajuar e të gjithë projekteve të planifikuara dhe të përfunduara gjatë vitit 2020 si dhe atyre në proces me financim nga buxheti i shtetit dhe ai i huaj jepet në Tabelën 40, Aneks 7 .

Objekti afat shkurtër i qeverisë qendrore me investime nga buxheti i shtetit nëpërmjet AKUM është të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë 24 orë deri në vitin 2023 për 58 nga 66 qendra urbane, projekt ky që ka filluar të zbatohet që në vitin 2018. Deri në fund të vitit 2019 ishin realizuar furnizimi me ujë i 14 qendrave urbane Fushë Arrëz, Lezhë, Tropojë, Cërrik, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Kolonjë, Fier, Konispol, Tepelenë,

Memaliaj dhe Përmet. Në mbyllje të vitit 2020 si rezultat i investimeve të kryera nga AKUM rezultojnë të kemi furnizim me ujë pa ndërprerje (24 orë) edhe për 8 qendra të tjera urbane përkatësisht **Pukë, Vau Dejës, Koplik, Rrëshen, Krujë, Peqin, Poliçan dhe Këlcyrë** duke e çuar në 22 numrin e qyteteve që në fund të vitit 2020 kanë cilësi mjaft të lartë të shërbimit të furnizimit me ujë. Nga investimet e realizuara gjatë vitit 2020 në vlerë prej 4.4 miliard lekë (rreth 36 milion euro) kanë përfituar dhe është përmirësuar cilësia e shërbimeve për rreth 654,000 banorë.

Referuar Master Planit të Furnizimit me Ujë dhe KUN nevojat për investime në sektor të projektuar deri në vitin 2040 vlerësohen rreth 5 miliard euro.

Financimi aktual në sektor ende nuk i përgjigjet nevojave reale që ka sektori UK për të përmbushur kërkesat e Direktivës Evropiane të Ujit të Pijshëm dhe Ujërave të Ndotura. Modeli i hartuar për mbulimin e skemës së financimit në 2016 identifikoi rrugët e financimit për mbulimin e nevojave të investimeve fizike dhe institucionale për përmirësimin e performancës së sektorit sipas objektivave strategjike me kontributet e parashikuara sipas sistemit 3T-të, përkatësisht nga Taksat (buxheti), Transferrat (donatorë), si dhe nga Tarifatat e konsumatorëve. Për këto të fundit duke patur parasysh dhe respektuar kriterin e përballueshmërisë së faturës së shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët.

KONKLUZIONE, REKOMANDIME

- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave është një problem thelbësor në sektor dhe kërkon rritjen e përgjegjshmërisë së stafëve drejtues të shoqërive UK në drejtim të raportimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme. ERRU të hartojë dhe aprovojë një metodikë-rregullore për një kontroll dhe klasifikim të saktësisë së raportimeve të të dhënave mbi baza faktike dhe analitike.
- Ujit Pa të Ardhura, 65.4% në nivelin më të lartë të viteve të fundit mbetet problem serioz për sektorin UK. AKUM duhet të mbështesë instalimin e matësve të ujit në burim dhe tek konsumatorët familjarë kryesisht për shoqëritë e dobëta financiarisht në mënyrë që të hartohen bilancet e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Niveli i lartë prej 45 % që zënë kostot e punës në kostot operacionale të shoqërisë, kërkon mirëmanaxhim të burimeve njerëzore nga ana e saj. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.
- Shoqëritë UK duhet të hartojnë Planet e Biznesit 5 Vjeçare, në mënyrë që të përcaktojnë vijimësinë e aktivitetit të tyre. Hartimi i tyre për shoqëritë e vogla që kanë mundësi financiare të kufizuara duhet të mbështetet nga AKUM dhe/ose donatorët.
- Shoqëritë duhet të hartojnë Planet e Menaxhimit të Aseteve që mundësojnë planifikimin efikas të investimeve në sektor në përputhje me ciklin e plotë të jetës së aktiveve.
- Referuar respektimit të VKM Nr.63 për reformën, në sektor janë akoma 18 shoqëri të pa licencuara. Kjo kërkon një angazhim serioz nga Bashkitë dhe shoqëritë UK për të përfunduar procesin e licencimit si shoqëri të riorganizuara duke vlerësuar dhe regjistruar asetet, si dhe marrjen e Akt Miratimit Higjeno Sanitar.
- Të vlerësohen elementët e qasjes për agregimin e sektorit në aspektet praktiko-ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta, si dhe të vlerësohet qasja për agregimin e sektorit me disa shembuj agregimi të suksesshëm.

Hyrje

Enti Rregullator i Ujit është një institucion publik i pavarur, ligji i ka atribuar kompetencat e licencimit dhe vendosjes së tarifave për operatorët që ofrojnë shërbimet e ujësjellës kanalizimeve konsumatorëve. ERRU gjithashtu luan rolin e balancuesit në mbrojtje të interesave të konsumatorëve në një ambient monopol shërbimesh, dhe inkurajimit të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të operatorëve në sektor.

Hartimi i Raportit Vjetor të Performancës së Sektorit të UK, përbën një tjetër detyrim ligjor për ERRU-në, të cilin ajo e përmbush me një analizë dhe vlerësim sa më objektiv të performancës së sektorit, duke dhënë dhe konkluzionet përkatëse që rrjedhin prej tyre, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të shoqërive.

Raporti i Performancës së shoqërive UK 2020 hartuar nga ERRU është pjesë e informacionit të faqes së web-it të ERRU-së, si instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Në të jepet një panoramë e sektorit krahasuar me vitin paraardhës (benchmarking) dhe tendenca e performancës të të gjithë sektorit të UK në Shqipëri.

Viti 2020, subjekt i këtij raporti ka qenë viti pandemisë së COVID 19, si dhe i periudhës post-tërmetit shkatërrimtar të nëntorit 2019. Të dy këto fenomene katastrofike jashtë vullnetit njerëzor, si në të gjithë sektorët e tjerë të aktivitetit ekonomik, kanë patur influencën e tyre negative edhe në performancën e sektorit të ujësjellës kanalizimeve.

Ndër faktorët kryesorë në uljen e performancës financiare të shoqërive UK të post tërmetit përmendim pamundësinë për të faturuar dhe arkëtuar për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve mjaft familje dhe biznese për shkak të shkatërrimit të banesave apo të dëmtimit mjaft të rëndë të tyre që në mjaft raste i ka detyruar ato që të zhvendosen për një periudhë relativisht të gjatë. Dëmtimi i bizneseve shtoi papunësinë, dhe rrjedhimisht numrin e familjeve me pamundësi pagese të faturës së shërbimeve të UK.

Ndërkohë pandemia e COVID 19 fatmirësisht rezultoi që nuk transmetohej me anë të ujit të pijshëm, që nëse do të ishte rasti do të kishte pasoja të paparashikuara dhe ndoshta fatale. Impakti në sektorin e ujësjellës kanalizimeve ishte në drejtim të pengesave të përkohshme në drejtim të lëvizjes së punonjësve të shoqërive UK, në riorganizimin e tyre për situata të jashtëzakonshme, si dhe në disa masa të tjera preventive për operimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve të UK. Pandemia shtroi si prioritet që shoqëritë UK të hartojnë Planet e Sigurisë dhe Emergjencës për rastet kur këto shoqëri gjenden përballë situatave të jashtëzakonshme si kjo e pandemisë apo të ndonjë lloji tjetër fatkeqësie natyrore që nuk varet nga vullneti njerëzor. Theksohet fakti se impakti financiar në aktivitetin e shoqërisë nga pandemia nuk ishte i konsiderueshëm në drejtim të shpenzimeve, sepse u kufizua në blerjen e disa dezinfektanteve dhe masa të tjera mbrojtëse, si dhe pagesa jashtë orarit, por pati impakt të konsiderueshëm në arkëtimet.

Në terma shifrorë të dy fatkeqësitë e mësipërme sollën që treguesi i mbulimit të kostove të operim-mirëmbajtjes (O&M) të përkeqësohet me rreth 4% krahasuar me vitin 2019, ndërsa ai i normës së arkëtimit u përkeqësua me rreth 3%.

Gjithsesi sektori krahasuar me vitin 2019, kanë tendencë negative 6 nga treguesit kryesorë të performancës ndërsa 4 tregues kanë tendencë pozitive. Përmirësim kanë patur cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve që është rritur Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë, si dhe Niveli i Matjes. Treguesi i

performancës së Efijencës së Stafit ka mbetur në të njëjtat nivele, por sektori edhe për vitin 2020 vazhdon të paraqitet i mbingarkuar me staf.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M ka patur tendencë rënie dhe sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM sepse rreth 47 shoqëri UK nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M.

Gjithashtu edhe treguesit Uji Pa të Ardhura, Norma e Arkëtimit Korente dhe e Përgjithshme si dhe Mbulimi me Furnizimin me Ujë paraqiten me rënie krahasuar me vitin 2019.

Problem për Sektorin UK vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura që një pjesë e konsiderueshme e shoqërive kanë ndaj OSHEE-së, të cilat në mbyllje të vitit 2020 raportohen rreth 7.5 miliard lekë ose rreth 61% të detyrimeve që sektori UK ka ndaj të tretëve. Mjaft problematike me debi të konsiderueshme nga 0,2 deri 2, 3 miliard lekë paraqiten shoqëritë Durrës, Vlorë, Patos, Tiranë, Kavajë, Fier, Kurbin, Peqin, Lushnje etj., që i kanë ujësjellësat me ngritje mekanike. *Përgjithësisht shlyerja e këtyre detyrimeve ndaj OSHEE kërkon zgjidhje në nivel të qeverisë qendrore sepse është e pamundur që ajo të realizohet me anë të rritjes së tarifave të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.*

Objektivi afat shkurtër i qeverisë qendrore me investime nga buxheti i shtetit nëpërmjet AKUM është që të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë 24 orë deri në vitin 2023 për 58 nga 66 qendra urbane, projekt ky që ka filluar të zbatohet që në vitin 2018. Deri në fund të vitit 2019 ishte realizuar furnizimi me ujë i 14 qendrave urbane Fushë Arrëz, Lezhë, Tropojë, Cërrik, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Kolonjë, Fier, Konispol, Tepelenë, Memaliaj dhe Përmet. Në mbyllje të vitit 2020 si rezultat i investimeve të kryera nga AKUM rezultojnë të kemi furnizim me ujë pa ndërprerje (24 orë) edhe për 8 qendra të tjera urbane përkatësisht Pukë, Vau Dejës, Koplik, Rrëshen, Krujë, Peqin, Poliçan dhe Këlcyrë duke e çuar në 22 numrin e qyteteve që në fund të vitit 2020 kanë cilësi mjaft të lartë të shërbimit të furnizimit me ujë. Gjithashtu nga investimet e realizuara gjatë vitit 2020 për një vlerë prej 4.4 miliard lekë (rreth 36 milion euro) kanë përfituar, pra është përmirësuar cilësia e shërbimeve për rreth 654,000 banorë.

Në drejtim të nevojës së përmirësimit të menaxhimit, shoqëritë UK të riorganizuara, kanë nevojë urgjente që të hartojnë Planet e Biznesit 5 Vjeçar për një skanim të situatës, problematikave, hartimit të plan veprimeve, si dhe të përcaktimit të saktë të nevojave për investime në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura. Planet e Biznesit 5 Vjeçare të shoqërive UK duhet të konsiderohen si domosdoshmëri dhe baza justifikuese për propozimet për tarifa të reja kur ato aplikojnë pranë ERRE-së.

Si konkluzion, përmirësimi i performancës për të gjithë sektorin kërkon një angazhim gjithëpërfshirës të të gjithë aktorëve të këtij sektori, përkatësisht shoqërisë UK, bashkisë dhe qeverisë qendrore dhe të gjithë aktorëve të tjerë të rëndësishëm në sektor.

1 Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Performanca e përgjithshme e sektorit Ujësjetës Kanalizime për vitin 2020 dhe tendenca e saj krahasuar me vitin 2019 dhe me objektivat e "Performancës së Mirë" të përcaktuara nga ERRU, paraqiten në Tabelën 4 "Treguesit e Performancës së Sektorit UK".

Tabela 4. Treguesit e Performancës së Sektorit të UK

Nr.	Treguesit e Performancës	2019	2020	Tendenca	Performancë e Mirë (ERRU)
1	Uji Pa të Ardhura (%)	63.7	65.4	↘	30
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	107.1	103.2	↘	100
3	Mbulimi i Kostos Totale (%)	77.5	74.9	↘	80
4	Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (%)	95.8	89.8	↘	82
5	Norma e Arkëtimit Korente(%)	79.8	76.6	↘	82
6	Niveli i Matjes (%)	77.3	79.6	↗	85
7	Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje UK)	5.33	5.32	↗	4/6/10
8	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	13.3	13.8	↗	18
9	Mbulimi me Kanalizime KUN (%)	51	51.5	↗	75
10	Mbulimi me Furnizim me Ujë (%)	76.8	76.1	↘	n/a

Shënim: Burimi ERRU

Nga tabela e mësipërme vërehet se 6 nga treguesit kryesorë të performancës për sektorin UK kanë tendencë negative, ndërsa 4 tregues kanë tendencë pozitive krahasuar me vitin 2019.

Cilësia e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve, lidhur me Kohëzgjatjen e Furnizimit me Ujë (mesatarisht 13.8 orë/ditë) dhe Nivelit të Matjes (79.6%), ka përmirësim, por treguesit mbeten përsëri në nivele jo të kënaqshme, sipas referencës që ERRU konsideron për performancë të mirë. Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit (mesatarisht 5,32 staf/1000 lidhje) është pothuajse në të njëjtat nivele, sektori vazhdon të paraqitet i mbingarkuar me staf dhe shtimi i tij vijon të konstatohet edhe për vitin 2020. Vërehet një përmirësim i lehtë edhe për treguesin e Mbulimit me Kanalizime KUN.

Treguesi Mbulimi i Kostove O&M paraqitet në nivel performancë të mirë sipas referencës së ERRU, por tendenca e tij është negative krahasuar me vitin 2019. Megjithatë sektori ka akoma nevojë që të subvencionohet nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM sepse rreth 47 shoqëri UK nuk arrijnë të mbulojnë 100% kostot e O&M. Rezultantja del pozitive për sektorin sepse mjaft nga shoqëritë e mëdha duke filluar që nga UK Tiranë arrijnë ti mbulojnë kostot e O&M mbi 100%. Treguesi Mbulimi i Kostove Totale nuk e ka arritur nivelin e performancës së mirë dhe është përkeqësuar për vitin 2020, nga 77.5% në 74.9%.

Gjithashtu edhe treguesit Uji Pa të Ardhura, Norma e Arkëtimit Korente dhe e Përgjithshme si dhe Mbulimi me Furnizimin me Ujë paraqiten me rënie krahasuar me vitin 2019.

Në përgjithësi performanca e sektorit për vitin 2020 paraqitet e përkeqësuar për shkak edhe të Covid-19 i cili ka ndikuar në të gjitha variablat që llogarisin treguesit e performancës sidomos në uljen e faturimit dhe arkëtimin e të ardhurave.

1.1.1 Uji Pa të Ardhura (UPA)

Gjatë këtij viti, të gjitha shoqëritë UK në sektor, prodhuan 303,8 milion m³ nga të cilat 60% me ngritje mekanike dhe 40% me vetërrjedhje. Krahësuar me vitin 2019, ndërsa variabli “Uji i Prodhuar” u rrit me +18,1 milion m³, variabli volumi i faturuar pësoi rënie me 2,15 milion m³ pavarësisht se shoqëritë rriten numrin e lidhjeve me ujin me +15,667 lidhje të reja. Vlerësimi dhe jo matja e ujit të prodhuar në burim si pasojë e mungesës në një pjesë të madhe të matësve në to, mos pajisja 100% e të gjithë konsumatorëve me matësa, faturimi me tarifë aforfe i cili nuk i përgjigjet konsumit real sidomos për konsumatorët në zonat rurale bën vlerësimin e këtij treguesi të ketë pasaktësi e cila mund të jetë në nivele të konsiderueshme.

Treguesi UPA në nivelin 65.4%, i përkeqësuar me 1.7% për vitin 2020, vazhdon të mbetet në nivele të larta e të papranueshme. Faktorët si “lidhje të paligjshme”, “faturimi aforfe”, “leximet e gabuara nga faturuesit”, si dhe “sistemet me tubacione të vjetra” që ju bashkëngjiten shoqërive gjatë reformës së re territoriale janë disa nga faktorët që e mbajnë akoma këtë tregues në nivele kaq të larta.

Niveli i lartë i UPA në sektor, tendenca në përkeqësimin e tij, mbetet një nga shqetësimet më të mëdha për rregullatorin. Në këtë kuadër, ERRU kërkon çdo vit hartimin e Bilancit të Ujit, i cili është një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve teknike dhe administrative si dhe orientimin e shoqërive drejt përmirësimit të treguesit “Uji Pa të Ardhura”.

Akoma mjaft shoqëri hasin vështirësi në hartimin e tij, kryesisht në përlllogaritjen e faktorëve që përbëjnë në tërësi treguesin, si pasaktësi të dhënash, si dhe papërgjegjshmëri të stafit drejtues për rëndësinë e tij. Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve, emërimeve të duhura veçanërisht për stafin teknik, paraqitet domosdoshmëri sidomos për shoqëritë e grupit të dytë dhe të tretë.

Sfidë e sektorit për përmirësimin e treguesit Ujit Pa të Ardhura mbetet ulja e humbjeve administrative dhe fizike të cilat ndikojnë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë, si dhe rritjen e treguesit të Kohëzgjatjes së Furnizimit me Ujë (objektivi i furnizimit me ujë 24/7).

Ulja e humbjeve lidhet direkt me menaxhimin e kontrollit të humbjeve sidomos në sistemet e furnizimit dhe veçanërisht humbjet nga lidhjet e paligjshme të cilat për këtë vit llogariten të jenë rreth 20% të prodhimit vjetor. Rrjetet shpërndarëse në sektor kërkohet që të jenë të seksionuara me zona të mbyllura të matura (DMA) në përputhje me modele hidraulike të tyre që lejojnë vlerësimin dhe kontrollin e humbjeve dhe përcaktojnë masat për zvogëlimin e tyre.

Instalimi i ujëmatësve në të gjitha pikat kyçe të prodhimit dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve mbetet domosdoshmëri për të shfrytëzuar burimet ujore sipas kërkesës për ujë dhe njëkohësisht për të faturuar konsumin real për çdo kategori të konsumatorëve.

Në analizat që ERRU bën në aplikimet për nivel të ri tarifor i kushton një vëmendje të madhe analizës mbi UPA bazuar në Bilancin e Ujit, në mënyrë që ai të paraqesë sa më realisht gjendjen e prodhimit të ujit në sisteme, si dhe të elementëve të tjerë të tij.

1.1.2 Mbulimi i Kostos Direkte të O&M dhe i Kostos Totale

Viti 2020 krahasuar me vitin 2019 ka shënuar një përkeqësim të treguesve të Mbulimit të Kostove të O&M dhe ato Totale respektivisht me 3.9% dhe 2.6%. Ky përkeqësim është rrjedhojë e rritjes së Kostove të Operim & Mirëmbajtjes me 428.6 milion lekë si dhe të Kostove Kapitale me 126.1 milion lekë. Të

ardhurat e aktivitetit janë pothuajse në nivelin e vitit 2019, me një rritje prej 87 milion lekë megjithatë kjo nuk ka ndikuar në përmirësimin e treguesit, për shkak se rritja e nivelit të kostove ka qenë më e madhe.

Tabela 5 jep të detajuara kostot e O&M dhe Kostot Totale për vitet 2019 dhe 2020 dhe diferencat për secilën prej tyre në vlerë absolute në lekë dhe në përqindje.

Tabela 5. Zërat e Kostove të O&M dhe Kostove Totale për vitet 2019 e 2020 (në 000 lekë)

Nr.	Kostot e Shërbimit UK	Viti 2019 në 000 lekë	Viti 2020			Diferenca 2020-2019 në 000 lekë	Rritja/Rënia 2020/2019 në %
			në 000 lekë	Ndaj Kostove O&M (%)	Ndaj Kostove Totale (%)		
1	Kosto e punës	3,824,243	4,300,480	45%	33%	476,237	12%
2	Kosto e energjisë së konsumuar	2,678,804	2,592,311	27%	20%	(86,494)	-3%
3	Kosto e riparim/mirëmbajtjes	374,373	499,668	5%	4%	125,295	33%
4	Kosto e shërbimeve të kontraktuara	930,163	1,001,599	10%	8%	71,436	8%
5	Kosto e materialeve kimikate	489,380	233,679	2%	2%	(255,701)	-52%
6	Kosto të tjera	816,912	914,753	10%	7%	97,841	12%
	Kostot Operim & Mirëmbajtjes	9,113,875	9,542,489	100%	73%	428,614	5%
7	Kostot e Amortizimit	2,592,402	2,595,284		20%	2,882	0%
8	Kosto financiare, taksa tatime	888,167	1,011,344		7%	123,177	14%
	Kostot Kapitale	3,480,569	3,606,628		27%	126,059	4%
	Kostot Totale	12,594,444	13,149,117		100%	554,673	4%

Konstatohet se rritja e kostove të O&M është më e lehtë krahasuar me rritjen e kostove për vitin 2019, e cila ka qenë 11%. Për vitin 2020 Kostot e O&M janë rritur me rreth 5%, ose në vlerën 428,614 milion lekë. Pjesa më e konsiderueshme e rritjes së kostove të O&M i përket UK Tiranë me rreth 91 milion lekë, UK Shkodër me rreth 62.5 milion lekë, UK Durrës me 53.9 milion lekë dhe UK Berat-Kuçovë me 53.8 milion lekë.

Me rritje konstatohen të gjithë zërat sintetik të kostove me përjashtim të Kostos së Energjisë së Konsumuar, e cila ka rënie me 3% dhe Kostos së Materialeve dhe Kimikateve e cila ka rënie të konsiderueshme me 52%.

Rritje të konsiderueshme ka shënuar zëri “Kosto e Punës” me +476.2 milion lekë, “Kosto e Riparim Mirëmbajtjes” me +125.3 milion lekë si dhe “Kosto të Shërbimeve të Kontraktuara” +71.4 milion lekë.

Me rritje paraqitet edhe zëri “Kosto të Tjera” (+97.8 milion lekë) në të cilin shoqëritë përfshijnë kostot të cilat nuk janë të pasqyruar në zërat e tjerë të cituar më lart, si kostot për pagesat rregullatore dhe detyrime të prapambetura ndaj ERRU, SHUKALB-it, Këshillave të Administrimit, tarifrat ndaj Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, kostot për nxjerrjet jashtë përdorimit, vendimet gjyqësore etj.

Në detaje analiza për secilin zë të kostos të paraqitur në Tabelën 5 jepet si më poshtë:

Kosto e Punës Sektori për vitin 2020 e ka zhvilluar aktivitetin me një staf prej 8,425 punonjësish (punonjësit e vet dhe nënkontraktorët) nga 8,212 punonjës që janë raportuar në vitin 2019, pra me një rritje prej 213 punonjës.

Shoqëritë që kanë rritur ndjeshëm numrin e punonjësve janë UK Vlorë me 65 punonjës, UK Kamzë me 50 punonjës, UK Sarandë me 48 punonjës, UK Kavajë me 26 punonjës etj.

Nevoja për shtimin e numrit të punonjësve vjen si rezultat i riorganizimit të shoqërive UK në përputhje me reformën, pasi zonat rurale më parë administroheshin nga vetë ish komuna. Gjithashtu rritja e numrit të tyre vjen edhe për shkak të specifikave të operimit dhe ofrimit të shërbimit, zgjerimit të zonave të shërbimit, zbatimit të projekteve të ndryshme UK apo edhe për shkak të garantimit të sigurisë së veprave me personel roje.

Nga ana tjetër janë shumë shoqëri që kanë reduktuar stafin operues si UK Krujë me 16 punonjës, UK Cërrik me 14 punonjës, UK Dibër me 10 punonjës etj.

Në përgjithësi, sektori vazhdon të jetë i mbingarkuar me staf të pajustifikuar. Lidhur me këtë tregues, për secilën shoqëri kërkohet të analizohet hollësisht numri i punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune. ERRU analizon në mënyrë të detajuar veçanërisht në rastet kur shoqëritë aplikojnë për nivel të ri tarifor.

Në total, rritja e raportuar e numrit të stafit, por edhe rishikimi i nivelit të pagave ka sjellë rritjen e Kostove të Punës me rreth 476.2 milion lekë në vit.

Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafet menaxhuese të shoqërive UK pasi kostot e punës zënë 45% të kostove operacionale në sektor. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

Kosto e Shërbimeve të Nënkontraktuara Këtu përfshihen shpenzime të tjera për shërbimet e kontraktuara që kryhen nga të tretët, por kostot për shërbimin e rojeve nga nënkontraktorët zënë pjesën më të madhe të tyre. Shoqëritë janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për sigurinë e komponentëve të furnizimit me ujë, si depo, stacione pompimi, puse etj., të cilët konsiderohen si objekte me rëndësi strategjike për ruajtjen e sigurisë së shëndetit të popullsisë, kështu shërbimi i rojeve përveçse me punonjësit e vet ka filluar të kryhet me nënkontraktorë gjithmonë e më shumë duke i rritur kostot e këtij shërbimi nga viti në vit.

Në vitin 2020 kosto e shërbimeve të nënkontraktuara për sektorin UK është rritur me 71.4 milion lekë krahasuar me 2019. Kostot më të larta për këtë shërbim i zë UK Tiranë me 66% të totalit të tyre, ndërsa vlerën më të madhe të rritjes së kostove për shërbimet e nënkontraktuara e ka UK Lushnje, e cila e ka rritur këtë kosto me 23.7 milion lekë krahasuar me 2019.

Siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme legjislativi për garantimin e sigurisë së objekteve të rëndësishme të veçantë duhet rishikuar për të parashikuar edhe zgjidhje alternative teknike apo logjistike.

Kosto të Tjera. Në kostot e tjera shoqëritë raportojnë detyrimet ndaj ERRU, SHUKALB-it, pagesat e këshillave të Administrimit, tarifatat ndaj Agjencisë së Baseneve për përdorimin e ujit nga Basenet, ekspertë kontabël, shpenzime për penaltete dhe gjoba, shpenzime për konsulencë si dhe të tjera kosto që nuk kategorizohen në zërat e tjerë sintetik të kostove. Kostot e Tjera janë rritur me rreth 97.8 milion lekë krahasuar me kostot e vitit 2019. Rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2019 ka shënuar UK Tiranë (59 milion lekë), UK Berat-Kuçovë (14.8 milion lekë), UK Fier (12.3 milion lekë) etj.

Konstatohet se, krahasuar me raportin e një viti me parë, ritmi i rritjes për këtë kosto është reduktuar në 7% nga 46% që ka qenë.

Kosto e Energjisë Elektrike Kostot e energjisë elektrike zënë rreth 27% në totalin e kostove të O&M. Rreth 78% të kostove të energjisë i zënë 14 shoqëritë e Grupit të I-rë, ku peshën më të madhe e zë UK Durrës me rreth 33% të kostove të këtij grupi ose rreth 26% të totalit të kostove të energjisë së sektorit.

Kostot e energjisë për vitin 2020 për shoqëritë raportohen rreth 86.5 milion lekë më të ulëta se viti 2019, kryesisht për shkak të investimeve të kryera në instalimin e pompave të reja me rendiment të lartë apo matësve në prodhim dhe atyre individuale, të cilat kanë ndikuar në reduktim të kostove për m³ ujë të prodhuar. Në vlerë absolute, me rënie të konsiderueshme të kostove të energjisë janë UK Tepelenë (30 milion lekë), UK Tiranë (27.4 milion lekë), UK Kavajë (24.6 milion lekë), UK Libohovë (18 milion lekë), UK Elbasani (12.4 milion lekë), UK Korçë (11.2 milion lekë) etj.

Shoqëritë që kanë rritje të koston së energjisë janë UK Lezhë (8.3 milion lekë), UK Selenicë (8.2 milion lekë), UK Cërrik dhe UK Këlcyrë me nga 5.7 milion lekë etj.

Reduktimi i kostove të energjisë për të gjithë sektorin ka ardhur si rezultat i uljes së konsumit të energjisë me 9.3 milion kwh për të treja shërbimet ose me 4.1 % ndaj totalit për sektorin. Nga shërbimi i furnizimit me ujë ndikimin kryesor e ka dhënë UK Tiranë, e cila e ka ulur konsumin e energjisë elektrike me 7.7 milion kwh.

Konstatohet se vëllimi i ujit të prodhuar me ngritje mekanike në sektor është rritur me 14.5 milion m³ që përfaqëson rreth 8.7 % të totalit të ujit të prodhuar me ngritje mekanike.

Megjithëse duket mjaft optimiste performanca e mësipërme, ku konstatohet se është rritur sasia e ujit të pompuar dhe njëkohësisht është ulur konsumi i energjisë elektrike, ky konkluzion duhet marrë relativisht me rezervë duke patur parasysh faturimet jo korrekte që kanë ndodhur nga OSHEE ndaj shoqërive UK.

Edhe shërbimi i KUN ka rënie të sasisë së energjisë elektrike të konsumuar me rreth 4.4 milion kwh si dhe ITUN me 2.5 milion kwh. Rreth 54% të kostove të energjisë për ujin e trajtuar e ka Sha UK Durrës që e ofron këtë shërbim për rreth 200 mijë banorë. Për vitin 2020 UK Durrës ka reduktuar konsumin e energjisë elektrike me 1.8 milion kwh për këtë shërbim, ndërsa për shërbimin KUN, UK Sarandë ka reduktuar energjinë elektrike me 3.6 milion kwh.

Problem për Sektorin UK vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura që shoqëritë kanë ndaj OSHEE-së, ku shuma e akumuluar ndër vite kalon vlerën e 138 milion euro ose rreth 70 milion euro pa kamat vonesat. Zgjidhja e problemit të borxheve të bartura ndaj OSHEE-së duhet të trajtohet për zgjidhje përfundimtare nga qeveria qendrore.

Kostot e Riparimeve Kostot e riparimeve gjatë vitit 2020 krahasuar me ato të vitit 2019 janë rritur me 33% ose 125.3 milion lekë.

Rritja e këtyre kostove vjen si rezultat i rritjes së numrit të defekteve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes krahasuar me vitin 2019. Rritja e kostove për këtë shërbim sidomos ka qenë evidente për grupin e parë, të cilët përbejnë 80% të këtyre kostove. Në rritjen e këtyre kostove ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e kostove të riparimeve për UK Tiranë me 55.2 milion lekë, UK Durrës me 33.6 milion lekë dhe UK Elbasan 33.2 milion lekë.

Kostot Kapitale. Kostot Kapitale përfshijnë kostot e Amortizimit dhe të Interesave të Kredive. Referuar Tabelës 5 vërehet se këto kosto zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 27% të totalit të kostove të sektorit.

Kostot e amortizimit për vitin 2020 rezultojnë 2.9 milion lekë më të larta se viti 2019, e cila kryesisht ka ardhur nga saktësimi i vlerës së aktiveve të shoqërive nëpërmjet rivlerësimeve apo kalimeve në asetet e shoqërive të rikrijuara, si edhe nga investimet e kryera dhe të pasqyruara në aktivet në bilanci të shoqërive për të cilat është llogaritur amortizimi i vitit.

Me rritje të konsiderueshme me 123.2 milion lekë rezultojnë dhe kostot financiare, ku përfshihen kostot e interesave, kostot e taksave dhe tatimeve, provizione dhe zëri kosto financiare. Kryesisht ka ndikuar rritja e kostove për tatime me 150.8 milion lekë dhe rritja e kostove për provizione me 236.2 milion lekë. Kostot për interesa për vitin 2020 janë 357 milion lekë, por ato janë akoma shumë larg detyrimit real që shoqëritë përfituese të kredive afat gjata kanë ndaj Institucioneve të Kredive. Është fakt se disa shoqëri nuk kanë mundësi financiare për të përballuar këto kosto.

Kostot Totale të aktivitetit të shoqërisë përbëhen nga Kostot Direkte të O&M dhe Kostot Kapitale. Theksohet se sektori UK vazhdon të jetë larg mbulimit 100% të Kostove Totale. Aktualisht janë 2 shoqëri, UK Tiranë, UK Kolonjë, që arrijnë që t'i mbulojnë ato në nivelin mbi 100%.

Megjithatë situata financiare e shoqërive UK është e tillë që me të ardhurat e gjeneruara mbulohen vetëm 75% të shpenzimeve totale, krahasuar me vitin 2019, ritmi i rritjes së kostove totale për sektorin ka rënë ndjeshëm nga 18% që ka qenë në 4%.

1.1.1 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të performancës së shoqërive, që lidhet me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj. Raporti ka konsideruar dy tregues në lidhje me Normën e Arkëtimit, përkatësisht Normën e Arkëtimit të Përgjithshme (NAP) dhe Normën e Arkëtimit Korente (NAK). NAP në përlogaritjen e saj përfshin të gjitha arkëtimet vjetore të kryera nga shoqëria, d.m.th. edhe debitë e vjetra, ndërsa NAK përjashton këto të fundit, d.m.th. vetëm ato që shoqëria faturon brenda atij viti kalendarik.

Tabela 35, Aneks 2 jep për secilën shoqëri NAP dhe NAK të vitit 2020 dhe krahasuar ato me vitin 2019. Norma e Arkëtimit Korente për sektorin UK për vitin 2020 raportohet në nivelin 76.6 %, pra me një rënie prej 3.2% krahasuar me vitin 2019. Ky tregues mund të mos jetë real pasi shumë shoqëri në kontabilizimin e arkëtimit korent përjashtojnë arkëtimet e vonuara në kohë, por që kryhen brenda vitit dhe i raportojnë si arkëtim i debive. NAP është më reale pasi e amortizon "gabimin" që konstatohet në NAK.

Nga shembujt pozitivë që performojnë me normë të lartë arkëtimi korent përmenden shoqëritë UK Vlorë, UK Kamëz, UK Malësi e Madhe, UK Gramsh, UK Lezhë, UK Berat-Kuçovë, UK Pogradec, UK Tiranë, UK Delvinë, UK Poliçan, UK Vorë, UK Dropull etj.

Disa nga shoqëritë që operojnë me normë arkëtimi korent të ulët janë përkatësisht, UK Lushnje, UK Durrës, UK Elbasan, UK Shkodër, UK Kukës, UK Dibër, UK Mirditë, UK Roskovec, UK Has, UK Finiq etj. Konstatohet se shumica e këtyre shoqërive kanë tendencë negative krahasuar me vitin 2019.

Norma e Arkëtimit e Përgjithshme për vitin 2020 raportohet 89.8% nga 95.8% që ka qenë në vitin 2019. Gjatë vitit 2020 shoqëritë kanë arkëtuar rreth 1.3 miliard lekë debi të prapambetura, pra rreth 300 milion lekë më pak se viti paraardhës.

Ky indikator është me rënie, megjithëse shoqëritë janë munduar ta përmirësojnë atë me marrëveshjet midis shoqërisë dhe konsumatorit, sipas së cilës arkëtohen edhe debitë e vjetra krahas faturave korente.

Në rënien e këtij treguesi ka influencuar edhe situata e vështirë ekonomike e popullsisë, e krijuar nga Pandemia Covid 19, si edhe pasojat e tërmetit të nëntorit të vitit 2019, periudhë në të cilën financat e konsumatorëve pësuan rënie të ndjeshme. Mbyllja e bizneseve, rriti papunësinë e rrjedhimisht të ardhurat ranë, duke ndikuar në mos shlyerjen e detyrimeve kontraktuale.

Vlera absolute e debisë së akumuluar në mbyllje të vitit 2020 rezulton rreth 15 miliard lekë nga të cilat rreth 80% i takon kategorisë së klientëve familjarë.

1.1.2 Niveli i Matjes

Niveli i Matjes për vitin 2020 është 79.6%, por megjithëse ka një përmirësim me 2.3% konsiderohet ende larg objektivit të përcaktuar nga ERRU. Pas riorganizimit të shoqërive me ndarjen e re administrative, ky tregues ka patur luhatjet e veta në varësi të organizimit të shoqërive, pasi shumica e konsumatorëve të zonave rurale nuk kanë instaluar matësa individual.

Në sektor, disa shoqëri kanë nivel shumë të mirë të këtij treguesi si UK Korçë, UK Lushnjë, UK Durrës, UK Sarandë, UK Librazhd, UK Peqin, UK Divjakë e shoqëri të tjera. Rreth 8 shoqëri e kanë këtë indikator nën nivelin 40%, veçanërisht nivel të ulët matje kanë UK Klos, UK Fushë Arrëz, UK Dropull, UK Kurbin, UK Bulqizë dhe UK Kavajë.

Konsumatorët që nuk kanë matësa, por faturohen aforfe me 150 litra/ditë/banor, mund të konsumojnë nën këtë normë të vlerësuar ose mund të abuzojnë, sidomos kur janë në zona rurale, ku shpesh uji përdoret për vaditje.

Shoqëritë UK për vitin 2020 kanë raportuar instalimin e 32,349 matëseve të rinj, kështu numri i lidhjeve me matës ka shkuar 717,725 lidhje nga 902,142 lidhje ekzistuese në total në të gjithë shoqëritë.

Sektori ende vazhdon të faturojë aforfe 7,447 klientë privat dhe institucione, ndërkohë që procesi i instalimit të matësave, në kategorinë klientë jofamiljarë të financuara nga vetë klientët, duhet të kishte përfunduar në zbatim të Vendimit Nr. 236, datë 10.5.1993 dhe VKM nr.96, datë 21.2.2007.

Shoqëritë me numrin më të lartë të matësave të instaluar për vitin 2020 janë UK Kamëz, (6,582), UK Tiranë (4,305), UK Kavajë (2,341) dhe UK Vlorë (2,206), por krahasuar me vitin 2019 numri i instaluar i matësave në sektor ka qenë më i vogël.

ERRU thekson vazhdimisht nevojën e instalimit të matësave në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë dhe konsumatorëve individualë, por për këtë kërkohet edhe mbështetja me financime nga qeveria qendrore. Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre, prandaj pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive dhe një element që lehtëson problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve të mbikonsumit të tij.

1.1.3 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit përfaqëson numrin e stafit të shoqërisë për 1000 lidhje UK. Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues merr një rëndësi të veçantë. Nga të dhënat, vihet re që gjatë vitit 2020 numri total i punonjësve në sektorin UK është rritur me 213 punonjës.

Treguesi i performancës së Efiçencës së Stafit për vitin 2020 është mesatarisht 5,32 staf/1000 lidhje UK. Ky tregues është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës dhe qëndron ende larg objektivit të performancës së mirë të kërkuar nga ERRU. Duke qenë se numri i lidhjeve UK gjatë vitit 2020 është rritur me 15 668 për FU dhe 29 019 për KUN, rritja e numrit të stafit nuk ka ndikuar në përkeqësimin e këtij indikator. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, i cili në disa raste rritet artificialisht me punonjës që nuk përputhen me kërkesat dhe përshkrimet e vendit të punës. Vetëm disa shoqëri, si UK Korçë, UK Tiranë, UK Kamëz, UK Lezhë, UK Vlorë, UK Elbasan etj., i plotësojnë kushtet që efiçenca e stafit të jetë në nivelet e një performance të mirë. Duke parë karakterin mjaft kompleks dhe relativ të këtij treguesi, kërkohet një analizë me e thelluar e tij sepse jo të gjitha shoqëritë e mësipërme mund të konsiderohen të suksesshme në realizimin e këtij treguesi.

Në periudha zgjedhore punësimi në shoqëritë UK bëhet edhe në baza militantizmi dhe ky mbetet një problem evident në sektor, megjithatë nevoja e rritjes së numrit të punonjësve të shoqërive UK ka ardhur edhe nga shtrirja e shërbimit edhe për zonat rurale që më parë nuk mbuloreshin me shërbim.

Në disa raste treguesi i Efiçencës së Stafit është artificialisht i lartë për shkak se shoqëritë janë të detyruara të mbajnë përgjegjësi për sigurinë e komponentëve të sistemeve të FU dhe KUN, kështu që në ato zona shërbimi ku sistemet e furnizimit me ujë kanë një numër të madh deposh, puse etj., shoqëritë paraqesin në organigramën e tyre një numër të lartë punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte. ERRU në aplikimet e shoqërive për tarifa analizon në mënyrë të detajuar këtë tregues, i cili lidhet direkt me kostot e punës, duke konsideruar vetëm kostot e justifikuara për përballimin përmes tarifës. Nga ana tjetër disa shoqëri nuk e përfshijnë numrin e punonjësve të kontraktuar për sigurinë e objekteve në llogaritjen e këtij treguesi, gjë e cila nuk i vë ato në të njëjten bazë krahasimi ndërmjet tyre.

1.1.4 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Për vitin 2020 treguesi i Vazhdimësisë së Furnizimit me Ujë për sektorin është në nivelin 13.8 orë/ditë me një përmirësim prej 0.5 orë/ditë. *Gjatë vitit 2020, në sektor, janë kryer investime fizike të suksesshme, nga Qeveria Qendrore nëpërmjet AKUM-it të cilat pritet të përmirësojnë cilësinë lidhur me këtë indikator.* Aktualisht raportohen 10 shoqëri me FU 24/7. Megjithatë disa shoqëri paraqiten me nivel të papranueshëm të këtij treguesi dhe ofrojnë deri në 6 orë/ditë ujë, të tilla janë UK Kamëz, UK Lushnjë, UK Roskovec, UK Divjakë dhe UK Kurbin. Niveli i ulët i këtij treguesi lidhet dhe me rrezikun e cënimit të shëndetit të popullatës nga mundësia e futjes në tubacione të ujërave nëntokësore të ndotura gjatë kohës që tubacionet janë bosh madje dhe shpesh herë nën presion negativ.

Qeveria qendrore nëpërmjet AKUM ka në objektivin e saj afat shkurtër që nga 66 qendra urbane në vend, 52 prej tyre do të kenë furnizim me ujë pa ndërprerje deri në fund të vitit 2021 dhe 58 deri në fund të vitit 2023. Në mbyllje të vitit 2020 janë 22 qendra urbane të cilat kanë përfutur shërbimin e furnizimit me ujë pa ndërprerje.

Theksohet se me riorganizimin e ri të shoqërive, asnjë shoqëri nuk ofron furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur si mesatare për të gjithë zonën e re të shërbimit ku përfshihet edhe zona rurale.

Referuar të dhënave të vitit 2020 krahasuar me ato të para fillimit të reformës, popullsia e zonës rurale që shërbehet nga shoqëritë UK është rritur, por kohëzgjatja e furnizimit me ujë të pijshëm për këto zona përgjithësisht është e ulët krahasuar me zonën urbane. Kjo është arsyeja që ky tregues ka pësuar rënie për shumë shoqëri UK. Për shoqëritë që ofrojnë furnizim me ujë me orar të kufizuar, ky tregues aktualisht nuk llogaritet në mënyrë analitike sipas zonave të ndara të shpërndarjes (DMA), por vetëm duke u nisur nga koha e zbrazjes së depos kur furnizon rrjetin shpërndarës, e cila nuk është metoda e duhur për matjen dhe vlerësimin e tij.

1.1.5 Mbulimi me Shërbimet e FU dhe të KUN

Treguesit “Mbulimi me FU” dhe “Mbulimi me KUN” për vitin 2020 janë pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2019 me një rënie prej 0.7% për shërbimit FU, ndërsa ka një rritje prej 0.5% për shërbimin KUN.

Shërbimi i furnizimit me Ujë ofrohet për 76.1% të popullsisë në juridiksion. Ky tregues ka një rënie të lehtë sepse popullsia në zonën e juridiksionit është shtuar me rreth 70 mijë banorë, ndërkohë që ajo e mbuluar me shërbimin e furnizimit me ujë raportohet të jetë shtuar me rreth 19 mijë banorë.

Krahasuar me objektivat e përcaktuara nga ERRU, niveli i ulët i këtij treguesi ndikohet sidomos nga disa shoqëri të Grupit të II-të dhe të III-të si UK Dibër, UK Fushë Arrëz, UK Klos, UK Librazhd, UK Pukë, të cilat kërkojnë investime fizike për të zgjeruar shërbimet e furnizimit me ujë brenda zonës së tyre të shërbimit.

Shërbimi me kanalizime i ujërave të ndotura ofrohet për 58 mijë banorë me tepër se në vitin 2019. Problemi kryesor vazhdon të mbetet Zona Rurale, në të cilën përgjithësisht nuk ka rrjet kanalizimesh dhe shkarkimet e ujërave të ndotura realizohen individualisht me gropa septike, por që lënë mjaft për të dëshiruar në drejtim të respektimit të standardeve teknike të zbatimit të tyre.

1.2 Rezultatet Financiare të Sektorit

1.2.1 Të Ardhurat nga Aktivitetet dhe Subvencionet

Tabela 36 në Aneks 3 paraqet nevojat reale për subvencione të shoqërive UK për të mbuluar kostot e O&M si dhe subvencionet e marra për vitin 2020. Në këtë tabelë të ardhurat nga aktiviteti krahasohen me Kostot e O&M dhe Kostot Totale, gjithashtu paraqitet dhe rezultati financiar vjetor i shoqërive UK me humbje ose fitim.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 9 850 milion lekë të ardhura nga aktiviteti i shoqërive UK, të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur me 86.9 milion lekë. Gjithashtu këtë vit janë rritur me rreth 20 milion lekë të ardhurat nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore.

Tabela 6 jep në mënyrë të përmblendhur të ardhurat për sektorin nga aktiviteti i shoqërive UK dhe nga subvencionet e akorduara nga qeveria qendrore nëpërmjet AKUM-it.

Tabela 6. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2019-2020 nga Aktiviteti dhe Subvencionet

Nr.	Emërtimi	Viti 2019 (në 000 lekë)	Viti 2020 (në 000 lekë)	Diferenca (në 000 lekë)
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	9,763,452	9,850,414	+86,962
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	700,000	720,000	+20,000
3	TOTALI	10,463,452	10,570,414	+106,962

Duke patur parasysh ndarjen e shoqërive në grupe, tabela 7 jep të dhënat mbi të Ardhurat e Sektorit për Vitet 2019-2020 të ndara sipas Grupeve të Shoqërive UK.

Tabela 7. Të Ardhurat e Sektorit UK për Vitet 2019-2020 sipas Grupeve të Shoqërive UK

Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2020
		Grupi i I-rë (në 000 lekë)		Grupi i II-të (në 000 lekë)		Grupi i III-të (në 000 lekë)	
1	Të Ardhurat nga Aktiviteti UK	8,395,141	8,412,695	1,238,406	1,332,503	129,906	105,215
2	Të Ardhurat nga Subvencionet	419,544	179,752	257,213	473,003	23,243	67,245
3	TOTALI	8,814,685	8,592,446	1,495,619	1,805,506	153,149	172,460
	Diferenca pa Subvencionet	+17,554		+94,097		-24,691	

Nga tabela e mësipërme vërehet se në shoqëritë e **Grupit të I-rë** të ardhurat janë rritur me 17.5 milion lekë. Shoqëri që kanë rritje të të ardhurave në Grupin e parë janë UK Vlorë (+79.3 milion lekë), kryesisht për shkak të rritjes së nivelit tarifar, UK Kamëz (+26.7 milion lekë), për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve dhe vëllimit të faturuar. Të tjera janë UK Lushnje (+11.4 milion lekë), UK Pogradec (+4.2 milion lekë) dhe UK Elbasan (+3.3 milion lekë). Të gjitha shoqëritë e tjera të këtij grupi kanë rënie të të ardhurave duke filluar nga UK Tiranë (-129.9 milion lekë), për shkak se kanë rënë të ardhurat nga shërbimet e tjera lidhje rilidhje etj., UK Fier me (-61.2 milion lekë), UK Kavajë (-68.1 milion lekë), UK Sarandë (-29.4 milion lekë), UK Korçë (-9.9 milion lekë) dhe UK Shkodër (-9.5 milion lekë).

Në **Grupin e II-të** konstatohet rritje e të ardhurave për vitin 2020 në shumën 94.1 milion lekë. Rritjen më të madhe e kanë shënuar UK Peqin, UK Mirditë, UK Krujë, UK Kukës, por gjithashtu në këtë grup janë shtuar edhe 2 shoqëri të cilat kanë rritje të të ardhurave, por që më parë kanë qenë në grupin e tretë UK Poliçan dhe UK Tropojë. Me rënie të të ardhurave në këtë grup janë shoqëritë, UK Himarë (-9.8 milion lekë), UK Vau Dejës (-8.1 milion lekë), UK Divjakë (-5 milion lekë).

Grupi i III-të të cilët zënë peshën minimale prej 1% në totalin e të ardhurave, rezulton me rënie të të ardhurave me rreth 24.7 milion lekë. Në fakt të ardhurat e vitit 2019 përfshijnë edhe dy shoqëritë UK Poliçan dhe UK Tropojë, të cilat për vitin 2020 kanë kaluar në Grupin e II-të, për shkak të rritjes së numrit të lidhjeve, për këtë arsye të ardhurat nga aktiviteti për Grupin e III-të kanë rënie. Nëse do të llogariteshin të ardhurat e vitit 2019 duke përjashtuar 2 shoqëritë, atëherë krahasimi me vitin 2020 i Grupit të III-të do të kishte rritje me 13.9 milion lekë.

Për vitin 2020 janë 10 shoqëri që i mbulojnë mbi 100% Kostot O&M nga 57 shoqëri në total. Niveli i mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes ka rënë, për shoqëritë e Grupit të I-rë nga 118% në

114%, për shoqëritë e Grupit të II-të nga 69% në 68%, ndërsa Grupi i III-të ka rritje krahasuar me vitin 2019 nga 53% në 57%.

Situata e krijuar nga Covid-19 ka ndikuar në uljen e faturimit, sidomos në zonat turistike të cilat nuk u frekuentuan me të njëjtin fluks si vitet e tjera. Gjithashtu tërmeti në nëntor të vitit 2019 ka nxjerrë jashtë funksionit shumë banesa duke ulur kështu numrin e klientëve dhe faturimet e shërbimeve UK.

Vëllimi i ujit të faturuar për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka rënë me 1.95 milion m³ ujë ndërsa vëllimi i faturuar KUN ka rënë me 1.4 milion m³. Kjo rënie nuk i përgjigjet rritjes me 29 mijë lidhje të reja të furnizimit me ujë dhe 15.6 mijë lidhje KUN, kështu që rritja e të ardhurave nga aktiviteti ka ardhur kryesisht nga ndryshimi i nivelit tarifar.

Sektori akoma nuk arrin të mbulojë krejtësisht kostot e O&M, kështu që nevoja për subvencionim mbetet e domosdoshme. Përgjithësisht diferenca e pa mbuluar e kostove të O&M me subvencione ka patur si pasojë mospagimin e faturave të energjisë elektrike të shoqërive ndaj OSHEE-së duke rritur më tej borxhin e shoqërive ndaj këtij të fundit.

Nëse vërehet shpërndarja e subvencioneve, ka devijime në alokim me vlera nën ose mbi nevojave referuar vlerave deficitare të shoqërive për të mbuluar kostot e O&M. Gjatë vitit 2020 nuk janë planifikuar dhe shpërndarë subvencione për 10 shoqëri, UK Sarandë, UK Berat-Kuçovë, UK Lezhë, UK Tiranë, UK Korçë, UK Pogradec, UK Fier, UK Himarë, UK Librazhd dhe UK Klos. Kanë përfituar 40% të totalit të subvencioneve, përkatësisht shoqëritë UK Kukës 87.3 milion lekë, UK Shkodër 82.7 milion lekë dhe UK Patos 65.9 milion lekë.

Nevoja për subvencione për Sektorin në mënyrë që të mbulohen diferencat e kostove të O&M me të ardhurat është llogaritur në vlerën prej 1,344 milion lekë (rreth 10.8 milion euro), ndërsa fondi i akorduar shoqërive si subvencion është rreth 720 milion lekë (5.8 milion euro). Gjatë vitit 2020 nga shuma 720 milion lekë, përkatësisht 435.3 milion lekë janë shpërndarë duke respektuar kriterin e alokimit në përmbushje deri 100% të nevojës reale për subvencione për çdo shoqëri UK, ndërkohë që vlera prej 284.7 milion lekë është shpërndarë për disa shoqëri UK mbi nevojën reale për mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, pra mbi 100% të nevojave të tyre për subvencione. Kjo shtesë është përdorur kryesisht për pagesat e kontributeve sociale të prapambetura në vite për punonjësit e këtyre shoqërive.

Në total nevoja e sektorit për mbulimin e kostove të operimit do të rezultonte me 624 milion lekë (1,344-720), por për shkak të shpërndarjes së fondeve është akoma më e madhe, pra në vlerën 908.6 milion lekë (284.7+624). Në të ardhmen duhet t'i kushtohet një vëmendje e shtuar zbatimit të kriterëve në shpërndarjen e subvencioneve. Shoqëritë kryesore që kanë marrë më tepër fonde se nevojat janë UK Kukës, UK Tropojë, UK Poliçan etj.

Tabela 36 në Aneksin 3 jep një pasqyrë të detajuar të nevojës për subvencione për vitin 2020, si dhe alokimin (shpërndarjen) e realizuar praktikisht gjatë vitit për çdo shoqëri UK.

1.2.2 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK

Investimet nga Buxheti i Shtetit dhe Donatorët

Nevojat për investime në sektorin UK janë evidente, megjithëse ato kanë qenë vazhdimisht në rritje nga qeveria qendrore. Investimet në sektorin UK mbeten akoma nën nivelin e duhur për të arritur objektivat e Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, si dhe në përmbushje të kërkesave të Direktivës Evropiane për ujin e pijshëm dhe për ujërat e ndotura.

Investimet fizike në sektorin UK, referuar Master Planit Kombëtar për këtë fushë të projektuar deri në vitin 2040 rezulton që të jenë rreth vlerës së 5 miliard Euro. Për përmbushjen e këtyre kërkesave kërkohej rreth 200 milion Euro/vit duke patur parasysh projektimin e tyre në 25 vite.

Mënyra e synuar e financimit të nevojave fizike të sektorit përcaktohet në draft Strategjinë e Financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve nëpërmjet sistemit të 3T-ve, përkatësisht nga Taksat (buxheti i shtetit), Transferta (financimi i donatorëve), si dhe nga Tarifat (faturat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga konsumatorët).

Theksohet fakti se në kuadër të vazhdimësisë së reformës në sektor qeveria qendrore e ka patur në fokus të vazhdueshëm kontributin në rritje nga buxheti i shtetit për investimet në fushën e ujësjellës kanalizimeve.

Projektet e planifikuara në buxhetin e AKUM për periudhën 2020-2023 janë në vlerën e 22.23 miliard lekë ekuivalente me rreth 179.3 milion euro (përfshirë TVSH), nga të cilat rezulton se deri në mbyllje të vitit 2020 janë financuar rreth 4.4 miliard lekë ose ekuivalente me 36 milion euro. Gjithashtu në sektor për vitin 2020 janë financuar rreth 16.9 milion euro nga burime të huaja (KfW & SECO) në formë kredie dhe grante. Financimet e huaja kanë qenë kryesisht përmes programit Infrastruktura bashkiake III-IV që përfshijnë shoqëritë UK Librazhd, Lushnje, Gjirokastrë dhe Kamëz.

Referuar tabelës nr. 8 të mëposhtme vlera totale e financuar në sektorin UK për vitin 2020 është 53 milion euro.

Tabela 8 paraqet në mënyrë të përmblendhur investimet e planifikuara për tu financuar nga AKUM dhe burimet e huaja për periudhën 2020-2023 si dhe vlerën e financuar prej tyre deri në mbyllje të vitit 2020. Gjithashtu një listë e detajuar e të gjithë projekteve të planifikuara dhe të përfunduara gjatë vitit 2020 si dhe atyre në proces me financim nga buxheti i shtetit dhe ai i huaj jepet në Tabelën 40, Aneks 7.

Tabela 8. Investimet e planifikuara në sektorin UK financuar nga AKUM dhe nga burime të huaja për periudhën 2020-2023.

Përshkrimi	Vlera Totale e Investimit 2020-2023 (Lekë)	Vlera e Financuar për Vitin 2020 (Lekë)
Investime nga AKUM	18,531,262,514	3,706,252,502
Investime të Huaja	1,744,917,279	1,744,917,279
TVSH	4,055,235,959	1,090,233,955
TOTALI	24,331,415,752 (eq. 196 milion euro)	6,541,403,736 (eq. 53 milion euro)

Burimi: AKUM

Investimet më të mëdha, janë planifikuar kryesisht në ujësjellës, kjo lidhet me objektivin afat shkurtër që ka ndërmarrë qeveria qendrore ku përmes investimeve nga AKUM synohet të ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë pa ndërprerje për 58 qendra urbane, nga 66 të tilla deri në vitin 2023, projekt ky që ka filluar të zbatohet me intensitet që në vitin 2018.

Ajo që vihet re nga tabela e investimeve të planifikuara në buxhetin e AKUM e cila jepet në Tabelën 40, Aneks 7 është shtrirja e tyre e gjerë e cila përfshin të gjithë qarqet dhe bashkitë e vendit me një impakt përfitimi për rreth 1,516,000 banorë ku vetëm nga investimet e mbyllura në vitin 2020 janë përfitues rreth 654,000 banorë. Gjithashtu përveç investimeve në qendrat urbane për arritjen e furnizimit me ujë 24/7 vihet re që një pjesë e mirë e tyre përfshijnë edhe zonat rurale ku sigurisht edhe nevojat për investime janë më të mëdha për arritjen e standardeve të njëjta të shërbimit në të gjithë territorin e vendit.

Deri në mbyllje të vitit 2020 si rezultat i investimeve të kryera rezulton të kemi furnizim me ujë pa ndërprerje (24 orë) për 22 qendra urbane (qytete), përkatësisht **Fushë Arrëz, Pukë, Vau Dejës, Koplik, Lezhë, Rrëshen, Tropojë, Krujë, Cërrik, Peqin, Korçë, Pogradec, Maliq, Bilisht, Kolonjë, Poliçan, Fier, Konispol, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyre dhe Përmet.**

Duhet theksuar se investimet e planifikuara në drejtim të kanalizimeve mbeten akoma një sfidë për tu arritur në të ardhmen pasi mbulimi i sektorit me kanalizime në rang kombëtar mbetet akoma shumë i ulët në masën e 51.5 %.

Akoma financimi aktual në sektor nuk i përgjigjet nevojave reale në përmbushje të tre Direktivave Evropiane për Ujin e Pijshëm dhe Ujërat e Ndotura*, ku vendi ynë synon të hapë së shpejti negociatat për aderimin në Komunitetin Evropian.

* *Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian (Direktiva e Politikave të Ujit).*
Direktiva 98/83/EC (Direktiva e Ujit të Pijshëm);
Direktiva 91/271/EEC (Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura)

1.3 Reforma në Sektor dhe Nevoja për Agregim

Sektori UK nuk e ka përfunduar ende riorganizimin sipas reformës edhe pse tashmë kanë kaluar 5 vjet nga miratimi i VKM -së Nr.63, date 27.01.2016, për reformën në sektorin UK. Shoqëritë ekzistuese dhe ato të reja të krijuara, vazhdojnë të kenë vështirësi në drejtim të procesit të inventarizimit, vlerësimit, regjistrimit të aseteve dhe më pas regjistrimit të tyre në QKB për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës nga ish komunat si dhe të vështirësive në përmbushje të kërkesave të kapaciteteve të stafëve të tyre.

Gjithashtu një element tjetër shumë problematik është pajisja me Akt Miratime Higjieno Sanitare përfshirë dhe zonën e shtuar rurale pas riorganizimit. Kjo ka ardhur kryesisht sepse shoqëritë kanë zgjeruar zonën e shërbimit me zona shtesë rurale, që kanë asete mjaft të amortizuara të sistemeve të furnizimit me ujë. E njëjta problematikë është evidentuar edhe tek shoqëritë e reja të krijuara rishtas në sektor, si UK Pustec, Kamëz dhe Klos.

Në vijim të ndarjes sipas reformës, aktualisht të gjitha shoqëritë UK operojnë dhe ofrojnë shërbimin në të gjithë territorin administrativ të bashkive përkatëse, por jo të gjitha kanë arritur të plotësojnë kërkesat sipas procesit të parashikuar të riorganizimit. Ky proces parashikon se brenda 3 muajve nga

përfundimi i tij, shoqëritë duhet të aplikojnë pranë Entit Rregullator të Ujit për licencim dhe miratimin e tarifave të reja për të gjithë zonën e re të shërbimit. Për shkak të vështirësive të përmendura më sipër mungesa e licencimit të shoqërive sipas riorganizimit është bërë pengesë edhe për aplikimin e tyre për tarifa të reja pranë ERRU-së.

Deri në mbyllje të vitit 2020, kanë përfunduar riorganizimin dhe janë licencuar nga ERRU sipas reformës 39 nga 57 shoqëri UK, të cilat në mënyrë të detajuar jepen në Tabelën 34, Aneks 1. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur nga afër dhe ka inkurajuar procesin e riorganizimit dhe të licencimit të të gjithë shoqërive UK në përputhje me riorganizimin e tyre sipas reformës duke ofruar asistencën e saj në këtë drejtim.

Gjithashtu reforma vijon të ndiqet edhe nga AKUM në zbatim të kontratave të performancës të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Bashkive bazuar në tregues performance që në mjaft raste janë të përcaktuara apriori. AKUM duhet që në bashkëpunim me shoqëritë UK përkatëse të arrijë në përcaktim të saktë të Treguesve Kryesorë të Performancës si bazë e këtyre Kontratave që kushtëzojnë shpërndarjen e subvencioneve, si dhe të incentivave për investimet fizike.

Në kuadër të nevojës për përshpejtimin e përmirësimit të gjendjes në sektor janë ndërmarrë disa hapa edhe nga Qeveria Qendrore (MIE). Kështu MIE në fund të vitit 2019 përpiloi një qasje që është përfshirë në projekt ligjin e ri për sektorin e ujit i cili akoma nuk është aprovuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi. Qasja e propozuar parashikon ndarjen në dy kategori të shoqërive UK, përkatësisht në ato që operojnë duke mbuluar kostot e O&M dhe në ato të cilat kanë nevojë për subvencionim nga Qeveria Qendrore.

Në princip, qasja propozon agregimin e detyruar të shoqërive që nuk performojnë, përndryshe nuk i kryen financimet për investime fizike dhe nuk akordon subvencionet për të mbuluar kostot e O&M. Kjo qasje përgjithësisht synon krijimin e shoqërive të agreguara gjigande që do të menaxhohet nga një staf qendror (Struktura e Kompetencave të Përbashkëta ose SKP). Gjithashtu për shoqëritë që nuk përmbushin treguesit e performancës në mënyrë të vazhdueshme qasja presupozon futjen në veprim të Operatorit të Alternativës së Fundit, i cili merr përsipër menaxhimin e shoqërisë për një periudhë të caktuar deri në përmirësimin e treguesve të performancës dhe më tej ja kthen përsëri shoqërisë së mëparshme UK.

Gjithashtu në prill të vitit 2020 me kërkesë të MIE është realizuar studimi për agregimin e sektorit i financuar nga (SECO). Në këtë studim ashtu si edhe në studimin e bëshmërisë mbi “Agregimin e Sektorit Ujësjellës Kanalizime në Shqipëri” hartuar nga PADECO Co. Ltd së bashku me Valu-Add Management Services në Qershor 2009, është konkluduar që: **“Agregimi duhet realizuar në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”.**

Agregimi në vetvete është një proces kompleks e delikat ku ndërthuren mjaft faktorë objektivë dhe subjektivë të cilat duhen marrë në konsideratë.

Në këtë kuadër janë dy opsione që diskutohen mbi rrugët e mundshme të agregimit të sektorit të cilat trajtohen më poshtë:

- 1- Sektori të agregohet në mënyrë agresive dhe të menjëhershme duke tentuar që të jetë i organizuar në nivel kombëtar me një ose 3-4 shoqëri UK.
- 2- Agregimi të realizohet në mënyrë graduale me agregime pilot të suksesshme si eksperiencia pozitive për agregimin më tej të të gjithë sektorit.

Sa i përket agregimit të menjëhershëm i të gjitha shoqërive UK ekzistuese në një ose disa shoqëri, do të përmbante në vetvete problematikat e mëposhtme:

- Agregimi i menjëhershëm dhe me detyrim i shoqërive UK do të haste në pengesa ligjore, përfshirë dhe ato për arsye politike duke rënë ndesh me Ligjin Organik për Qeverisjen Vendore ku përcaktohet qartë se pushtetet vendore janë përgjegjëse për shërbimet UK
- Një shoqëri (ose disa) e agreguar do të haste mjaft vështirësi për të menaxhuar në mënyrë të centralizuar mbi 850 sisteme të pavarura të furnizimit me ujë dhe mbi 300 burime ujore të shpërndara në të gjithë territorin e vendit.
- Shembuj të tjerë ku shërbimet e FU dhe KUN ofrohen nga një shoqëri e vetme për të gjithë vendin i hasim gjithashtu në vendet anglo sakson, si Irlandë dhe Skoci, por që kanë karakteristika mjaft të ndryshme ekonomike, të mënyrës së qeverisjes, klimatike etj.,.
- Në vendin tonë aktualisht janë në fuqi rreth 57 sisteme të ndryshme tarifash shërbimi UK që duhet të unifikohen. Vlera mesatare e faturës mujore në të 57 shoqëritë luhet nga 350 deri në 2000 lekë/muaj. Në rast se do të kalohen në një faturë të unifikuar në rang kombëtar, për mbulimin e kostove O&M aktuale në sektor duhet të aplikohet një faturë e unifikuar në vlerën prej rreth 1400 lekë/muaj.
- Metodologjia aktuale e vendosjes së tarifave nga ERRU përcakton për çdo shoqëri nën-tarifa që i referohen çdo kostoje të shërbimeve, respektivisht, për FU, për KUN, për trajtimin e ujit të pijshëm, të trajtimit të UN, si dhe atë të shitjes së ujit me shumicë. Menaxhimi i centralizuar do të kërkonte ndërtimin e një software që merr parasysh veçoritë e mësipërme.

Nëse do të pranohet alternativa e agregimit gradual ajo propozohet të realizohet duke proceduar me një ose më shumë agregime pilot të suksesshme sipas kriterit “në baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore”. Realizimi i këtij procesi kërkon paraprakisht zhvillimin e një anketë studimore (survey) në të gjitha bashkitë e vendit për të seleksionuar bashkitë ku është e mundur të kryhet një agregim në baza vullnetare.

Për seleksionimin e 2-3 shembujve pilot rekomandohet që të kihen parasysh kriteret e mëposhtme:

- a. Të synohen agregime të shoqërive brenda një qarku, ku kryetarët e pushteteve vendore mundësisht të jenë të një krahu politik dhe që mirëkuptohen ndërmjet tyre.
- b. Përgjithësisht agregimi duhet të behet ndërmjet një shoqërie financiarisht të qëndrueshme me një ose disa shoqëri me performancë financiare të dobët.
- c. Agregimi duhet realizuar me vullnet të lirë dhe shoqëruar me incentiva nga qeveria qendrore. Incentivat do të konsistojnë në kompensimin/subvencionimin për një periudhë tranzitore të deficitit financiar të kostove të O&M të shoqërisë së dobët financiare të agreguar, si dhe me incentiva investimesh fizike për zonën e re të shërbimit të shoqërisë së agreguar.
- d. Me iniciativën e qeverisë qendrore (MIE) bashkitë/shoqëritë UK të seleksionuara për agregim të suksesshëm të firmosin marrëveshjet paraprake të dakortësisë për agregim, sipas një draft modeli të parapërgatitur.

ERRU për vazhdimësinë e reformës në sektorin e ujit dhe përmirësimin e situatës në sektor i qëndron rekomandimit të saj për nevojën e agregimit të sektorit. Për këtë duhet angazhimi i fortë institucional i pushtetit qendror dhe atij vendor.

1.4 Besueshmëria dhe Saktësia e të Dhënave

ERRU, tashmë për të dytin vit radhazi ka hartuar Raportin e Performancës së shoqërive UK dhe të sektorit për vitin 2020 duke u bazuar në të dhënat që shoqëritë UK kanë dorëzuar pranë ERRU në vijim të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator Nr. 31, datë 28.06.2019 mbi “Platformën e Data Bazës për Grumbullimin e të Dhënave nga Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime”.

Iniciativa e ERRU-së për të patur bazën e saj të pavarur të të dhënave për monitorimin e shoqërive dhe hartimin e Raporteve Vjetore të Performancës së shoqërive UK, lindi si një nevojë për të mënjanuar problematikat e vazhdueshme që ERRU ka patur në vite për varësinë e të dhënave të marra nga Drejtoria e Monitorimit dhe Benchmarkut pranë AKUM si dhe për të minimizuar problemin e vërtetësisë dhe pasaktësisë së të dhënave që jo rrallë ka influencuar në konkluzionet për përmirësimin e performancës së sektorit.

Grumbullimi i të dhënave dhe kontrolli i tyre nga ERRU synon të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e përgjegjshmërisë të raportimeve të sakta të të dhënave nga ana e shoqërive UK.

Edhe për vitin 2020 gjatë përpunimit të të dhënave tekniko-ekonomike rezultoi se me gjithë përpjekjet e ERRU në asistencën e dhënë ndaj shoqërive UK si në takime me drejtuesit dhe personat kyç të shoqërisë ashtu edhe në komunikimet e shpeshta telefonike dhe elektronike me to për plotësimin dhe raportimin e të dhënave, ***besueshmëria dhe saktësia e tyre mbetet akoma një sfidë për sektorin UK.***

Konstatohet jo rrallë se të dhënat e raportuara nga shoqëritë pranë ERRU-së nuk përputhen gjatë verifikimeve të Bilanceve Financiare, Bilanceve të Ujit, apo kur ato aplikojnë për tarifa të reja.

Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen me vlerësime dhe jo me instrumenta matëse, në mënyrë empirike kryesisht për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo sjellë si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura të rezultojë me shkallë relativisht jo të vogël pasaktësie.

Pasaktësi ka gjithashtu edhe në raportimet që bëjnë shoqëritë në drejtim të arkëtimit të detyrimeve korente dhe atyre të prapambetura mbi bazën e të cilave llogaritet treguesi Norma e Arkëtimit.

Nisur nga faktorët e mësipërm për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave është treguar mjaft kujdes në kryerjen e analizës së të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij atë pjesë të të dhënave që nuk ka një bazë justifikimi për të eliminuar vlerësimet e gabuara mbi performancën e sektorit në përgjithësi, si dhe të secilës shoqëri UK në veçanti dhe në mjaft raste edhe duke i verifikuar ato në terren aty ku gjykohet se është e nevojshme.

Sigurisht gjatë vitit 2020 për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, verifikimi në terren i të dhënave ka qenë praktikisht minimal, prandaj garantimi i saktësisë deri në një nivel të caktuar i të dhënave të grumbulluara është realizuar kryesisht përmes komunikimeve telefonike dhe e-mail me shoqëritë UK.

ERRU e ka në fokus përmirësimin e besueshmërisë së bazës së të dhënave dhe është duke përfshirë në metodologjinë re të tarifave një kapitull të veçantë vlerësimi klasifikimi të saktësisë së të dhënave që raportojnë shoqëritë kur aplikojnë për tarifa të reja. Metodologjia jep gjithashtu dhe rrugët dhe mënyrën e rritjes së saktësisë së të dhënave që duhet zbatuar nga stafi i shoqërive për të rritur përgjegjësinë e tyre në këtë drejtim.

2 Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime

2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjetllës kanalizime është i bazuar në 9 tregues kryesorë të performancës (Norma e Arkëtimit Korente dhe ajo Totale përmbledhen në një tregues) të miratuara nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Duke patur parasysh nevojën për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare, në përzgjedhjen e TKP përparësi u është dhënë atyre treguesve që vlerësojnë situatën ekonomike të shoqërive, kapacitetet aktuale menaxhuese si dhe shërbimin ndaj konsumatorëve.

Nëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimet më të rëndësishme të performancës së operatorëve që tregon dhe nivelin e cilësisë së ofruar të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Të gjitha shoqëritë UK raportojnë të dhënat për zonën e shërbimit sipas reformës edhe pse kemi akoma 18 shoqëri të pa licencuara nga ERRU në përputhje me reformën deri në fund të vitit 2020. Treguesit Kryesorë të performancës të llogaritura për 57 shoqëritë krahasohen me ato të viti paraardhës sepse është i dyti vit që ERRU disponon të dhënat e saj pranë sektorit të monitorimit.

Metodologjia e përdorur në këtë raport performance mbetet e njëjtë, si për ndarjen në grupe të shoqërive, ashtu dhe në vlerësimin e treguesve të tyre. Tabela 9 jep tre grupimet e shoqërive UK sipas madhësisë (numrit të lidhjeve).

Tabela 9. Grupimet e Shoqërive Sipas Numrit të Lidhjeve

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup	Numri i shoqërive që do të analizohen në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjetllës kanalizime	14	14
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjetllës kanalizime	34	34
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjetllës kanalizime	9	9

Burimi i Informacionit ERRU

Për vitin 2020 ka një ndryshim në grupet e renditjes së shoqërive krahasuar me vitin paraardhës, bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, dy shoqëri përkatësisht UK Poliçan dhe UK Tropojë janë përfshirë në Grupin e II-të për shkak të shtimit të numrit të lidhjeve në përputhje me këtë kategori. Në detaje numri i lidhjeve për çdo shoqëri në secilin grup jepet në Tabelën 10

Tabela 10. Numri i lidhjeve për çdo Shoqëri sipas Grupimeve

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			Grupi 2 (vazhdimi)		
UK	Tiranë	254,796	U	Bulqizë	5,349
UK	Durrës	89,129	UK	Malësi e Madhe	5,070
UK	Vlorë	57,239	UK	Tepelenë	4,801
UK	Elbasan	39,878	UK	Përmet	4,770
UK	Fier	37,868	UK	Dropull	4,652
UK	Shkodër	32,038	UK	Vorë	4,514
UK	Korçë	29,091	U	Selenicë	4,243
UK	Berat -Kuçovë	29,088	UK	Kolonjë	4,241
UK	Kavajë	25,398	UK	Ura Vajgurore	4,146
UK	Lushnje	22,989	U	Peqin	3,991
UK	Sarandë	21,595	UK	Tropojë	3,928
UK	Kamëz	20,075	UK	Vau Dejës	3,764
UK	Lezhë	18,690	UK	Skrapar	3,459
UK	Pogradec	17,585	UK	Roskovec	3,151
			UK	Delvinë	3,122
			UK	Mirditë	3,117
			UK	Poliçan	3,002
Grupi 2			Grupi 3		
UK	Maliq	10,233	UK	Finiq	2,746
UK	Gjirokastrë	10,208	U	Konispol	2,313
UK	Devoll	9,088	U	Klos	1,840
UK	Dibër	8,746	UK	Pukë	1,794
UK	Cërrik	7,572	UK	Këlcyrë	1,743
UK	Belsh	7,220	U	Has	1,580
UK	Kurbin	7,127	UK	Libohovë	1,522
UK	Kukës	6,978	UK	Fushë – Arrëz	750
UK	Librazhd	6,797	UK	Pustec	736
UK	Mat	6,675			
UK	Divjakë	6,405			
UK	Krujë	6,331			
UK	Himare	6,121			
UK	Patos	5,830			
UK	Mallakastër	5,798			
U	Gramsh	5,638			
UK	Rrogozhinë	5,572			

Burimi i Informacionit ERRU

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhen arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin e performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë, gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme.

Në tabelën nr. 11 tregohen kufijtë minimal dhe maksimal të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa në grafikun 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.




Figura 1. Grafik i Analizës së TKP-ve

Tabela 11 Objektivat për TKP të Vendosura nga ERRU

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat nga ERRU		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit për 1000 lidhje) ²	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji Pa të Ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i Matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤8 orë/ditë
8 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

² Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.3 Treguesit Kryesorë të Performancës

2.3.1 Uji Pa të Ardhura

Ndikimi i drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive i Treguesit UPA është dhe arsyeja kryesore e fokusimit të rregullatorit për reduktimin e tij drejt niveleve sa më minimale të cilat janë të lidhura me mirë administrimin dhe gjendjen teknike të sistemeve që ofrojnë këtë shërbim.

“Ujë Pa të Ardhura” konsiderohet sasia e ujit që humbet nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues, shpërndarës etj).

Për vitin 2020, treguesi “Ujë Pa të Ardhura” në nivelin 65.4 % në sektor, paraqet trend përkeqësimi pasi krahasuar me një vit më parë shoqëritë kanë prodhuar në total 6% më shumë ndërkohë që faturimi total ka pësuar rënie me 2%. Në përkeqësimin e treguesit ndikuan jo vetëm faktorët “lidhje të paligjshme”, “faturimi aforfe”(sidomos për zonat rurale), “sistemet e vjetra” që ju bashkëngjiten shoqërive gjatë reformës së re territoriale, por edhe Pandemia botërore e cila izoi në tërësi turizmin dhe lëvizjen e banorëve vendas.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për Grupin e I-rë, viti 2020

Në Grupin e I-rë të përbërë nga 14 shoqëri UK, performojnë dobët, me nivelin e Ujit Pa të Ardhura nga 50-80%, 10 shoqëri UK. Me nivel të humbjeve nën kufirin 30-50% paraqiten shoqëritë UK Lezhë 38.03%, UK Pogradec 39.81% dhe UK Sarandë 48.46%.

Me performancën më të mirë, për shumë vite radhazi, spikat shoqëria UK Korçë me 30.81%. Ndonëse në nivele jo të larta, përmirësim të treguesit paraqesin UK Elbasan (-2.51%), UK Sarandë (-2.14%), UK Berat -Kuçovë (-1.24%) dhe UK Lushnje (-0.25%).

Prodhimi i pa bazuar në kërkesën për ujë ka influencuar në përqëndrimin e nivelit UPA për UK Kavajë e cila ndonëse ka rënie të faturimit për ujin e shitur me shumicë me mbi 1 milion m³, prodhimi vjetor nuk ka pësuar rënie. Përqëndrim të treguesit paraqesin shoqëritë UK Durrës (+5.63%), Fier (+3.61%), UK Kamëz (+2.28%), UK Pogradec (+4.41%), UK Lezhë (+3.03%) etj.

Me nivelin më të lartë të humbjeve paraqitet UK Vlorë 79.05% dhe UK Durrës 79.53%.

Shoqëria UK Durrës ndonëse ka rritur prodhimin me 9.647 milion m³, sasia e ujit të faturuar nuk ka pësuar rritje të ndjeshme. Përqëndrimi i treguesit ka ardhur si pasojë e rritjes së sasive të ujit që humbet në sistemin e furnizimit dhe kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes (sipas B. Ujit 2020).

Për ecuri më të mirë në grup paraqiten UK Sarandë (-15.54%), UK Berat-Kuçovë (-5.94%) dhe UK Lushnje (-1.25%).

Tabela 12. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Elbasan	UK	76.80	74.29	-2.51
2	Sarandë	UK	50.60	48.46	-2.14
3	Berat - Kuçovë	UK	72.30	71.06	-1.24
4	Lushnje	UK	74.00	73.75	-0.25
5	Shkodër	UK	69.70	69.83	0.13
6	Korçë	UK	30.60	30.81	0.21
7	Vlorë	UK	78.00	79.05	1.05
8	Tiranë	UK	60.20	61.84	1.64
9	Kamëz	UK	61.50	63.78	2.28
10	Lezhë	UK	35.00	38.03	3.03
11	Fier	UK	72.30	75.91	3.61
12	Pogradec	UK	35.40	39.81	4.41
13	Durrës	UK	73.90	79.53	5.63
14	Kavajë	UK	39.50	62.41	22.91

Grupi 2 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për Grupin e II-të, viti 2020

Shoqëritë e Grupit të II-të, në të cilat niveli i matjes për ujin e prodhuar dhe të faturuar është në nivele të pakënaqshme, Treguesi UPA i paraqitur grafikut në figurën 3, paraqitet me luhate në nivele të larta. Kjo situatë është krijuar pasi shumë shoqëri ende nuk ushtrojnë kujdesin e duhur për të mbajtur nën monitorim sistemet e furnizimit për të përfutur një situatë më reale mbi prodhimin, faturimin dhe gjithë komponentët që përbëjnë në total ujin që nuk gjeneron të ardhura. Domosdoshmëria për të hartuar Bilancet e Ujit bazuar në vëzhgime dhe matje ditore gjatë gjithë periudhës vjetore mbetet një nga problemet kryesore të pazgjidhura.

Gjatë vitit 2020, kanë performuar nën kufirin e performancës së mirë shoqëritë Belsh (23.075%), Kolonjë (24.39%), Devoll (26.86%) dhe Tropojë (28.88%).

Performuan dobët nën kufirin 30-50% të Benchmarking 13 shoqëri UK, pjesa e mbetur performojnë me nivel të UPA mbi 50%. Përkeqësim të treguesit vërehet në shoqëritë UK Selenicë (+32.81%), Dropull (+22.87%), Himarë (+20.04%), Kukës (+13.25%) etj.

Me nivelin më të lartë të Ujit Pa të Ardhura paraqiten UK Selenicë (82.91%), UK Himarë (74.44%), UK Krujë (69.69%), UK Cërrik (68.61%), UK Roskovec (64.3%) etj.

Për ecurinë më të mirë gjatë dy viteve të fundit spikasin UK Tropojë, UK Tepelenë, UK Bulqizë, UK Kolonjë, UK Librazhd etj., ndonëse këto nivele për ndonjë nga shoqëritë janë të pabesueshme si rezultat i raportimeve jo korrekte në vite.

Më poshtë në tabelën 13, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për dy vitet e fundit për Grupin e II-të

Tabela 13. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Tropojë	UK	56.4	28.88	-27.52
2	Tepelenë	UK	57.1	34.31	-22.79
3	Bulqizë	U	65.6	43.46	-22.14
4	Kolonjë	UK	39	24.39	-14.61
5	Librazhd	UK	64.7	53.18	-11.52
6	Kurbin	UK	64.2	54.14	-10.06
7	Patos	UK	59.9	51.67	-8.23
8	Përmet	U	44	37.72	-6.28
9	Mallakastër	UK	64.5	59.08	-5.42
10	Peqin	UK	67.6	63.16	-4.44
11	Maliq	UK	40.3	37.56	-2.74
12	Dibër	UK	60.5	57.79	-2.71
13	Skrapar	UK	54.4	51.91	-2.49
14	Delvinë	UK	45.6	43.19	-2.41
15	Rrogozhinë	UK	63.3	62.22	-1.08
16	Gramsh	U	39.6	38.6	-1
17	Mirditë	UK	47.6	47.71	0.11
18	Cërrik	UK	68.4	68.61	0.21
19	Vorë	UK	65.3	66.15	0.85
20	Ura Vajgurore	UK	57.2	58.47	1.27
21	Divjakë	UK	41	42.61	1.61
22	Mat	UK	44	45.88	1.88
23	Gjirokastër	UK	44.4	47.9	3.5
24	Roskovec	UK	60	64.3	4.3
25	Poliçan	UK	41.2	46.09	4.89
26	Devoll	UK	20.9	26.86	5.96
27	Malësi e Madhe	UK	46	54.31	8.31
28	Krujë	UK	60.8	69.69	8.89
29	Belsh	UK	12.9	23.07	10.17
30	Vau i Dejës	UK	46.7	58.38	11.68
31	Kukës	UK	21.3	34.55	13.25
32	Himarë	UK	54.4	74.44	20.04
33	Dropull	UK	25.9	48.77	22.87
34	Selenicë	U	50.1	82.91	32.81

Grupi i III-të i Shoqërive

Në Grupin e III-të të shoqërive, performojnë mbi kufirin e dobët të performancës shtatë shoqëri; UK Pukë 78.48%, UK Finiq 77.45%, UK Këlcyrë 76.78%, UK Fushë Libohovë 71.98% etj. Me nivelin më të ulët të treguesit UPA paraqitet UK Klos 19.66% ndërsa nën nivelin e dobët 30-50% të Benchmarkut performon vetëm UK Konispol 36.42%.

Gjatë këtij viti, përmirësim i Treguesit UPA vërehet në UK Fushë Arrëz (-18.33%), UK Konispol (-13.98%), UK Klos (-9.84%), UK Finiq (-4.95%) si dhe UK Këlcyrë (-3.32%).

Performanca për vitin 2020

Grupi 3 - Uji pa të Ardhura (%)




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për Grupin e III-të, viti 2020

Tabela 14. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Fushë Arrëz	UK	70.20	51.87	-18.33
2	Konispol	U	50.40	36.42	-13.98
3	Klos	U	29.50	19.66	-9.84
4	Finiq	UK	82.40	77.45	-4.95
5	Këlcyrë	UK	80.10	76.78	-3.32
6	Has	U	56.80	58.86	2.06
7	Pukë	UK	62.50	78.48	15.98
8	Pustec	UK	42.00	58.76	16.76
9	Libohovë	UK	26.30	71.98	45.68

Krahasimi i të dhënave për dy vitet e fundit paraqet trend në përmirësim të treguesit UPA për shoqëritë UK Poliçan, UK Tropojë si dhe UK Pukë. Vështirësitë në hartimin e Bilancit të Ujit, raportimet jo korrekte në vlerësimin e ujit të prodhuar në vite, bëjnë të pabesueshëm nivelin e UPA dhe trendin e tij për shoqëritë UK Pustec dhe UK Libohovë

Përfundime

- Analiza e kryer për treguesin UPA në rang sektori për vitin 2020, tregoi përkeqësim të tij në nivelin 1.7%. Krahësuar me një vit më parë, të gjitha shoqëritë së bashku kanë prodhuar 18,084 mijë m³ ujë më shumë. Ndonëse numri i lidhjeve me ujin është rritur me 15,667 lidhje, volumi i faturuar ka pësuar rënie me 2,152 mijë m³. Në përkeqësimin e treguesit ndikuan faktorët e tërmetit të fund vitit 2019 dhe pandemisë COVID 19, për shkak të të cilave nuk janë faturuar mjaft konsumatorë familjarë që iu shkatërruan banesat, si dhe rënia e konsumit nga bizneset për shkak të izolimit dhe kufizimeve përkatëse të imponuara.
- Niveli i Ujit Pa të Ardhura për vitin 2020 është 65.4%, performojnë nën kufirin 30% të performancës së mirë gjashtë shoqëri UK, 17 prej tyre performojnë brenda kufirit 30-50% dhe pjesa e mbetur mbi kufirin 50%.
- Niveli i lartë i UPA dhe tendenca qoftë edhe e lehtë në rritje e tij mbetet shqetësim kryesor për sektorin. Hartimi i planeve të biznesit, përfshirja në to e planeve të veprimit për të reduktuar humbjet komerciale (dukshme) dhe ato teknike (reale) mbetet emergjente në shoqëritë të cilat nuk i disponojnë, apo që edhe nuk i zbatojnë ato.
- Eliminimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, përmirësimi i situatës teknike të sistemeve të vjetruara mbeten ende detyrat kryesore realizimi i të cilave do të përmirësojë jo vetëm treguesin UPA, por dhe situatën financiare të shoqërive UK.
- ERRU sugjeron të gjitha shoqëritë UK që ti kushtojnë vëmendje "Bilancit të Ujit", i cili ende nuk hartohet saktë nga shumë shoqëri, apo nuk tregohet vëmendja e duhur prej tyre. Vlerësimi i saktë i komponentëve që përbëjnë këtë bilanc do të jetë pasqyra në të cilën duhet të bazohen për të hartuar planet e veprimit për të reduktuar në kohë Ujin Pa të Ardhura.
- Instalimi i ujëmatësve në të gjitha pikat kyçe të prodhimit dhe për të gjithë kategoritë e konsumatorëve mbetet domosdoshmëri për të shfrytëzuar burimet ujore sipas kërkesës për ujë dhe njëkohësisht për të faturuar konsumin real për çdo kategori të konsumatorëve.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve dhe emërimeve të duhura veçanërisht për stafin teknik, është një problem sidomos për shoqëritë e grupit të dytë dhe të tretë.

2.3.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i Kostove O&M” është treguesi që pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij, (pa kostot kapitale), tregues që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie.

Për vitin 2020, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 103,23 % nga 107.13 % që ishte në vitin paraardhës duke shënuar përkeqësim me 3.9%. Sektori ka vite që performon mirë në drejtim të mbulimit të kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes duke i mbuluar në nivelin mbi 100%, por këto dy vitet e fundit tendenca ka qenë në rënie të nivelit të këtij treguesi. ERRU konstaton se në sektor janë 10 shoqëri që kanë këtë tregues mbi 100% nga 14 që rezultojnë në vitin 2019. Më poshtë ky tregues analizohet në detaje për secilin grupim të shoqërive.

Performanca për Vitin 2020

Bazuar në kriterin e numrit të lidhjeve për klasifikimin e shoqërive, në Grupin e I-rë, bëjnë pjesë 14 shoqëritë më të mëdha, një pjesë e të cilave kanë disa vite që mbulojnë kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes mbi 100 %. Realizimi i këtij treguesi për shoqëritë e Grupit të I-rë për vitin 2020 jepet në grafikun e Figurës 5.

Grupi 1 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 5. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë, viti 2020.

Siç shihet nga grafiku, 5 nga 14 shoqëritë e këtij grupi e kanë kaluar nivelin e objektivit të synuar për performancë të mirë 100% të vendosur nga ERRU, përkatësisht: UK Korçë, UK Lezhë, UK Pogradec, UK Tiranë dhe UK Berat-Kuçovë. Krahasuar me vitin 2019 niveli i këtij objektiv ka ardhur duke u ulur pasi ishin 6 shoqëri që mbulonin Kostot O&M.

Këto 5 shoqëri me nivel të mirë performance edhe pse e kanë kaluar nivelin 100% të objektivit të këtij treguesi, kanë nivel performance më të ulët krahasuar me vitin 2019, me përjashtim të UK Korçë, e cila e ka përmirësuar këtë tregues me 35.69% si rezultat i uljes së Kostove O&M me rreth 38 milion lekë.

Në zonën e performancës së dobët vazhdojnë të mbeten, për vitin e tretë radhazi, katër shoqëri të këtij grupi dhe konkretisht UK Kavajë (41.26%), UK Lushnje (74.62%), UK Fier (78.42%) dhe UK Vlorë (73.14%). Këto shoqëri kanë përkeqësim të këtij treguesi që prej 3 vitesh, përveç UK Vlorë, e cila krahasuar me vitin paraardhës është përmirësuar me 12.34%, por gjithsesi mbetet në nivelin e performancës së dobët.

Në zonë e performancës së pranueshme (80%-100%) janë pesë shoqëri, UK Durrës, UK Kamëz, UK Shkodër, UK Elbasan dhe UK Sarandë, ku kjo e fundit konstatohet se ka pësuar një rënie të treguesit duke kaluar nga niveli i performancës së mirë në atë të pranueshmen. Kjo situatë për Grupin e I-rë ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së kostove direkte me 294 milion lekë dhe rritjes së të ardhurave nga aktiviteti me rreth 17.5 milion lekë.

Tabela 15 paraqet ecurinë e treguesit mbulimi i Kostove O&M për dy vitet e fundit.

Tabela 15. Ecuria e Treguesit Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Korçë	UK	179.20	214.89	35.69
2	Durrës	UK	86.90	99.46	12.56
3	Vlorë	UK	60.80	73.14	12.34
4	Kamëz	UK	82.30	85.11	2.81
5	Lushnje	UK	76.20	74.62	-1.58
6	Shkodër	UK	86.00	84.11	-1.89
7	Kavajë	UK	43.50	41.26	-2.24
8	Elbasan	UK	94.60	87.85	-6.75
9	Lezhë	UK	139.10	131.68	-7.42
10	Pogradec	UK	117.50	108.95	-8.55
11	Tiranë	UK	160.40	150.17	-10.23
12	Fier	UK	90.30	78.42	-11.88
13	Sarandë	UK	112.00	93.86	-18.14
14	Berat - Kuçovë	UK	136.10	111.88	-24.22

Në këtë grup, gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë pasur përmirësim 4 shoqëri. UK Korçë është përmirësuar me 35.69%, për shkak të reduktimit të kostove me 19%, UK Durrës është përmirësuar me 12.56%, UK Vlorë me 12.34% dhe UK Kamëz me 2.81%, për shkak se niveli i rritjes së të ardhurave është më i madh se niveli i rritjes së kostove.

Dhjetë shoqëritë e tjera të këtij grupi kanë shënuar rënie, ku me rënien më të lartë kryeson UK Berat-Kuçovë (-24.22%), për shkak të rritjes së kostove të punës me 33%, pasuar nga UK Sarandë (-18.14%), për shkak të uljes së vëllimit të ujit të faturuar, UK Fier (-11.88%) dhe UK Tiranë (-10.23%), për shkak të uljes së të ardhurave nga faturimi. Të tjera shoqëri janë me rënie me të lehtë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020

Referuar klasifikimit mbi numrin e lidhjeve, në grupin e dytë të shoqërive bëjnë pjesë 34 shoqëri nga 32 që ishin në vitin 2019. Evidentohen si shoqëri me performancë të mirë **pesë shoqëri** që mbulojnë Kostot O&M me mbi 100%, nga tetë shoqëri që ishin në vitin paraardhës. Sipas grafikut në vijim, shoqëria me performancën më të mirë është UK Kolonjë me treguesin mbulimi i kostove O&M në nivelin 140.49%, e ndjekur nga UK Kukës, UK Librazhd, UK Tropojë dhe UK Devoll.

Grupi 2 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 6. Mbulimi i Kostove O&M për Grupin e II-të, viti 2020

Në zonën e performancës së dobët, pra me mbulim të kostove O&M nën 80% renditen 19 shoqëri. Shoqëria me performancën më të dobët mbetet UK Patos me 22.88% të mbulimit të kostove O&M, e cila si shkak kryesor ka nivelin e ulët të tarifave. Rritja e tarifave që do të aplikohet duke filluar nga data 01.03.2021, pritet t'a përmirësojë këtë tregues në rreth 60%. Sipas grafikut nr. 6, në nivele shumë të ulëta mbulimi të kostove O&M janë dhe UK Kurbin, UK Ura Vajgurore, UK Tepelenë, UK Skrapar që si shkak kryesor kanë gjithashtu nivelin e ulët të tarifave dhe që kanë një kohë relativisht të gjatë që nuk kanë aplikuar pranë ERRU-së për tarifa të reja.

Në zonën e performancës së pranueshme, me mbulim të kostove O&M 80%-100% janë renditur 10 shoqëri, ku për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, UK Mirditë ka përmirësimin më të madh për këtë tregues me 33.76%, e ndjekur nga UK Roskovec me 29.44%, UK Përmet, UK Vorë dhe UK Bulqizë. Katër nga shoqëritë e këtij grupi që janë UK Himarë, UK Malësi e Madhe, UK Mat dhe UK Dibër krahasuar me nivelin e performancës në vitin 2019, kanë rënë nga zona e performancës së mirë me mbulimin mbi 100% të kostove OM në zonën e performancës së pranueshme.

Tabela 16. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Mirditë	UK	56.30	90.06	33.76
2	Roskovec	UK	69.40	98.85	29.45
3	Kolonjë	U	121.00	140.49	19.49
4	Tropojë	UK	88.40	107.54	19.14
5	Vau i Dejës	UK	48.30	65.42	17.12
6	Tepelenë	UK	28.50	44.75	16.25
7	Polican	UK	56.30	69.57	13.27
8	Përmet	U	75.00	86.31	11.31
9	Kukës	UK	102.30	113.43	11.13
10	Vorë	UK	80.90	89.31	8.41
11	Bulqizë	UK	88.20	95.38	7.18
12	Kurbin	UK	33.50	39.75	6.25
13	Peqin	UK	48.90	50.53	1.63
14	Delvinë	U	75.40	76.05	0.65
15	Patos	UK	22.90	22.88	-0.02
16	Cërrik	UK	67.00	66.79	-0.21
17	Krujë	UK	67.80	67.54	-0.26
18	Maliq	UK	70.80	69.38	-1.42
19	Gramsh	UK	93.30	91.59	-1.71
20	Gjirokastrë	U	95.80	94.02	-1.78
21	Mallakastër	UK	59.50	56.25	-3.25
22	Ura Vajgurore	UK	50.60	43.69	-6.91
23	Rrogozhinë	UK	60.80	53.87	-6.93
24	Belsh	UK	78.10	68.84	-9.26
25	Dibër	UK	101.60	92.03	-9.57
26	Devoll	UK	113.80	103.95	-9.85
27	Selenicë	UK	57.60	46.99	-10.61
28	Divjakë	UK	58.60	46.89	-11.71
29	Librazhd	UK	127.40	111.04	-16.36
30	Skrapar	UK	69.30	45.26	-24.04
31	Himarë	UK	117.20	90.82	-26.38
32	Malësi e Madhe	UK	115.90	88.71	-27.19
33	Mat	UK	100.10	70.44	-29.66
34	Dropull	UK	80.90	49.65	-31.25

Nga 34 shoqëri që bëjnë pjesë në grupin e dytë, raportohen 14 shoqëri që e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të Kostove të O&M në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Përmirësimin më të madh e ka shënuar UK Mirditë e cila për vitin 2020 raporton rreth 15 milion lekë të ardhura më shumë se viti 2019, duke arritur nivelin e mbulimit të kostove O&M në 90.06% për vitin 2020, nga 56.3% që ishte në vitin 2019. Përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar dhe shoqëritë UK Roskovec, UK Kolonjë, UK Tropojë, UK Vau Dejës dhe UK Tepelenë.

Gjithashtu, në këtë grup, vihet re që shoqëritë UK Devoll dhe UK Librazhd edhe pse vijnë të qëndrojnë në nivelet e mbulimit të kostove O&M mbi 100% (për vitin 2020) kanë tendencë negative të këtij treguesi. Rënia e mbulimit të kostove O&M për UK Devoll me 9.85% ka ardhur si pasojë e rritjes së nivelit të kostove mbi nivelin e të ardhurave, ndërsa rënia për UK Librazhd me 16.36% ka ardhur si pasojë e rritjes së kostove dhe uljes së nivelit të të ardhurave.

Ndërkohë, shoqëria UK Dropull ka shënuar rënien më të madhe në mbulimin e kostove O&M në Grupin e II-të në 31.25%, duke e kaluar shoqërinë nga zona e performancës së pranueshme në zonën e performancës së dobët. Rënie të konsiderueshme të këtij treguesi (dy-shifrore) kanë shënuar dhe shoqëritë UK Mat, UK Malësi e Madhe, UK Himarë, UK Skrapar, UK Librazhd, UK Divjakë dhe UK Selenicë.

Grupi i III-të i Shoqërive

Sipas klasifikimit, në bazë të numrit të lidhjeve, në Grupin e III-të bëjnë pjesë 9 shoqëri, nga të cilat vetëm UK Pukë është në zonën e performancës së pranueshme dhe shoqëritë e tjera përfshihen në shoqëritë me performancë të dobët. Këto janë shoqëritë më të vogla të sektorit, me numër lidhjesh për shërbimin e furnizimit me ujë deri në 3,000 lidhje. Edhe pse këto shoqëri kryesisht nuk arrijnë të mbulojnë kostot e punës, që konsiderohen si kosto prioritare, influenca negative e tyre në sektor është minimale. Kjo vjen si pasojë e numrit të vogël të klientëve që kanë këto shoqëri.

Performanca për Vitin 2020

Grupi 3 - Mbulimi i Kostove O&M (%)




Figura 7. Mbulimi i Kostove O&M Grupi III-të, Viti 2020

Grupi i tretë numëron në total rreth 15 mijë lidhje dhe kostot O&M të këtij grupi llogariten në rreth 2% të kostove OM të sektorit, pra mund të thuhet që performanca e këtyre shoqërive nuk ka ndikim në sektor.

Shoqëria me performancën më të dobët për këtë grup është UK Këlcyrë që mbulon vetëm 32.1% të Kostove të O&M, e cila është dhe shoqëria që ka rënien më të madhe të mbulimit të kostove O&M me 20.8%. Një rënie të ndjeshme të këtij treguesi krahasuar me vitin 2019, për grupin e tretë ka edhe UK Pustec me 17.59%.

Tabela 17. Ecuria e Mbulimit të Kostove O&M për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Libohovë	UK	25.60	53.53	27.93
2	Klos	U	43.60	65.89	22.29
3	Fushë Arrëz	UK	49.60	70.51	20.91
4	Finiq	UK	66.70	76.10	9.40
5	Konispol	U	62.40	65.48	3.08
6	Has	U	48.20	48.86	0.66
7	Pukë	UK	87.30	84.90	-2.40
8	Pustec	UK	51.40	33.81	-17.59
9	Këlcyrë	UK	52.90	32.10	-20.80

Për shoqëritë e Grupit të III-të, për pjesën më të madhe të shoqërive, treguesi i mbulimit të Kostove O&M në vitin 2020 ka pasur tendencë rritëse, krahasuar me vitin 2019, që tregon përpjekje nga këto shoqëri për përmirësim, por jo në nivelin e kërkuar për të pasur një situatë të mirë financiare. Shkak kryesor i nivelit të ulët të këtij treguesi për këtë grup shoqërisht është niveli i ulët i tarifave që aplikojnë dhe që vazhdojnë të mos aplikojnë për rritje të tyre pranë ERRU-së për arsye sociale dhe politike të pushtetit vendor.

Përfundime

- Nga analiza e treguesit “Mbulimi i Kostove O&M” për të tre grupet e shoqërive (të klasifikuara sipas kriterit të numrit të lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë) rezultojnë se niveli i mbulimit të kostove O&M për vitin 2020 është 103.2%, duke shënuar rënie me 3.9% krahasuar me vitin 2019. Ky përkeqësim ka ardhur si rezultat i rritjes së kostove të operimit dhe mirëmbajtjes me 4.7%, ndërkohë që të ardhurat janë rritur në një nivel më të ulët, me rreth 1%.
- Nga 57 shoqëri të cilat kanë raportuar të dhëna për vitin 2020, rezultojnë se 10 prej tyre kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 16 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 30 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 12 shoqëri të cilat mbulojnë më pak se 50% të kostove O&M. Këto shoqëri kryesisht i përkasin grupit të dytë dhe të tretë të shoqërive, me përjashtim të UK Kavajë që bën pjesë në grupin e parë. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot e O&M
- Mjaft prej shoqërive duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për rritje të tarifave, ndërsa një pjesë e tyre e kanë të pamundur t’i mbulojnë ato, rrjedhimisht lind nevoja për mbështetje me subvencione nga buxheti i shtetit.
- Për vitin 2020 në sektor rezultojnë 33 shoqëri me tendencën negative të këtij treguesi që përbën rreth 58% të shoqërive në sektor, por që përkeqësimi i situatës financiare të tyre kryesisht ka ardhur dhe si pasojë e pandemisë së krijuar nga Covid-19 dhe e situatës post tërmetit.
- Mbulimi i Kostove O&M është elementi bazë në propozimet e shoqërive për tarifa të reja duke argumentuar në mënyrë të detajuar kostot, si edhe ti raportojnë shpenzimet sipas qendrave të kostos për të bërë një tarifim sa më të saktë për të dy shërbimet të ndara. Detajimi i kostove shërben edhe si një element bazë për transparencën ndaj konsumatorëve.
- Nevoja për subvencione mbetet një domosdoshmëri në të ardhmen e afërt për disa shoqëri të grupit të dytë dhe ato të grupit të tretë.

2.3.3 Mbulimi i Kostove Totale

Një shoqëri që të quhet e qëndrueshme financiarisht duhet të përballojë kostot totale për shërbimet që ofron me të ardhurat e realizuara nga këto shërbime. Niveli i këtij treguesi për vitin 2020 për shoqëritë e sektorit raportohet 74.9% kundrejt 77.52% që ishte në vitin 2019.

Për këtë tregues analiza nuk është kryer sipas grupeve të shoqërive, por për sektorin në tërësi, pasi janë vetëm dy shoqëri që përballojnë kostot totale të operimit me të ardhurat nga aktiviteti, përkatësisht UK Kolonjë në nivelin 137.57% dhe UK Tiranë në nivelin 109.06%.

Në nivelin e performancës (50%-80% e mbulimit të kostos totale) raportohen 25 shoqëri, ndërsa në nivelin e performancës së mirë (mbi 80% e mbulimit të kostos totale) raportohen vetëm 9 shoqëri, dy prej të cilave e kanë nivelin e mbulimit mbi 100%.

Pjesa tjetër e shoqërive (23 shoqëri) bëjnë pjesë në brezin e performancës së dobët, me mbulimin e kostove totale deri në 50%, ku ka shoqëri me nivele minimale të mbulimit të kostove si: UK Patos (21.32%), UK Pustec (28.93%), UK Këlcyrë (30.38%), UK Kavajë (30.56%), UK Dropull (32%) dhe UK Konispol (32.88%).

Ka shoqëri ku nuk mund të mbulohen as kostot e punës, të cilat për periudhën afatshkurtër duhet të shihen me prioritet nga AKUM për subvencionim dhe investime kapitale, ndërkohë që në periudhën afat mesme të shihet mundësia e ndjekjes së strategjisë së agregimit të tyre me shoqëri të tjera.

Janë 18 shoqëri që kanë pasur tendencë pozitive (mbi 5% rritje) në drejtim të mbulimit të kostove totale me të ardhurat nga aktiviteti krahasuar me vitin 2019. Kjo tendencë varion nga 5% UK Kukës, në 26.87% UK Kolonjë. Në nivel të qëndrueshëm të këtij treguesi me luhatje nga (-2.17%) deri në 4.27% raportohen 15 shoqëri.

Tendenca negative konstatohet në pjesën tjetër të shoqërive (24 shoqëri), nga të cilat janë 15 shoqëri që raportojnë rënie të konsiderueshme të nivelit të këtij treguesi nga (-10.59%) në (-24.52%).

Në shumicën dërmuese të shoqërive konstatohen rritje të kostove totale në nivele shumë më të larta se rritja e të ardhurave nga aktiviteti UK. Kostot totale në sektor për vitin 2020 janë rritur me 554,6 milion lekë ose 4% krahasuar me vitin 2019. Në këtë rritje rreth 68%, ose 377.3 milion lekë i takon shoqërive të grupit të parë. Ndërsa, të ardhurat e sektorit kanë shënuar një rritje me rreth 1% ose në vlerë 86.9 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës ku pjesën kryesore të kësaj rritje e kanë shoqëritë e grupit të dytë me rreth 64%.

Pra, është rritja në mënyrë jo të njëtrajtshme e dy variablave “Të ardhura” dhe “Kosto totale” arsyeja pse situata e sektorit referuar këtij treguesi është përkeqësuar.

Pas riorganizimit të shoqërive sipas ndarjes administrative territoriale konstatohet se ky tregues është përkeqësuar dhe shoqëritë që tentojnë të mbulojnë kostot totale kanë patur tendencë negative.

Duhet patur parasysh që një ndikim të konsiderueshëm negativ ka dhënë dhe situata e krijuar nga Covid-19, që solli mos frekuentimin e shtëpive të dyta në zonat turistike si dhe bllokimin e turizmit në përgjithësi. Pasojat e post tërmetit gjithashtu kanë vazhduar duke ulur nivelin e faturimit dhe arkëtimit sidomos në zonat e Durrësit, Lezhës, Kurbinit, Krujës, Tiranës dhe Vorës ku nxjerrja jashtë funksionit e shumë banesave dhe pallateve ka sjellë uljen e numrit të klientëve, e si rrjedhojë dhe mos faturim të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime.

Tabela 18. Ecuria e Mbulimit të Kostove Totale

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Kolonjë	UK	110.70	137.57	26.87
2	Libohovë	UK	24.70	50.43	25.73
3	Finiq	UK	42.70	67.46	24.76
4	Tropojë	UK	60.00	80.15	20.15
5	Mirditë	UK	35.90	53.44	17.54
6	Durrës	UK	70.70	88.12	17.42
7	Devoll	U	81.00	95.69	14.69
8	Vorë	UK	76.40	88.93	12.53
9	Tepelenë	UK	22.70	33.83	11.13
10	Poliçan	UK	53.00	64.08	11.08
11	Klos	U	46.30	56.92	10.62
12	Vlorë	UK	37.90	48.09	10.19
13	Roskovec	UK	39.90	48.25	8.35
14	Cërrik	UK	58.80	66.35	7.55
15	Kamëz	UK	51.40	58.09	6.69
16	Fushë Arrëz	UK	29.20	35.56	6.36
17	Kurbin	UK	31.20	36.58	5.38
18	Kukës	Uk	72.60	77.60	5.00
19	Malësi e Madhe	UK	68.80	73.07	4.27
20	Has	U	35.30	37.59	2.29
21	Lushnje	UK	51.80	53.11	1.31
22	Vau i Dejës	UK	36.50	37.75	1.25
23	Maliq	Uk	62.50	62.94	0.44
24	Gjirokastër	UK	75.20	75.38	0.18
25	Rrogozhinë	UK	47.30	47.48	0.18
26	Korçë	UK	78.40	78.11	-0.29
27	Peqin	UK	46.10	45.79	-0.31
28	Patos	UK	21.80	21.32	-0.48
29	Gramsh	UK	77.10	76.48	-0.62
30	Shkodër	UK	49.30	48.58	-0.72
31	Krujë	U	61.10	60.31	-0.79
32	Mallakastër	U	47.40	46.09	-1.31
33	Përmet	UK	70.60	68.43	-2.17
34	Lezhë	UK	55.60	51.14	-4.46
35	Pogradec	UK	52.60	47.23	-5.37
36	Bulqizë	UK	87.50	81.70	-5.80
37	Elbasan	UK	73.10	66.97	-6.13
38	Ura Vajgurore	UK	43.30	36.52	-6.78
39	Pukë	UK	64.60	57.16	-7.44
40	Belsh	UK	73.50	65.12	-8.38
41	Fier	UK	75.00	66.49	-8.51
42	Tiranë	UK	119.00	109.06	-9.94
43	Selenicë	UK	57.40	46.81	-10.59
44	Divjakë	UK	56.00	44.98	-11.02
45	Berat - Kuçovë	UK	90.10	79.07	-11.03
46	Kavajë	UK	41.70	30.56	-11.14
47	Librazhd	UK	106.00	94.42	-11.58
48	Delvinë	UK	61.80	48.95	-12.85
49	Skrapar	UK	54.50	41.15	-13.35
50	Pustec	UK	42.30	28.93	-13.37
51	Sarandë	UK	71.80	56.45	-15.35
52	Këlcyrë	UK	46.60	30.38	-16.22
53	Himarë	UK	91.40	74.56	-16.84
54	Dibër	UK	100.20	83.36	-16.84
55	Dropull	U	54.10	32.00	-22.10
56	Mat	UK	84.90	61.51	-23.39
57	Konispol	U	57.40	32.88	-24.52

2.3.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likuiditetin e saj.

Norma e Arkëtimit varet kryesisht nga faktorë manaxherial. Në analizën e shoqërive sipas grupeve llogariten treguesi Norma e Arkëtimit Korente (NAK) që tregon arkëtimet e shitjeve të shërbimeve UK për vitin 2020, si dhe treguesi Norma e Arkëtimit e Përgjithshme (NAP) ku përfshihen dhe arkëtimet e debive përpara vitit raportues.

Për vitin 2020 NAK rezulton 76.62% kundrejt 79,7% që ishte në vitin 2019, me një rënie prej 3.18%. Kjo situatë justifikohet dhe me pamundësinë financiare të klientëve për të paguar si rezultat i impaktit negativ që ka dhënë Pandemia Covid-19 në të ardhurat e qytetarëve, si edhe nga pasojat post tërmetit të nëntorit 2019. Mbyllja e bizneseve për një periudhë të gjatë ka sjellë një rritje të papunësisë (sezonale ose jo) dhe ky efekt është reflektuar tek situata financiare e shoqërive UK.

Shoqëritë punojnë dhe për vjeljen e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma, si lidhja e akt-marrëveshjeve shoqëri - klient për pagimin e tyre me këste, krahas arkëtimit të faturave korente.

Nga debitë e prapambetura, gjatë vitit 2020 janë arkëtuar rreth 1.3 miliard lekë. Në analizën e Grupeve, fokusi është NAK pasi sa më e lartë efiçenca në mbledhjen e të ardhurave korente, aq më shumë rritet mundësia që të likuidohet debia e vjetër.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020




Figura 8. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e I-rë, Viti 2020

Për vitin 2020, në Grupin e I-rë, raportohen 5 shoqëri me performancë të mirë, pra me një normë arkëtimi korente mbi 82%, që janë: UK Vlorë (95.95%), UK Kamëz (93.29%), UK Lezhë (89.52%), UK Berat-Kuçovë (88.6%) dhe UK Pogradec 87.89%.

Në këtë grup, në brezin e performancës së dobët, me normë arkëtimi korente nën 60%, raportohen shoqëritë UK Lushnje (54.84%) dhe UK Durrës (59.28%). Këto dy shoqëri lidhur me treguesin NAK kanë shënuar rënie me rreth 10% krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë që marrim parasysh krahas pandemisë

edhe faktorin e post tërmetit për Durrësin, rënia e UK Lushnjes duket mjaft drastike dhe jo e justifikuar në këtë masë.

Pjesa tjetër e shoqërive (7 shoqëri) bëjnë pjesë në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korente 60%-82%.

Tabela 19. Ecuria e Normës së Arkëtitimit Korente për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Kamëz	UK	74.50	93.29	18.79
2	Vlorë	UK	78.20	95.95	17.75
3	Fier	UK	62.80	75.43	12.63
4	Korçë	UK	78.80	80.41	1.61
5	Pogradec	UK	87.80	87.98	0.18
6	Berat - Kuçovë	UK	89.50	88.60	-0.90
7	Lezhë	UK	90.70	89.52	-1.18
8	Tiranë	UK	84.90	81.06	-3.84
9	Kavajë	UK	78.60	74.70	-3.90
10	Sarandë	UK	78.00	72.29	-5.71
11	Lushnje	UK	64.80	54.84	-9.96
12	Durrës	UK	70.20	59.28	-10.92
13	Shkodër	UK	79.40	67.87	-11.53
14	Elbasan	UK	78.90	66.26	-12.64

Nga 14 shoqëri të analizuar, 5 prej tyre kanë shënuar përmirësim të treguesit NAK krahasuar me vitin 2019. Për vitin 2020 progresin më të madh e ka shënuar UK Kamëz me (+18.79%), UK Vlorë me (+17.75%) si dhe UK Fier me (+12.63%). Ndërsa, një pjesë e mirë e shoqërive që bëjnë pjesë në këtë grup (9 shoqëri) kanë shënuar përkeqësim të këtij treguesi, ku vlen të theksohet (rënie dyshifrore): UK Elbasan (-12.64%), UK Shkodër (-11.53%) si dhe UK Durrës (-10.92%).

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020

Grupi 2 - Norma e Arkëtitimit Korente (%)




Figura 9. Norma e Arkëtitimit Korente për Grupin e II-të, Viti 2020

Në Grupin e II-të, ku bëjnë pjesë 34 shoqëri, 13 prej tyre bëjnë pjesë në brezin e performancës së mirë, me një normë arkëtimi korente mbi 82%, ku kryeson UK Malësi e Madhe me 96.56%, UK Gramsh me 94.85%, UK Delvinë me 91.74%, UK Poliçan me 90.92%, UK Vorë me 90.82%, duke vijuar me 8 shoqëri të tjera siç tregohet dhe në grafikun e mësipërm.

Në brezin e performancës së pranueshme, me normë arkëtimi korente 60%-82%, bëjnë pjesë 17 shoqëri, duke filluar nga UK Himarë me 79.94% e duke vijuar deri tek UK Krujë me 60%. Nga këto shoqëri konstatohet se 12 prej tyre kanë pësuar rënie të këtij treguesi krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu, vihet re se pesë nga këto shoqëri kanë kaluar nga zona e performancës së mirë në vitin 2019, në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2020, që tregon për një keq menaxhim nga ana e drejtuesve të shoqërisë.

Në zonën e performancës së dobët, me normë arkëtimi korente nën 60% përfshihen 4 shoqëri, përkatësisht **UK Roskovec, UK Mirditë, UK Dibër dhe UK Kukës**

Tabela 20. Ecuria e Normës së Arkëtimimit Korente për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Delvinë	UK	64.50	91.74	27.24
2	Mat	UK	59.80	84.84	25.04
3	Cërrik	UK	60.70	82.06	21.36
4	Rrogozhinë	UK	63.00	77.84	14.84
5	Patos	U	76.50	88.65	12.15
6	Gramsh	UK	84.60	94.85	10.25
7	Divjakë	UK	60.20	69.98	9.78
8	Malësi e Madhe	UK	88.20	96.56	8.36
9	Devoll	UK	66.60	73.91	7.31
10	Bulqizë	UK	70.80	77.77	6.97
11	Skrapar	UK	75.50	79.46	3.96
12	Librazhd	UK	84.20	88.13	3.93
13	Dropull	UK	87.00	90.68	3.68
14	Maliq	UK	83.00	84.03	1.03
15	Vorë	UK	90.10	90.82	0.72
16	Dibër	UK	48.60	49.13	0.53
17	Vau i Dejës	UK	72.10	70.23	-1.87
18	Gjirokastrë	U	75.90	73.29	-2.61
19	Përmet	UK	72.50	69.06	-3.44
20	Tepelenë	UK	88.90	85.08	-3.82
21	Kolonjë	UK	75.50	70.82	-4.68
22	Mallakastër	UK	73.30	67.75	-5.55
23	Roskovec	UK	60.80	52.74	-8.06
24	Peqin	U	92.60	84.11	-8.49
25	Poliçan	UK	99.70	90.92	-8.78
26	Ura Vajgurore	UK	90.50	79.75	-10.75
27	Kurbin	UK	83.20	72.41	-10.79
28	Selenicë	UK	71.30	60.00	-11.30
29	Himarë	UK	91.80	79.94	-11.86
30	Tropojë	UK	73.90	61.12	-12.78
31	Belsh	UK	91.20	73.42	-17.78
32	Kukës	UK	60.70	34.69	-26.01
33	Mirditë	U	82.00	52.63	-29.37
34	Krujë	UK	93.10	60.00	-33.10

Referuar tabelës së mësipërme, 16 shoqëri e kanë përmirësuar treguesin e NAK krahasuar me vitin e mëparshëm, kundrejt 18 shoqërive të cilat kanë shënuar përkeqësim. Ecurinë më të mirë e kanë UK Delvinë me (+27.24%), UK Mat me (+25.04%), UK Cërrik me (+21.36%), duke vijuar me pjesën tjetër të shoqërive deri tek UK Dibër e cila ka përmirësimin më të vogël (+0.53%).

Ndërsa nga 18 shoqëri të cilat kanë rezultuar me përkeqësim të situatës për NAK, raportohen të jenë **UK Krujë me (-33.1%), UK Mirditë me (-29.37%), UK Kukës me (-26.01%)**.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020




Figura 10. Norma e Arkëtimit Korente për Grupin e III-të, Viti 2020

Në Grupin e III-të bëjnë pjesë 9 shoqëri, nga të cilat vetëm UK Konispol dhe UK Pukë janë në nivelin e performancës së mirë (mbi 82% të nivelit të arkëtimit), respektivisht me 98.52% dhe 85.38%.

Në brezin e performancës së dobët (nën 60%) përfshihen tre shoqëri, përkatësisht UK Finiq (48.78%), UK Has (53.52%) dhe UK Klos (60.67%).

Tabela 21 paraqet ecurinë e treguesit të Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të të shoqërive.

Tabela 21. Ecuria e Normës së Arkëtimit Korente për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Pustec	UK	49.90	70.17	20.27
2	Konispol	U	92.90	98.52	5.62
3	Pukë	UK	83.60	85.38	1.78
4	Klos	U	59.50	60.67	1.17
5	Fushë Arrëz	UK	68.10	67.15	-0.95
6	Libohovë	UK	71.00	66.10	-4.9
7	Has	U	58.70	53.52	-5.18
8	Këlcyrë	UK	73.50	63.05	-10.45
9	Finiq	UK	64.40	48.78	-15.62

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, në Grupin e III-të 4 shoqëri kanë përmirësuar treguesin NAK, ku UK Pustec ka rritjen më të madhe me (+20.27%). Pesë shoqëritë e tjera kanë pësuar rënie të këtij

treguesi, ku UK Finiq me (-15.62%) ka rënien më të madhe brenda këtij grupi, duke e kaluar shoqërinë në zonën e performancës së dobët për vitin 2020.

Përfundime

- Shoqëritë kanë raportuar për vitin 2020 të dhëna të ndara për secilin tregues. Gjithsesi edhe për këtë vit ekziston një marzh gabimi në lidhje me treguesin NAK pasi ka disa shoqëri që ende konsiderojnë dhe i raportojnë debitë e krijuara gjatë vitit, të cilat likuidohen nga klientët brenda vitit si shlyerje të debive të prapambetura.
- Referuar sektorit në tërësi, nga 57 shoqëri që kanë raportuar të dhëna për Normën e Arkëtimit Korente, 20 shoqëri rezultojnë në brezin e performancës së mirë (mbi 82%), 29 shoqëri në brezin e pranueshëm (60%-82%) dhe 8 shoqëri në nivelin e performancës së dobët (nën 60%).
- Për vitin 2020, vërehet se 25 shoqëri kanë shënuar përmirësim të këtij treguesi, nga 34 që ishin në vitin 2019, ndërsa pjesa tjetër e shoqërive (32 shoqëri) kanë pësuar regres gjatë vitit 2020.
- Norma Përgjithshme e Arkëtimit (NAP) për vitin 2020 ka shënuar një rënie me 6.2%. Në sektor janë 20 shoqëri që raportojnë NAP mbi 100%, që do të thotë se kanë performuar mirë për arkëtimin e debive të vjetra duke krijuar mundësinë për shlyerjen e detyrimeve që kanë ndaj të tretëve. NAP e grupit të parë raportohet 88.3%, e grupit të dytë 97.3% dhe e grupit të tretë 94.9%. Brenda secilit grup ka dhe shoqëri me normë më të ulët se mesatarja e grupit.
- Për një pjesë të shoqërive të cilat konsiderohen shoqëri të reja ose shoqëritë që janë ende në proces riorganizimi nevojitet një saktësim i mëtejshëm i situatës dhe tendencës së ecurisë për këto tregues, vlerësimi i të cilave do të kryhet rast pas rasti

2.3.5 Niveli i Matjes

Raporti i lidhjeve me matës ndaj numrit total të lidhjeve i shprehur në përqindje jep treguesin e Nivelit të Matjes. Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatorëve individuale dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë. Për vitin 2020, ky tregues është rritur 2.3% krahasuar me vitin paraardhës duke e çuar këtë tregues në nivelin 79.6 %.

Treguesi “Niveli i Matjes” është një ndër treguesit që ka patur trend në përmirësim në vite. Gjatë vitit 2020, shoqëritë UK kanë raportuar instalimin e 32,347 ujëmatësave më shumë se viti paraardhës, por përsëri nuk e kanë arritur objektivin e performancës së mirë 85 %, ekziston ende nevoja imediate për të pajisur të gjithë konsumatorët me matësa. UK Devoll paraqitet më në fund me nivel matje 100%, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Konsumatorët nuk duhet të paguajnë për sasi uji pa matje (aforfe 150 litra/ditë, banor) sepse mbart në vetvete padrejtësi dhe abuzim, kjo për faktin se shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të presupozuar, ndërkohë që një pjesë e tyre konsumojnë shumë më tepër për ujitje (shtëpi private dhe zona rurale) duke cenuar cilësinë e shërbimit në zonat e mbuluara me shërbim. Pajisja 100% me ujëmatës në të gjithë komponentët kyç të sistemeve të furnizimit me ujë, vazhdon të jetë një nga objektivat kryesor që ERRU vendos për shoqëritë, por ky proces kërkon mbështetje financimi edhe nga qeveria qendrore.

Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 85% nivel matje është larg për tu arritur nga shumë shoqëri, siç vërehet në analizën e shoqërive sipas grupeve

Grupi 1 - Niveli i Matjes (%)




Figura 11 . Niveli i Matjes Grupi I-rë, Viti 2020

Në grupin e I-rë, shoqëritë paraqesin trend në përmirësim, prej të cilave 8 shoqëri UK Korçë 99%, UK Lushnje 95.35%, UK Durrës 95.03%, UK Sarandë 94.75%, UK Pogradec 89.01%, UK Tiranë 88.84%, UK Lezhë 85.91% dhe UK Kamëz 85.14%, performojnë mbi nivelin e performancës së mirë 85%. Ndërsa gjashtë shoqëritë e tjera performojnë nën kufirin e performancës së mirë 85%.


Krahasuar me vitin 2019, përmirësim të dukshëm të treguesit raportojnë dy shoqëri, UK Kamëz (+18.84 %), UK Kavajë (+10.19 %), ndërsa shoqëritë e tjera të këtij grupi kanë rritje të lehtë deri në 4%.

Ecuria e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 22.

Tabela 22. Ecuria e Nivelit të Matjes Grupi I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Kamëz	UK	66.30	85.14	18.84
2	Kavajë	UK	31.00	41.19	10.19
3	Korçë	UK	95.00	99.00	4.00
4	Shkodër	UK	66.10	69.53	3.43
5	Vlorë	UK	57.00	60.24	3.24
6	Fier	UK	64.60	66.63	2.03
7	Elbasan	UK	72.20	74.08	1.88
8	Berat - Kuçovë	UK	73.50	74.93	1.43
9	Lezhë	UK	84.50	85.91	1.41
10	Pogradec	UK	88.00	89.01	1.01
11	Lushnje	UK	94.40	95.35	0.95
12	Durrës	UK	94.30	95.03	0.73
13	Tiranë	UK	88.20	88.84	0.64
14	Sarandë	UK	94.60	94.75	0.15

Performanca për vitin 2020

**Figura 12. Niveli i Matjes Grupi II-të, viti 2020**

Gjatë vitit 2020, në grupin e dytë janë 34 shoqëri nga 32 që ishin për vitin 2019, sepse nga kalimi i pragut të lidhjeve janë shtuar 2 shoqëri nga Grupi i III-të. Mbi kufirin e performancës së mirë (mbi 85%) performojnë 12 shoqëri UK. Përmirësim të ndjeshëm të treguesit paraqesin 8 shoqëri UK Vorë (+12.79%), UK Tropojë (+12.66%), UK Mat (+10.16%), UK Malësi e Madhe (+8.93%), UK Dibër (+7.96%), UK Krujë (+5.83%), UK Gjirokastrë (+5.28%) dhe UK Belsh (+5.02%).

Nivel të matjes 100%, për të dytin vit radhazi, raporton vetëm UK Devoll, ndërsa me nivel të lartë të treguesit performojnë UK Librazhd 98.9%, UK Peqin 97.44%, UK Divjakë 96.52%, UK Rrogozhinë 94.53%, UK Roskovec 94.51%, UK Ura-Vajgurore 94.36%, UK Himarë 92.48%, UK Përmet 92.01%, UK Belsh 91.52%.

Përkeqësim të këtij treguesi raportojnë shoqëritë UK Delvinë me (-14.49 %), por nga komunikimet me shoqërinë rezulton se kjo rënie e madhe nuk është reale, pasi ka ardhur për shkak të raportimit jo korrekt në vitin 2019, e ndjekur nga UK Kolonjë (-8.14 %) dhe UK Patos (-4.96 %).

Ecuria e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 23.

Tabela 23. Ecuria e Nivelit të Matjes, Grupi II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Vorë	UK	65.50	78.29	12.79
2	Tropojë	U	76.70	89.36	12.66
3	Mat	UK	62.60	72.76	10.16
4	Malësi e Madhe	UK	61.50	70.43	8.93
5	Dibër	UK	51.70	59.66	7.96
6	Krujë	UK	73.60	79.43	5.83
7	Gjirokastrë	U	54.40	59.68	5.28
8	Belsh	UK	86.50	91.52	5.02
9	Vau i Dejës	UK	71.70	75.88	4.18
10	Gramsh	UK	79.70	82.81	3.11
11	Bulqizë	UK	20.30	22.88	2.58
12	Mirditë	UK	66.70	68.53	1.83
13	Tepelenë	UK	67.40	68.94	1.54
14	Kukës	U	35.50	37.02	1.52
15	Maliq	UK	88.40	89.60	1.20
16	Peqin	UK	96.70	97.44	0.74
17	Himarë	UK	92.00	92.48	0.48
18	Rrogozhinë	UK	94.10	94.53	0.43
19	Ura Vajgurore	UK	94.00	94.36	0.36
20	Cërrik	UK	82.10	82.34	0.24
21	Selenicë	UK	8.30	8.53	0.23
22	Përmet	UK	91.80	92.01	0.21
23	Roskovec	UK	94.30	94.51	0.21
24	Librazhd	UK	98.80	98.90	0.10
25	Divjakë	UK	96.50	96.52	0.02
26	Devoll	UK	100.00	100.00	0.00
27	Dropull	UK	18.80	18.66	-0.14
28	Kurbin	UK	22.60	22.20	-0.40
29	Poliçan	UK	67.50	65.52	-1.98
30	Skrapar	UK	41.60	38.10	-3.50
31	Mallakastër	UK	64.50	60.35	-4.15
32	Patos	UK	38.10	33.14	-4.96
33	Kolonjë	UK	48.60	40.46	-8.14
34	Delvinë	UK	73.20	58.71	-14.49

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2020

Grupi 3 - Niveli i Matjes (%)




Figura 13. Niveli i Matjes Grupi III-të, Viti 2020

Në shoqëritë e Grupit III-të, tendencë përmirësimi të treguesit nga të dhënat e raportuara shfaqin pothuajse të gjitha shoqëritë UK, përveç UK Finiq që ka një rënie (-1.29%). Mbi nivelin e performancës së mirë performojnë tre shoqëri të këtij grupi: UK Pustec me 99.59 %, UK Konispol me 98.23 % dhe UK Këlcyrë me 93 %.

Përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë dy shoqëritë UK Këlcyrë (+20.20%) dhe UK Pustec (+10.89 %). Shoqëria UK Klos ka raportuar për herë të parë në vitin 2019, por niveli i matjes ka qenë zero, ndërsa për vitin 2020 raporton nivelin e matjes 27.28%.

Me nivelin më të ulët të treguesit prej disa vitesh performon shoqëria UK Libohovë, e cila pothuajse i ka të pamatur të gjithë kategoritë e konsumatorëve dhe nuk bën asnjë përpjekje për përmirësimin e këtij treguesi duke qëndruar në nivelin e matjes nën 2%.

Ecuria e nivelit të matjes, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 24.

Tabela 24. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Klos	U	0.00	27.28	27.28
2	Këlcyrë	UK	72.80	93.00	20.20
3	Pustec	UK	88.70	99.59	10.89
4	Fushë Arrëz	UK	42.60	45.60	3.00
5	Has	U	71.30	71.84	0.54
6	Konispol	U	97.70	98.23	0.53
7	Pukë	UK	58.80	59.31	0.51
8	Libohovë	UK	1.90	1.84	-0.06
9	Finiq	UK	58.50	57.21	-1.29

Përfundime

- Niveli i matjes për vitin 2020 në rang sektori është 79.6 %, krahasuar me vitin 2019 ky tregues është përmirësuar me 2.3%. Megjithë trendin në përmirësim, kërkohet më shumë angazhim nga shoqëritë për të përmbushur objektivin prej 85% të performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të tij duke ulur kërkesën për ujë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit nga rritja e orëve të furnizimit me ujë.
- Në total për të tre grupet, 23 shoqëri UK operojnë mbi nivelin e performancës së mirë (4 shoqëri më shumë se në vitin 2019) të Benchmarking. Nga këto shoqëri (8 janë në grupin e parë, 12 në grupin e dytë dhe 3 shoqëri në grupin e tretë). Në sektorin UK, për të dytin vit radhazi, vetëm UK Devoll ka nivelin e matjes 100%.
- Pjesa e konsumatorëve që faturohen aforfe me 150 litra/ditë, banor, nuk është korrekte pasi shumica e konsumatorëve familjarë konsumojnë nën këtë normë të supozuar, por pjesa tjetër abuzojnë pasi kanë shtëpi private apo janë në zona rurale ku konsumi është realisht më i madh se faturimi. Nga ana financiare shoqëritë përfitojnë në mënyrë jo korrekte duke faturua volum më të madh sesa konsumojnë realisht konsumatorët.
- Rritje më të lartë të nivelit të matjes me mbi 10% për vitin 2020 e kanë UK Kamëz me 18.84%, UK Kavajë me 10.19 %, UK Vorë me 12.79%, UK Tropojë me 12.66%, UK Mat me 10.16%, UK Këlcyrë me 20.20% dhe UK Pustec me rritje 10.89%.
- Rënie me të dukshme të këtij treguesi kanë UK Delvinë me 14.49% (raportim i gabuar në vitin 2019), UK Kolonjë me 8.14% dhe UK Patos me 4.96%.
- Shoqëritë UK për vitin 2020 kanë raportuar instalimin e 32,347 ujëmatësave duke e çuar numrin e lidhjeve me matës në 717,723 lidhje nga 902,142 lidhje që janë gjithsej. Konstatohen ritme të ulëta të instalimit të matësave krahasuar me vitin 2019.
- Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit mbetet një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbi konsumit në sisteme.

Në fokus të punës së operatorëve duhet të jetë gjithashtu zbatimi i programeve për instalimin e matësve individual dhe në prodhim për të bërë të mundur eliminimin e praktikës aforfe, si dhe pajisja 100% me matësa e konsumatorëve privat.

2.3.6 Efienca e Stafit

Ky tregues merr një rëndësi të veçantë në analizën e performancës së shoqërisë sepse kostot e personelit zënë përqindjen më të madhe të kostove O&M të aktivitetit të saj.

Efienca e Stafit tregon se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiençës në punë, e cila lidhet me mënyrën e rritjes së efiençës së përgjithshme të shoqërisë.

Efikasiteti i stafit nënkupton që shoqëritë të mos kenë njerëz në organikën e tyre që nuk justifikojnë pozicionin dhe intensitetin e punës që presupozohet të kryejnë. Sektori paraqitet i mbingarkuar me staf të pajustifikuar që në përgjithësi janë punësuar pa arsimin dhe kualifikimin përkatës, si dhe në mjaft raste me militantë partiakë. Në mjaft raste kjo pjesë e stafit përveç se është jo efikase, dekurajon edhe pjesën tjetër të stafit, si shembull negativ i performancës në punë.

Për vitin 2020 për shkak të marrjes në administrim të zonave rurale është rritur në total me rreth 213 punonjës numri i stafit administrativ dhe operativ. Gjatë vitit 2020 në sektor janë shtuar 15 668 lidhje të reja ujësjellësi dhe 29 019 lidhje KUN, e cila ka bërë të mundur që efikasiteti i stafit për 1000 lidhje UK për sektorin të përmirësohet nga 5,33 në vitin 2019 në 5.32 në vitin 2020.

Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe të përbërjes së sistemeve të furnizimit me ujë të shoqërive ky tregues duhet vlerësuar rast pas rasti në funksion të tyre.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020

Për Grupin e I-rë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët.

Figura 14 jep grafikisht Eficiençën e Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive UK




Figura 14. Eficienca e Stafit për Grupin e I-rë, Viti 2020

Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëritë UK Korçë me 2.47 punonjës për 1000 lidhje, UK Kamëz me 3.33 punonjës për 1000 lidhje dhe UK Tiranë me 3.70 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme sipas grafikut paraqiten 9 shoqëri nga UK Lezhë me 4.29 punonjës për 1000 lidhje deri tek UK Pogradec me 5.89 punonjës për 1000 lidhje.

Në brezin e performancës së dobët për të dytin vit radhazi janë 2 shoqëri, UK Fier me 6.19 punonjës për 1000 lidhje, dhe UK Kavajë me 7.29 punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 25 paraqet ecurinë e treguesit të Efiçencës së Stafit për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 25. Ecuria e Efiçencës së Stafit për Grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 nr.	2020 nr.	Diferenca 2020-2019 staf/1000 lidhje
1	Shkodër	UK	6.20	5.97	-0.23
2	Lushnje	UK	5.84	5.61	-0.23
3	Lezhë	UK	4.48	4.29	-0.19
4	Durrës	UK	5.33	5.16	-0.17
5	Tiranë	UK	3.82	3.70	-0.12
6	Fier	UK	6.26	6.19	-0.07
7	Berat - Kuçovë	UK	4.88	4.85	-0.03
8	Elbasan	UK	4.59	4.63	+0.04
9	Korçë	UK	2.26	2.47	+0.21
10	Pogradec	UK	5.57	5.89	+0.32
11	Kavajë	UK	6.86	7.29	+0.43
12	Vlorë	UK	4.37	4.90	+0.53
13	Kamëz	UK	2.67	3.33	+0.66
14	Sarandë	UK	3.69	4.97	+1.28

Për këtë grup vërehet një tendencë pozitive minimale dhe konkretisht janë 7 shoqëri (gjysma e shoqërive të Grupit të I-rë) UK Shkodër, UK Lushnje, UK Lezhë, UK Durrës, UK Tiranë, UK Fier dhe UK Berat - Kuçovë ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur përkatësisht me (0.23), (0.23), (0.19), (0.17), (0.12), (0.07) dhe (0.03) punonjës për 1000 lidhje.

Ecurinë më të mirë megjithëse me një përmirësim të lehtë e kanë shoqëritë UK Shkodër dhe UK Lushnje. Treguesi staf për 1000 lidhje është ulur me (0.23) si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve me 574 lidhje Ujë dhe 442 lidhje KUN dhe ulje të stafit me 7 punonjës për UK Shkodër si dhe i rritjes së numrit të lidhjeve me 162 lidhje KUN dhe ulje të stafit me 7 punonjës për UK Lushnje.

Shoqëritë e tjera të grupit të I-rë, referuar tabelës 25, duke filluar nga UK Elbasan deri tek UK Kamëz kanë tendencë negative përgjithësisht të vogël me përjashtim të UK Sarandë tendenca në rritje e të cilës është +1.28 punonjës për 1000 lidhje.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për Vitin 2020

Për Grupin e II-të, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 15 jep grafikisht Efiçencën e Stafit për Grupin e II-të të shoqërive UK

Grupi 2 - Efienca e Stafit (staf / 1000 lidhje)




Figura 15. Efienca e Stafit për Grupin e II-të, viti 2020

Në këtë grup në nivelin e performancës së mirë bëjnë pjesë 5 shoqëri si UK Kolonjë, UK Librazhd, UK Devoll, UK Maliq dhe UK Dibër ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur përkatësisht me (1.22), (0.22), (0.26), (0.04) dhe (1.20) staf për 1000 lidhje.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 19 shoqëri duke filluar nga UK Cërrik deri tek UK Vau-Dejës që variojnë brenda kufirit prej 6.14 deri 9.94 punonjës për 1000 lidhje.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët mbi 10 punonjës për 1000 lidhje renditen 10 shoqëri, si UK Peqin me tregues 22.80, UK Patos me 17.12, UK Mallakastër me 15.61, UK Malësi e Madhe me 12.98, UK Vorë me 12.02 e deri tek UK Tropojë me 10.11 punonjës për 1000 lidhje UK.

Në grupin e dytë përmirësim të ndjeshëm të këtij treguesi kanë UK Përmet (6.70), UK Roskovec (2.75) deri tek UK Mat (1.08) punonjës për 1000 lidhje. Tendencë përmirësimi, por në nivelin nën 1 punonjës që është përcaktimi që ERRU e konsideron pozitiv, kanë dhe 13 shoqëri duke filluar nga UK Mirditë deri tek UK Gramsh.

Përmenden gjithashtu 3 shoqëri të cilat kanë pasur tendence të lartë negative të këtij treguesi si UK Dropull me (+1.03), UK Vau Dejës me (+2.36) dhe UK Patos me (+4.57) punonjës për 1000 lidhje e cila është edhe shoqëria me tendencën më të lartë negative në Grupin e II-të. Për UK Patos tendenca në rritje është si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve me 1 punonjës për vitin 2020 dhe pakësimit të numrit të lidhjeve UK me 5 lidhje.

Tabela 26 paraqet ecurinë e treguesit të Efijencës së Stafit për Grupin e II-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 26. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 nr.	2020 nr.	Diferenca 2020-2019 staf/1000 lidhje
1	Përmet	U	14.06	7.36	-6.70
2	Roskovec	UK	12.04	9.29	-2.75
3	Tepelenë	UK	9.97	8.46	-1.51
4	Krujë	UK	8.28	6.88	-1.40
5	Cërrik	UK	7.49	6.14	-1.35
6	Kolonjë	UK	5.53	4.31	-1.22
7	Dibër	UK	7.20	6.00	-1.20
8	Mat	UK	7.44	6.36	-1.08
9	Mirditë	UK	11.86	11.11	-0.75
10	Ura Vajgurore	UK	10.16	9.50	-0.66
11	Rrogozhina	UK	8.13	7.54	-0.59
12	Tropojë	UK	10.68	10.11	-0.57
13	Peqin	UK	23.15	22.80	-0.35
14	Belsh	UK	10.04	9.74	-0.30
15	Divjaka	UK	11.84	11.55	-0.29
16	Devoll	UK	5.54	5.28	-0.26
17	Himarë	UK	6.99	6.75	-0.24
18	Librazhd	UK	5.20	4.98	-0.22
19	Skrapar	UK	9.28	9.16	-0.12
20	Maliq	UK	5.68	5.64	-0.04
21	Gramsh	U	8.89	8.87	-0.02
22	Selenicë	U	11.40	11.55	0.15
23	Polican	UK	7.95	8.10	0.15
24	Bulqizë	U	10.00	10.28	0.28
25	Mallakastër	UK	15.24	10.61	0.37
26	Gjirokastër	UK	9.03	9.44	0.41
27	Malësi e Madhe	UK	12.51	12.98	0.47
28	Kukës	UK	6.13	6.63	0.50
29	Delvinë	UK	6.67	7.32	0.65
30	Kurbin	UK	8.33	9.17	0.84
31	Dropull	UK	5.99	7.02	1.03
32	Vorë	UK	10.64	12.02	1.38
33	Vau- Dejës	UK	7.58	9.94	2.36
34	Patos	UK	12.55	17.12	4.57

Performanca për Vitin 2020

Për Grupin e III-të niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Figura 16 jep grafikisht Eficiencën e Stafit për Grupin e III-të të shoqërive UK




Figura 16. Eficienca e Stafit për Grupin e III-të, Viti 2020

Në Grupin e III-të, 7 shoqëri kanë më shume se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është UK Fushë -Arrëz 8.76 punonjës për 1000 lidhje i cili ndiqet më tej nga UK Pukë me 9.59 punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme, pra në nivelin 10-15 punonjës janë 4 shoqëri, respektivisht, UK Konispol, UK Libohovë, UK Finiq dhe UK Pustec.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 3 shoqëri, UK Klos (+15.76), UK Këlcyrë (20.08) dhe UK Has me (+20.25) punonjës për 1000 lidhje e cila renditet e fundit në Grupin e III-të dhe ka përkeqësimin më të madh me (+4.77) punonjës për 1000 lidhje.

Tabela 27 paraqet ecurinë e treguesit të Eficiencës së Stafit për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 27. Ecuria e Efijencës së Stafit për Grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 nr.	2020 nr.	Diferenca 2020-2019 staf/1000 lidhje
1	Finiq	UK	13.25	11.29	-1.96
2	Konispol	U	12.43	10.81	-1.62
3	Libohovë	UK	11.90	11.17	-0.73
4	Klos	U	16.36	15.76	-0.60
5	Pukë	UK	9.90	9.59	-0.31
6	Fushë- Arrëz	UK	8.87	8.76	-0.11
7	Këlcyrë	UK	19.93	20.08	0.15
8	Pustec	UK	11.89	12.79	0.90
9	Has	U	15.48	20.25	4.77

Ndryshim pozitiv të ndjeshëm mbi 1 punonjës për 1000 lidhje kanë pasur shoqëritë UK Finiq -1.96, UK Konispol -1.62, por përsëri mbesin në brezin e performancës së pranueshme me 11.29 dhe 10.81 punonjës për 1000 lidhje. Tendencë pozitive kanë pasur edhe shoqëritë UK Libohovë -0.73 deri tek UK Fushë Arrëz me -0.11 punonjës për 1000 lidhje UK.

Tendencën negative më të madhe e ka UK Has me +4.77 punonjës për 1000 lidhje, kjo si rezultat i shtimit të numrit të punonjësve me 8 punonjës më shumë krahasuar me vitin 2019 dhe shtimit të numrit të lidhjeve UK vetëm me 30 lidhje gjë e cila ka sjellë edhe përkeqësimin e këtij treguesi.

Gjithsesi vlerësimi i performancës për të tre grupet e këtij treguesi duhet të realizohet rast pas rasti në funksion të karakteristikave dhe numrit të sistemeve të furnizimit me ujë brenda zonës së shërbimit të shoqërisë. Është i njohur fakti që ky tregues influencohet mjaft nga numri i personelit roje të cilin shoqëria është e detyruar ta zbatojë për të garantuar sigurinë në këto objekte që konsiderohen të rëndësishme të veçantë. Kjo influencë është më e dukshme në shoqëritë e vogla që i përkasin Grupit të III-të.

Përfundime

- Në vitin 2020, treguesi staf për 1000 lidhje ka pësuar përmirësim të lehtë me vitin paraardhës.
- Numri i lidhjeve UK është rritur me rreth 15 668 lidhje uji dhe Lidhje KUN 29 019, nga ana tjetër rritja e numrit të punonjësve me 213 ka zvogëluar efektin pozitiv të rritjes së lidhjeve UK.
- Rritja e numrit të punonjësve justifikohet në pjesën më të madhe të tyre nga zhvillimet në sektor, riorganizimi i shoqërive dhe zgjerimi i zonës së shërbimit.
- Rritja e numrit të punonjësve është e lidhur direkt me kostot e punës. Në kuadër të objektivit të përgjithshëm strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, përmirësimi i efijencës së stafit është një nga elementet thelbësor për përmirësimin e efijencës financiare të shoqërisë.
- Rritja e kapaciteteve profesionale, tërheqja dhe motivimi i profesionistëve të trajnuar dhe transferimi efikas i njohurive teknike do të kishte efekt të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin dhe zhvillimin e shoqërive.
- Mbetet gjithnjë problem influenca e politikës me emërimet militantësh që e shtojnë artificialisht numrin e punonjësve në shoqëritë e UK, të cilët në mjaft raste jo vetëm që nuk kontribuojnë, por shërbejnë si shembull negativ për stafin.
- ERRU do të kushtojë një vëmendje të veçantë shqyrtimit të organogramës së stafit të shoqërive UK kur ato paraqesin aplikime për tarifa të reja në mënyrë që ato të jenë të justifikuara në numër punonjësish, pozicione dhe përshkrime të punës për secilin prej tyre.

2.3.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë.

Një nga treguesit kryesorë të cilësisë së shërbimit të një shoqërie është mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë për konsumatorët. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë lidhet me menaxhimin e kërkesës për ujë dhe të humbjeve teknike dhe administrative në sisteme duke synuar që t'u ofrohet konsumatorëve një shërbim furnizimi me ujë pa ndërprerje.

Mesatarja aktuale e sektorit e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë është 13.79 orë/ditë me një rritje 0.66 orë/ditë krahasuar me vitin paraardhës, ajo është ende larg objektivit përfundimtar të shërbimit të furnizimit me ujë pa ndërprerje 24/7 orësh.

Objektivi i performancës së mirë të vendosur nga ERRU prej 18 orë në ditë ende është larg për tu arritur nga shumë shoqëri, siç do vërehet në analizën e shoqërive sipas grupeve.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2020




Figura 17. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e I-rë, Viti 2020

Në Grupin e I-rë të shoqërive, për vitin 2020 vetëm pesë shoqëri arrijnë të furnizojnë konsumatorët me mbi 18 orë/ditë që është dhe kufiri i performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Përmirësim të këtij treguesi raportojnë shoqëritë UK Kavajë (+6 orë/ditë), UK Vlorë (+2.9 orë/ditë), UK Tiranë (+2.14 orë/ditë), UK Berat Kuçovë (+2 orë/ditë), etj. Shoqëria UK Korçë vazhdon të jetë edhe për këtë vit e vetmja që arrin të furnizojë me ujë 24 orë/ditë të gjithë zonën e shërbimit, duke u ndjekur nga UK Fier (22 orë/ditë), UK Shkodër (21.7 orë/ditë), UK Lezhë (21 orë/ditë).

Gjatë vitit 2020, orët e furnizimit janë reduktuar dukshëm nga shoqëritë UK Pogradec (-1.2 orë/ditë), UK Sarandë (-2 orë/ditë).

Të gjitha shoqëritë e Grupit të I-rë duhet të kenë në fokus kryesor përmirësimin e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë sepse si shoqëri të mëdha ato mbulojnë me shërbim pjesën më të madhe të popullsisë në vend.

Shoqëritë me performancë më të dobët vazhdojnë të jenë UK Kamëz me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 4 orë/ditë e ndjekur nga UK Lushnje me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë 5 orë/ditë.

Ecuria e këtij treguesi për Grupin e I-rë të shoqërive për dy vitet e fundit paraqitet në tabelën 28.

Tabela 28. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Diferenca 2020-2019 (%)
1	Kavajë	UK	4.00	10.00	6.00
2	Vlorë	UK	10.1	13	2.90
3	Tiranë	UK	13.30	15.44	2.14
4	Berat - Kuçovë	UK	12.00	14.00	2.00
5	Shkodër	UK	20.80	21.70	0.90
6	Durrës	UK	8.30	9.00	0.70
7	Elbasan	UK	12.00	12.50	0.50
8	Fier	UK	22.00	22.00	0.00
9	Kamëz	UK	4.00	4.00	0.00
10	Korçë	UK	24.00	24.00	0.00
11	Lezhë	UK	21.00	21.00	0.00
12	Lushnje	UK	5	5	0.00
13	Pogradec	UK	21.6	20.4	-1.20
14	Sarandë	UK	12.00	10.00	-2.00

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2020

Grupi 2 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 18. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për Grupin e II-të, Viti 2020

Në Grupin e II-të prej 34 shoqërisht, 7 prej tyre si rezultat i investimeve fizike nga AKUM-i arrijnë të furnizojnë me ujë 24 orë/ditë, përkatësisht qendrat urbane **Tepelenë, Cërrik, Devoll, Gramsh, Librazhd, Mat, Përmet**.

Mbi kufirin e performancës së mirë, me furnizim me ujë mbi 18 orë/ditë, performojnë 13 shoqëri UK, ndërsa për 8 shoqëri, niveli i këtij treguesi është nën kufirin e performancës së dobët (8 orë/ditë). Edhe për këtë vit **UK Roskovec dhe UK Kurbin**, janë performuesit më të dobët në grup me 4 orë furnizimi me ujë në ditë.

Gjatë vitit 2020, përmirësim të orëve të furnizimit me ujë kanë patur shoqëritë UK Mallakastër (+5 orë/ditë) UK Dropull (+4.5 orë/ditë), UK Patos (+4 orë/ditë), UK Belsh (+3 orë/ditë), UK Kolonjë (+3 orë/ditë), si dhe UK Devoll, UK Himarë, UK Krujë, UK Mat me nga +2 orë/ditë.

Ky tregues ka pësuar përkeqësim të ndjeshëm për shoqërinë UK Dibër (-4 orë/ditë), si rezultat i kalimit të zonave të reja dhe rritjes së zonës e shërbimit me këto zona, e ndjekur më pas nga UK Delvinë (-3 orë/ditë). Kjo e fundit justifikohet se me zbatimin e projektit për ndërtimin e ujësjellësit të ri janë hasur probleme me menaxhimin e rrjetit të vjetër dhe herë pas herë kanë qenë të detyruar të bënim ndërprerje të furnizimit me ujë për të mos patur humbje nga defektet që vinin si rezultat i zbatimit të projektit.

Ecuria e shoqërive në Grupin e II-të për dy vitet e fundit pasqyrohet në tabelën 29.

Tabela 29. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për Grupin e II-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Mallakastër	UK	6.00	11.00	5.00
2	Dropull	UK	5.50	10.00	4.50
3	Patos	UK	8.00	12.00	4.00
4	Belsh	UK	15.00	18.00	3.00
5	Kolonje	UK	18.00	21.00	3.00
6	Devoll	UK	22.00	24.00	2.00
7	Himarë	UK	14.00	16.00	2.00
8	Krujë	UK	6.00	8.00	2.00
9	Mat	UK	16.00	18.00	2.00
10	Vorë	UK	7.50	8.00	0.50
11	Roskovec	UK	4.00	4.45	0.45
12	Bulqizë	UK	19.00	19.00	0.00
13	Cërrik	UK	22.00	22.00	0.00
14	Divjakë	UK	6.00	6.00	0.00
15	Gjirokastër	UK	13.00	13.00	0.00
16	Gramsh	UK	24.00	24.00	0.00
17	Kurbin	UK	4.00	4.00	0.00
18	Librazhd	UK	24.00	24.00	0.00
19	Maliq	UK	14.00	14.00	0.00
20	Mirditë	UK	15.00	15.00	0.00
21	Peqin	UK	20.00	20.00	0.00
22	Poliçan	UK	24.00	24.00	0.00
23	Rrogozhinë	UK	9.00	9.00	0.00
24	Ura Vajgurore	UK	10.00	10.00	0.00
25	Vau i Dejës	UK	9.00	9.00	0.00
26	Tepelenë	UK	24.00	24.00	0.00
27	Skrapar	UK	12.00	12.00	0.00
28	Përmet	UK	24.00	24.00	0.00
29	Kukës	UK	8.50	8.40	-0.10
30	Malësi e Madhe	UK	12.00	11.10	-0.90
31	Tropojë	UK	22.00	21.00	-1.00
32	Selenicë	UK	6.50	5.00	-1.50
33	Delvinë	UK	9.00	6.00	-3.00
34	Dibër	UK	12.00	8.00	-4.00

Grupi 3 - Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)




Figura 19. Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë për Grupin e III-të, Viti 2020

Në Grupin e III-të të përbërë nga 9 shoqëri, 5 prej tyre arrijnë të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë mbi kufirin e performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Furnizimin me ujë 24 orë/ditë e ofrojnë shoqëritë **UK Fushë Arrëz, UK Pukë dhe UK Këlcyrë**. Përmirësim të ndjeshëm të orëve të furnizimit me ujë për vitin 2020 e ka patur UK Finiq me 15.4 orë/ditë, për shkak të investimeve që janë kryer duke e renditur këtë shoqëri tek shoqëritë me performancë të mirë me 21.4 orë/ditë. Për këtë vit ky grup ka një performancë të mirë, dhe vetëm UK Has e ka furnizimin me ujë 8 orë/ditë.

Në tabelën 30 të mëposhtme është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për Grupin e III-të të shoqërive për dy vitet e fundit.

Tabela 30. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e III-të

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Diferenca 2020-2019 (%)
1	Finiq	UK	6.00	21.40	15.40
2	Klos	U	4.00	9.00	5.00
3	Pustec	U	8.00	10.00	2.00
4	Fushë Arrëz	UK	24.00	24.00	0.00
5	Has	UK	8.00	8.00	0.00
6	Këlcyrë	UK	24	24	0.00
7	Konispol	UK	20.00	20.00	0.00
8	Libohovë	UK	13.00	13.00	0.00
9	Pukë	UK	24.00	24.00	0.00

Përfundime

- Konsumatorët Shqiptarë janë furnizuar mesatarisht me 13.79 orë ujë në ditë për vitin 2020. Krahasuar me vitin paraardhës treguesi është përmirësuar në nivel të ulët (+0.66 orë/ditë), por pavarësisht se duket larg realizimit të objektivit të performancës së mirë përcaktuar nga ERRU 18 orë/ditë, me investimet nga qeveria qendrore për qendrat urbane pritet që gjendja të përmirësohet dukshëm në të ardhmen e afërt.
- Eksperienca e shoqërive me performancë të mirë në të tre grupet tregon se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm.
- Shoqërive do t'u kërkohet t'i vendosin këto objektiva në planet e tyre të biznesit dhe të marrin hapat e nevojshme për të arritur përmirësime duke analizuar edhe treguesit e tjerë të performancës të ndërlidhur me njëri tjetrin, si p.sh. Uji Pa të Ardhura.

2.3.8 Mbulimi me Kanalizime

Raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK, është Treguesi i Mbulimit me Kanalizime. Shoqëritë të cilat ofrojnë këtë shërbim, arrijnë të mbulojnë në nivel kombëtar mesatarisht 51.5 % të popullsisë nga 51 % e raportuar në vitin 2019 me një rritje prej 0.5 % pothuajse e papërfillshme.

Investimet në sektorin e UN (në zonat urbane) kanë qenë të diferencuara duke i kushtuar më shumë vëmendje shërbimit të furnizimit me ujë. Zonat rurale me popullsi nën 2000 banorë nuk kanë rrjet KUN dhe ky shërbim mbulohet individualisht nga konsumatorët me gropa septike. Theksohet fakti se këto të fundit përgjithësisht janë akoma larg respektimit të kushteve teknike të zbatimit të tyre që të funksionojnë si mini-implante të trajtimit të ujërave të ndotura për një ambient ekologjikisht të pastër.

Për të patur një shërbim me kanalizime më cilësorë, nevojitet që të ketë implante të trajtimit të ujërave të ndotura. Për vitin 2020, mbulimi me ITUN nga njëmbëdhjetë implantet ekzistuese është raportuar 10 % më një ulje prej 2% nga viti 2019, pasi implantet e Kavajës dhe Orikumit janë jashtë funksionit. Gjithashtu implanti i Sarandës paraqet probleme të karakterit institucional dhe të operimit. Përveç impianteve të qyteteve Korçë dhe Pogradec, në kuadër të strategjisë së qeverisë qendrore për një bregdet të pastër, të gjithë implantet e tjerë janë të përqendruara në vijën bregdetare nga Velipoja deri në Sarandë. Domosdoshmëria për ndërtim të impianteve të reja dhe vënia në punë me kapacitet të plotë e impianteve të ndërtuara do të rrisë ndjeshëm cilësinë e këtij shërbimi duke krijuar njëkohësisht mbrojtje më të madhe të mjedisit.




Figura 20. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e I-rë, Viti 2020

Në Grupin e I-rë të shoqërive, krahasuar me vitin 2019, mbi kufirin 75% të performancës së mirë, performojnë vetëm 3 shoqëri nga 2 që ishin për vitin 2019, UK Kamëz me 100%, UK Tiranë me 90.1% dhe UK Sarandë me 79.24%, e cila këtë vit ka një rritje të mbulimit me kanalizim prej 5.24%. Ndërkohë, UK Kamëz, e cila raporton 100% mbulim me kanalizime u konstatua që kryen për të disatin vit radhazi raportim të gabuar, kështu që mbeten vetëm 2 shoqëri UK Tiranë dhe UK Sarandë që të jenë mbi këtë nivel.

Për vitin 2020, janë 9 shoqëri që performojnë mbi nivelin 50% deri në 75%, ndërsa 3 shoqëri performojnë nën nivelin 50% të mbulimit me kanalizime, përkatësisht: UK Shkodër 43.98%, UK Fier 38.34%, dhe UK Lushnje 38.18%, që konsiderohet si nivel i dobët.

Trajtimi i ujërave të ndotura në këtë grup bëhet nga shoqëritë e licencuara UK Durrës, UK Pogradec, UK Korçë, UK Lezhë dhe UK Shkodër.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të I-rë, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 31.

Tabela 31 .Ecuria e mbulimit me kanalizime për Grupin I-të 2020

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Sarandë	UK	74.00	79.24	5.24
2	Lushnje	UK	33.00	38.18	5.18
3	Durrës	UK	52.60	56.64	4.04
4	Vlorë	UK	58.40	61.80	3.40
5	Pogradec	UK	49.10	50.64	1.54
6	Lezhë	UK	59.20	60.26	1.06
7	Fier	UK	38.30	38.34	0.04
8	Kamëz	UK	100.00	100.00	0.00
9	Korçë	UK	65.30	65.25	-0.05
10	Berat - Kuçovë	UK	54.20	54.13	-0.07
11	Shkodër	UK	44.10	43.98	-0.12
12	Tiranë	UK	90.50	90.10	-0.40
13	Kavajë	UK	62.10	61.65	-0.45
14	Elbasan	UK	60.70	58.46	-2.24

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2020

Grupi 2 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 21. Mbulimi me Kanalizime për Grupin e II-të, Viti 2020

Në grupin e II-të, për këtë tregues kanë raportuar 28 shoqëri pasi 6 shoqëri nuk e kryejnë këtë shërbim. Për këtë vit, kanë raportuar për herë të parë për mbulimin me kanalizime U Përmet dhe UK Malësi e Madhe dhe nuk janë analizuar pasi nuk kanë bazë krahasimi. Në këtë grup, kanë përmirësime të dukshme UK Patos me (+13.95 %) dhe UK Roskovec (+12.52 %), ndërsa UK Dibër ka rënie të ndjeshme të këtij treguesi me (-26.46 %) për shkak të shtimit të zonave të reja rurale pa KUN, si rezultat i përfundimit të reformës.

Në këtë grup vetëm një shoqëri performon mbi kufirin 75% të nivelit të performancës së mirë UK Kolonjë me 81.58%. Shoqëritë e tjera të këtij grupi pothuajse të gjitha janë nën nivelin e performancës së dobët prej 50%.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të II-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 32.

Tabela 32. Ecuria e Mbulimit me Kanalizime për Grupin II-të 2020

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Përmet	U	0.00	68.00	68.00
2	Patos	UK	37.70	51.65	13.95
3	Roskovec	UK	16.50	29.02	12.52
4	Tropojë	UK	24.70	28.56	3.86
5	Vau i Dejës	UK	2.40	6.24	3.84
6	Himarë	UK	15.00	18.23	3.23
7	Belsh	UK	13.90	17.04	3.14
8	Malësi e Madhe	UK	0.00	1.94	1.94
9	Gjirokastër	UK	39.50	40.25	0.75
10	Skrapar	UK	45.50	46.11	0.61
11	Cërrik	UK	26.60	27.13	0.53
12	Tepelenë	UK	39.10	39.30	0.20
13	Mirditë	UK	39.80	40.00	0.20
14	Maliq	UK	23.90	24.00	0.10
15	Librazhd	UK	20.90	21.00	0.10
16	Krujë	UK	25.70	25.74	0.04
17	Mat	UK	45.90	45.93	0.03
18	Poliçan	UK	67.80	67.82	0.02
19	Kurbin	UK	37.00	37.02	0.02
20	Delvinë	UK	38.10	38.12	0.02
21	Mallakastër	UK	21.40	21.41	0.01
22	Bulqizë	U	0.00	0.00	0.00
23	Devoll	UK	0.00	0.00	0.00
24	Divjakë	UK	0.00	0.00	0.00
25	Gramsh	U	0.00	0.00	0.00
26	Peqin	UK	0.00	0.00	0.00
27	Selenicë	U	0.00	0.00	0.00
28	Kolonjë	UK	81.60	81.58	-0.02
29	Ura Vajgurore	UK	12.70	12.68	-0.02
30	Rrogozhinë	UK	8.00	7.82	-0.18
31	Dropull	UK	1.00	0.67	-0.33
32	Vorë	UK	48.40	47.74	-0.66
33	Kukës	UK	41.70	39.95	-1.75
34	Dibër	UK	43.90	17.44	-26.46

Grupi 3 - Mbulimi me Kanalizime (%)




Figura 22 . Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2020

Grupi i III-të është grupi me performancën më të dobët për treguesin e mbulimit me kanalizime si rezultat i një përqindje të lartë të hapësirës rurale në zonën e tyre të shërbimit. Nga 9 shoqëri të këtij grupi, vetëm 3 shoqëri kanë raportuar të dhëna për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura.

Nga 3 shoqëritë që merren në analizë shihet se asnjë nga shoqëritë nuk kalon mbi nivelin e performancës së mirë 75%. Të tre shoqëritë performojnë nën kufirin e performancës së dobët 50%, UK Fushë - Arrëz me 34.55%, UK Pukë me 25.28%, UK Pustec me 24.13%.

Këto tre shoqëri nuk kanë rënie të këtij treguesi por kanë qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel si në vitin 2019.

Ecuria e mbulimit me kanalizime, për shoqëritë e Grupit të III-të, për dy vitet e fundit paraqitet e detajuar më poshtë në tabelën 33.

Tabela 33. Ecuria e Mbulimi me Kanalizime për Grupin e III-të, Viti 2020

Nr.	Operatori	Aktiviteti	2019 (%)	2020 (%)	Ndryshimi 2020-2019 (%)
1	Pukë	UK	25.10	25.28	0.18
2	Pustec	UK	24.00	24.13	0.13
3	Fushë Arrëz	UK	34.50	34.55	0.05
4	Finig	UK		0.00	0.00
5	Has	U		0.00	0.00
6	Kelcyrë	UK		0.00	0.00
7	Klos	U		0.00	0.00
8	Konispol	U		0.00	0.00
9	Libohovë	UK		0.00	0.00

Përfundime

- Treguesi i mbulimit me kanalizime është ndër treguesit që ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel si për vitin 2019, me një rritje të papërfillshme prej 0.5 %. Shihet se për vitin 2020 nga analiza për të tre grupet, vetëm 4 shoqëri arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 75 % të popullsisë në zonën e juridiksionit, por duke mos marrë në konsideratë UK Kamëz që ka pasaktësi në raportim, për këtë vit mbeten vetëm 3 shoqëri mbi këtë kufi UK Tiranë, UK Sarandë dhe UK Kolonjë.
- Nga të tre grupet, 12 shoqëri performojnë ndërmjet kufirit të performancës së dobët 50% dhe kufirit të performancës së mirë 75%, ndërsa shoqëritë e tjera arrijnë të mbulojë me shërbim një përqindje të ulët të popullsisë në juridiksion.
- UK Përmet dhe UK Malësi e Madhe kanë raportim për herë të parë për mbulimin me kanalizime për vitin 2020.
- Nga 51.5% mbulim me shërbim të kanalizimeve në rang vendi, shihet që 45.5% ju ofrohet shërbim zonave urbane dhe vetëm 6% është për zonat rurale. Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 7 shoqëri UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec, UK Shkodër (ITUN Velipoje + ITUN Shirokë), UK Sarandës, UK Vlorë (ITUN Vlorë + ITUN Orikum) dhe UK Lezhë, por nga këto shoqëri kanë arritur të pajisen me licence nga ERRU vetëm 4 shoqëri (UK Durrës, UK Korçë, UK Pogradec dhe UK Shkodër) pasi shoqëritë e tjera nuk kanë mundur të pajisen me lejen mjedisore gjë që ka sjellë pengesë në marrjen e kategorisë D për këto shoqëri.
- Mbetet akoma problem respektimi i normave teknike për impiantet individuale të trajtimit të UN (gropat septike) për zonat rurale.
- Ndihet nevoja e rritjes së vëmendjes për investime në sektor, si në drejtim të zgjerimit të rrjeteve të mbledhjes dhe largimit të UN, edhe të impianteve të trajtimit të tyre para se të dergjen në ambientin pritës.

3 Konkluzione dhe Rekomandime

- Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave është një problem thelbësorë në sektor dhe kërkon rritjen e përgjegjshmërisë së stafëve drejtues të shoqërive UK në drejtim të raportimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme. ERRU të hartojë dhe aprovojë një metodikë-rregullore për një kontroll dhe klasifikim të saktësisë së raportimeve të të dhënave mbi baza faktike dhe analitike.
- Ujit Pa të Ardhura, 65.4% në nivelin më të lartë të viteve të fundit mbetet problem serioz për sektorin UK. AKUM duhet të mbështesë instalimin e matësave të ujit në burim dhe tek konsumatorët familjarë kryesisht për shoqëritë e dobëta financiarisht në mënyrë që të hartohen bilancet e ujit të sakta si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.
- Niveli i lartë prej 45 % që zënë kostot e punës në kostot operacionale të shoqërisë, kërkon mirëmanaxhim të burimeve njerëzore nga ana e saj. Numri i stafit të punësuar duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.
- Shoqëritë UK duhet të hartojnë Planet e Biznesit 5 Vjeçare, në mënyrë që të përcaktojnë vijimësinë e aktivitetit të tyre. Hartimi i tyre për shoqëritë e vogla që kanë mundësi financiare të kufizuara duhet të mbështetet nga AKUM dhe/ose donatorët.
- Shoqëritë duhet të hartojnë Planet e Menaxhimit të Aseteve që mundësojnë planifikimin efikas të investimeve në sektor në përputhje me ciklin e plotë të jetës së aktiveve.
- Referuar respektimit të VKM Nr.63 për reformën, në sektor janë akoma 18 shoqëri të pa licencuara. Kjo kërkon një angazhim serioz nga Bashkitë dhe shoqëritë UK për të përfunduar procesin e licencimit si shoqëri të riorganizuara duke vlerësuar dhe regjistruar asetet, si dhe marrjen e Akt Miratimit Higjeno Sanitar.
- Të vlerësohen elementët e qasjes për agregimin e sektorit në aspektet praktiko-ligjore të ngritjes dhe veprimtarisë së Operatorit të Alternativës së Fundit dhe Subjekteve të Kompetencave të Përbashkëta, si dhe të vlerësohet qasja për agregimin e sektorit me disa shembuj agregimi të suksesshëm.

4 Tema e Veçantë (Studim i ERRU-së Tetor 2020)

Studimi për Familjet me Ndhimë Ekonomike dhe Qëndrueshmëria Financiare e Shoqërive UK

- **Parashtresë mbi Temën**

Familjet që trajtohen me Ndhimë Ekonomike (NE) në rang vendi përbëjnë një numër jo të vogël kundrejt numrit total të popullsisë, si edhe një numër të konsiderueshëm klientësh të shoqërive UK. Tarifat që aplikojnë këto të fundit për konsumatorët familjarë krahasuar më të ardhurat mujore që familjet me NE marrin si bonus për mbijetesë nga qeveria qendrore e bëjnë praktikisht të pamundur pagesën e faturës së shërbimeve nga kjo shtresë e popullsisë.

Referuar legjislacionit në fuqi masa e ndihmës ekonomike për këto familje nuk mund të jetë më e madhe se 8,000 Lek/muaj. Për një familje me 4 persona (burrë, grua, 1 adult dhe 1 i mitur) vlera e ndihmës ekonomike llogaritet në rreth 5,500 lekë/muaj.

Pamundësia e pagesës së faturës së ujit nga kjo shtresë e popullsisë në rast se nuk kompensohet përbën një gropë financiare për shoqërinë UK, gjë e cila e bën të nevojshme gjetjen e një zgjidhje institucionale dhe praktike të këtij problemi.

Në fakt ERRU kur merr vendim për tarifën e propozuar nga shoqëritë dhe verifikon kriterin e Përbalueshmërisë së pagesës së faturës së shërbimeve e përjashton shtresën e konsumatorëve me NE, pra nuk merr si referencë të ardhurat mujore të këtyre të fundit.

Në këtë kuadër është e nevojshme që të realizohet një vlerësim i detajuar i influencës dhe peshës që kanë konsumatorët e shtresës së popullsisë me NE në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive të UK. Më tej, duhet të rekomandohen zgjidhjet e mundshme që kjo kategori konsumatorësh të përftojë shërbimet nga shoqëria UK dhe njëkohësisht të garantohet qëndrueshmëria financiare e kësaj të fundit.

Për këtë kategori familjesh është gjithashtu e nevojshme gjetja e rrugëve të garantimit të një norme minimale furnizimi me ujë për të plotësuar nevojat bazike jetike të jetesës për to. Duke presupozuar që kjo kategori mund ta konsiderojë veten të përjashtuar nga pagesa e faturës së ujit, garantimi i minimumit të normës lidhet ngushtësisht me zgjidhje teknike për të mënjeluar shpërdorimet që në mjaft raste janë evidente tek kjo kategori.

Qeveria qendrore duhet të përcaktojë dhe vendosë mbi alternativat e mundshme për zgjidhjen e problemit se si duhet të realizohet kompensimi ndaj shoqërive UK i pagesës së faturës së shërbimeve për këtë shtresë të popullsisë që nuk ka aftësi paguese për shërbimet e mësipërme.

Kompensimi i efektit financiar në shoqëritë UK nga konsumatorët me NE duhet të zgjidhet në nivel të qeverisjes qendrore sepse realisht asnjë nga pushtetet vendore në vend nuk gjeneron të ardhura nga sistemi vendor fiskal që të arrijë të mbulojë 100% e më shumë të kërkesave që i detyron ligji për të kryer funksionet e veta, ku përfshihen dhe ato të shërbimeve të FU dhe KUN.

Krahas zgjidhjes me subvencione direkt nga qeveria qendrore, alternativa tjetër mund të jetë kompensimi me anë të kontributit nga të gjithë konsumatorët e tjerë në zonën e shërbimit. Kjo realizohet duke e përfshirë vlerën e kompensimit në kostot për tarifën që propozon shoqëria UK për


konsumatorët familjarë, pra duke pranuar artificialisht një volum më të vogël të ujit të faturuar kur llogaritet kosto e 1m³ ujë.

Informacioni për këtë vlerësim bazohet në të dhënat zyrtare mbi numrin e familjeve dhe popullsisë që trajtohen me Ndhmë Ekonomike, si edhe të përgjigjeve të pyetësorit nga shoqëritë UK për çështje të veçanta të problematikave të mësipërme.

2. Vlerësimi i Familjeve me Ndhmë Ekonomike

Referuar të dhënave të INSTAT dhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, familjet që trajtohen me Ndhmë Ekonomike (NE) në shkallë kombëtare përbëjnë rreth 9,2% të numrit total të familjeve në të gjithë vendin që përfaqësojnë 256,673 banorë (shih figurën23).

Figura 23 Përqindja e Familjeve me NE ndaj Totalit në 61 Bashkitë e vendit




Burimi: INSTAT dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Siç u theksua më sipër, për një familje me 4 persona (burrë, grua, 1 adult dhe 1 i mitur) vlera e ndihmës ekonomike llogaritet në rreth 5,500 lekë/muaj.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se në 23 nga 61 bashki në të gjithë vendin numri i familjeve me ndihmë ekonomike përbën mbi 15% ndaj totalit të familjeve në bashkitë përkatëse, përkatësisht, Skrapar, Dibër, Mat, Klos, Bulqizë, Elbasan, Belsh, Gramsh, Peqin, Librazhd, Përrenjas, Memaliaj, Maliq, Kolonjë, Pogradec, Devoll, Kukës, Has, Tropojë, Mirditë, Vau Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz.

Figura 24, jep 23 bashkitë në të cilat familjet me ndihmë ekonomike përbëjnë mbi 15% të totalit të familjeve në to.

Figura 24 Bashkitë me mbi 15% të numrit të familjeve me ndihmë ekonomike ndaj totalit të familjeve në çdo Bashki



Në rang vendi familjet në NE përfaqësojnë 256,673 banorë, ndërsa në bashkitë me mbi 15% të familjeve me NE përfaqësojnë 186,402 banorë ose 73% e familjeve me NE ndodhet në 23 bashkitë e mësipërme.

Për sa më sipër rezulton që fokusi i subvencioneve nga Qeveria Qendrore për shoqëritë UK për mbulimin e kostove të O&M duhet të jetë me prioritet në 23 bashkitë e mësipërme.

3. Bonusi i Ndihmës Ekonomike Kundrejt Faturës së Shërbimeve Ujësjiellës Kanalizime

Në qoftë se marrim në konsideratë vlerën mesatare të faturës mujore bazuar në tarifat aktuale që shoqëritë UK aplikojnë për konsumatorët familjarë në secilën prej bashkive të vendit, ndaj vlerës së bonusit që familjet me ndihmë ekonomike marrin nga qeveria qendrore, vërejmë se ky raport është mbi 10% në 32 bashki të vendit.


Këto bashki janë, përkatësisht: Berat-Kuçovë, Devoll, Delvinë, Durrës, Elbasan, Fier, Gramsh, Gjirokastrë, Himarë, Kolonjë, Korçë, Krujë, Lezhë, Librazhd-Përrenjas, Lushnje, Malësi e Madhe, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Pukë, Rrogozhinë, Sarandë, Skrapar, Shkodër, Tepelenë, Tiranë, Vau Dejës, Vlorë dhe Vorë.

Në figurën 25 jepen 32 bashkitë ku vlera e faturës mujore për shërbimet e ujësjiellës kanalizimeve ndaj bonusit që marrin nga shteti familjet me ndihmë ekonomike është mbi 10%.

Nga ky grafik vihet re se në bashkitë, **Durrës, Korçë, Pogradec, Tiranë, Lezhë, Himarë dhe Vorë** fatura mujore përbën 25%-35% të bonusit të NE për konsumatorët me matje, ndërsa për ato aforfe është në nivelet 35% - 50%.

Në bashkitë e mësipërme pavarësisht se familjet me ndihmë ekonomike mund të jenë në përqindje të vogël, ato domosdoshmërisht duhen marrë në konsideratë nga shoqëritë UK sepse është absolutisht e pamundur që ato të mund të paguajnë faturën e shërbimeve të ujësjiellës kanalizimeve.


Figura 25 Fatura Mujore ndaj Vlerës së Bonusit të Ndhmës Ekonomike (32 Bashki)



4. Norma e Arkëtimit në Bashkitë me mbi 15% të Familjeve në Nevojë

Figura 26 jep treguesin e Normat së Arkëtimit në shoqëritë që i përkasin bashkive që kanë mbi 15% të totalit familje me ndihmë ekonomike.

Figura 26. Norma e Arkëtimit të Faturave UK në Bashki me mbi 15% të Familjeve me NE



Bazuar në të dhënat e grafikut të mësipërm vërehet që shoqëritë UK, **Belsh, Gramsh, Peqin, Elbasan, Librazhd-Përrenjas, Memaliaj, Maliq, Pukë, Mirditë dhe Pogradec** kanë norma arkëtimi mjaft të larta, pra duket se ato arrijnë të arkëtojnë pjesën dërrmuese të klientëve të kategorisë së familjeve me NE.

Në këto bashki duhet thelluar analiza për të gjetur arsyet që shpjegojnë këtë fenomen që në dukje është i pamundur. Ndërkohë paraqiten mjaft problematike shoqëritë UK, Dibër, Mat, Klos, Kukës, Has, Devoll, Bulqizë, Fushë Arrëz, Vau Dejës dhe Kolonjë.

5. Pyetësori

Të gjitha shoqërive UK iu dërgua për përgjigje Pyetësori i mëposhtëm:

- I. *Si e reflekton shoqëria në databazën e klientëve listën e konsumatorëve me NE, numri i tyre dhe sa përqind të konsumatorëve familjarë përbëjnë?*
- II. *A i faturon shoqëria konsumatorët me NE dhe sa përqind e tyre janë me matës?*
- III. *Nëse arkëtohen të ardhura prej tyre, sa është numri (%) i konsumatorëve që paguajnë, totali i të ardhurave që arkëtohen nga konsumatorët me NE, raporti i tyre ndaj totalit të faturuar për të gjithë klientët?*
- IV. *Duke presupozuar ti jepet falas një normë prej 50 litrash/ditë/person (për të plotësuar nevojat minimale të jetës së përditshme), kush mund të jetë zgjidhja teknike për realizimin në praktikë të saj?*
- V. *Çfarë zgjidhje propozoni për përballimin e gropës financiare që krijohet nga mospagesa e tyre, p.sh. Të paguhet nga faturat e konsumatorëve të tjerë që merret parasysh në Normën e Arkëtimit, apo subvencion i veçantë nga qeveria qendrore dhe/ose ajo lokale?*

Pyetësorit i janë përgjigjur zyrtarisht **20 nga 57** Shoqëri që operojnë në vend, përkatësisht:

Bulqizë, Krujë, Belsh, Peqin (pjesërisht), Librazhd (pjesërisht), Libohovë (pjesërisht), Tepelenë, Përmet, Maliq, Kolonjë, Pogradec, Devoll, Kukës, Mirditë, Lezhë, Shkodër, Pukë, Fushë Arrëz, Rrogozhinë dhe Vlorë.

Arsyeja kryesore e përqindjes kaq të ulët të përgjigjeve me të dhëna është se përgjithësisht shumë prej tyre justifikohen se nuk disponojnë të dhëna të klasifikuara (të ndara) për këtë kategori konsumatorësh.

6. Analiza e Përgjigjeve të Pyetësorit

- I. *Si e reflekton shoqëria në data bazën e klientëve listën e konsumatorëve me NE, numri i tyre dhe sa përqind të konsumatorëve familjare përbejnë?*
 - Në data basë shoqëritë rezultoi që numri i lidhjeve familjare me ndihmë ekonomike për të 57 shoqëritë përfaqëson rreth 8.7% të totalit të klientëve.
 - Gjithsesi vërehen edhe pasaktësi që duhen verifikuar sidomos për bashkitë, Dibër, Klos, Has, Kukës, Librazhd, Tropojë, ku përqindja e familjeve (klientëve) me NE variojnë nga 68% deri 136% të totalit të numrit të klientëve në data basë të shoqërisë !!??
- ii. *A i faturon shoqëria konsumatorët me NE, dhe sa përqind e tyre janë me matës?*
 - Faturohen 100% të klientëve që i përkasin familjeve me NE.
 - Mesatarisht 80% e tyre janë me matës. Nivel matje të ulët kanë shoqëritë UK, Kukës (5%), Bulqizë (7%), Vlorë (11%), Fushë Arrëz (35%), Pukë (28%) dhe Mirditë (40%).
- iii. *Nëse arkëtohen të ardhura prej tyre, sa është numri dhe në % i konsumatorëve që paguajnë, sa është totali i të ardhurave që arkëtohen nga konsumatorët me NE dhe raporti i tyre ndaj totalit të faturuar për të gjithë klientët?*
 - Janë përgjigjur me të dhëna 11 shoqëri UK që mbledhin të ardhura nga arkëtimet prej familjeve me NE që në përqindje ndaj totalit të arkëtimeve, janë përkatësisht: Lezhë (85%), Bulqizë (23%),

Libohovë (9%), Tepelenë (36%), Maliq (32%), Kolonjë 1%, Pogradec (10%), Devoll (13%), Kukës (16%), Mirditë (6%) dhe Pukë (8%). Shoqëritë e mësipërme përgjithësisht kanë një përqindje relativisht të ulët të familjeve në nevojë ndaj totalit (jo më shumë se 10%, përveç Lezhës dhe Tepelenës).

- iv. *Duke presupozuar ti jepet falas një normë prej 50 litra/ditë, person (për të plotësuar nevojat minimale të jetës së përditshme), kush mund të jetë zgjidhja teknike për realizimin në praktikë të saj?*

Janë përgjigjur 17 shoqëri, përgjigjet e të cilave të grupuara janë:

- Të veçohet kategoria e familjeve me NE në sistemin e shitjes
- Ti merret parasysh duke hequr tarifën fikse të shërbimit
- Të pajisen me matës dhe ti zbritet 50 litra/ditë, banor nga totali i konsumit

- v. *Çfarë zgjidhje propozoni për përballimin e gropës financiare që krijohet nga mos pagesa e tyre, p.sh. të përballohet nga pagesat e faturave të konsumatorëve të tjerë që merret parasysh në Normën e Arkëtimit, apo subvencion i veçantë nga qeveria qendrore dhe/ose ajo lokale?*

Janë përgjigjur 18 shoqëri, përgjigjet e të cilave të grupuara janë :

- Subvencion nga qeveria qendrore dhe/ose bashkia (14 shoqëri)
- Të zgjidhet si tek sektori energjetik (4 shoqëri)

Koment: Asnjë shoqëri nuk ka propozuar që këto kosto mund të përballohen nga tarifat e pjesës tjetër të klientëve që nuk janë me NE.

7. Përfundime

- ❖ Problematike paraqitet gjendja për qëndrueshmërinë financiare nga prania e numrit të madh të familjeve me NE në zonën Veri-Verilindore për bashkitë, përkatësisht, Dibër, Mat, Klos, Kukës, Has, Bulqizë, Fushë Arrëz dhe Vau Dejës, për të cilat subvencionet paraqiten domosdoshmëri.
- ❖ Subvencionimi i faturës së familjeve me NE me 50 litra/ditë, person mund të realizohet nga qeveria qendrore direkt shoqërisë UK ose nëpërmjet Bashkisë. Kjo formë është e domosdoshme për shoqëritë e zonës Veri-Verilindore.
- ❖ Për shoqëritë me nën 10% të numrit të familjeve me NE, për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë norma falas prej 50 litra/ditë, person mund të merret parasysh në propozimet për tarifa që realisht paguhet nga konsumatorët e tjerë.
- ❖ Duke patur parasysh që gjitha shoqëritë UK nuk kanë rekorde dhe analiza në veçanti për klientët e familjeve në NE, si dhe faktin që cikli i publikimit (ndryshimit) nga MSHMS të numrit të familjeve me NE bëhet çdo 3 muaj, është e nevojshme ndërtimi i një software në data basë e klientit që të seleksionojë më vete listën e familjeve me NE dhe faturimin me 50 litra/ditë, banor më pak se klientët e tjerë familjarë.
- ❖ Shoqëritë UK duhet të instalojnë falas detyrimisht ujëmatësa për të gjithë konsumatorët e familjeve me NE dhe të bëjnë një fushatë informuese/sensibilizuese për ti ndërgjegjësuar këto konsumatorë për të drejtë falas prej 50 litra/ditë, person, por mbi këtë normë duhet të paguajnë se përndryshe i ndërpritet shërbimi i furnizimit me ujë.

- ❖ Pavarësisht numrit relativisht të vogël të familjeve me NE në bashkitë me nivel ekonomik të lartë, shoqëritë duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë këtyre konsumatorëve, sidomos në rastet kur shoqëria aplikon tarifa të larta, përkatësisht, në Durrës, Korçë, Tiranë, Himarë, Lezhë, Lushnjë.
- ❖ Paradoksi si në Lezhë që mbi 85% e konsumatorëve të familjeve në nevojë e paguajnë rregullisht faturën e ujit mund të shpjegohet që këto familje mund të kenë të ardhura nga burime të tjera (p.sh. nga remitancat e emigrantëve) dhe që përfaqësojnë një ndërgjegjësim të lartë qytetar që duhet paguar për shërbimet e FU dhe KUN, gjë e cila duhet promovuar kundrejt konsumatorëve të tjerë familjarë që nuk kanë këtë status dhe nuk paguajnë faturën e ujit.

8. Referenca

- VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 «Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike»
- Udhëzimi nr.4, datë 17.02.2017 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë «Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike».
- VKM nr. 18, datë 12.1.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”.
- Vendimi i ERRU-së nr. 39, datë 09.12.2015” Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.
- Vendimi i ERRU-së nr. 42, datë 09.12.2015 “ Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.
- Udhëzim nr. 3, datë 18.06.2020 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore, për shoqëritë aksionarë të ujësjellës kanalizimeve për vitin buxhetor 2020 dhe 2021”.
- Raporti i Censurit të popullsisë vitit 2011.

5 Aneke: Të dhënat Kryesore të Sektorit

Tabela 34, Aneks 1. Shoqëritë e riorganizuara dhe të licencuara sipas reformës deri në vitin 2020

Nr.	Shoqëri të Licencuara sipas Reformës				
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1	Sh.a UK Kukës	Sh.a UK Gjirokastrë	Sh.a UK Libohovë	Sh.a UK Pukë	Sh.a UK Fier
2	Sh.a UK Vorë	Sh.a U Gramsh	Sh.a UK Dropull	Sh.a UK Elbasan	Sh.a UK Bulqizë
3	Sh.a UK Belsh	Sh.a UK Korçë	Sh.a UK Konispol		
4	Sh.a UK Malësi e Madhe	Sh.a UK Krujë	Sh.a UK Tropojë		
5		Sh.a UK Mirditë	Sh.a UK Vlorë		
6		Sh.a U Poliçan	Sh.a UK Rrogozhinë		
7		Sh.a UK Berat Kuçovë	Sh.a UK Kavajë		
8		Sh.a UK Devoll	Sh.a UK Sarandë		
9		Sh.a UK Maliq	Sh.a UK Ura Vajgurore		
10		Sh.a UK Patos			
